



FINANCAT VETJAKE

PËR MBËSHTETJEN TE VETJË



MESAZH NGA PRESIDENCA E PARË

Të dashur Vëllezër dhe Motra:

Zoti ka shpallur: “Është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi” (DeB 104:15). Kjo zbulesë është një premtim nga Zoti se Ai do të sigurojë bekime materiale dhe do ta hapë derën e mbështetjes te vetja, e cila është aftësia jonë që t’i sigurojmë nevojat e jetës për veten dhe pjesëtarët e familjes sonë.

Kjo fletore pune është përgatitur për t’i ndihmuar anëtarët e Kishës që t’i mësojnë dhe t’i vënë në praktikë parimet e besimit, arsimin, të punuarit fort dhe mirëbesimin në Zot. Pranimi dhe të jetuarit e këtyre parimeve do t’ju aftësojnë më shumë që t’i merrni bekimet materiale të premtuara nga Zoti.

Ne ju ftojmë që t’i studioni me zell dhe t’i zbatoni këto parime dhe t’ua jepni mësim pjesëtarëve të familjes suaj. Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të bekohet. Ju do të mësoni se si të veproni në shtegun tuaj drejt mbështetjes më të madhe te vetja. Ju do të bekoheni me shpresë, paqe dhe përparim më të madh.

Ju lutemi, jini i sigurt se ju jeni një fëmijë i Atit tonë në Qiell. Ai ju do dhe nuk do t’ju braktisë asnjëherë. Ai ju njeh dhe është gati t’ju zgjatë bekimet shpirtërore dhe materiale të mbështetjes te vetja.

Sinqerisht,

Presidenca e Parë

Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Solt-Lejk-Siti, Juta

© 2017 nga Intellectual Reserve, Inc.
All rights reserved.

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Miratur për anglisht: 3/17

Miratur për përkthim: 3/17

Përkthim i *Personal Finances for Self-Reliance*

Albanian

14863 101

PËRMBAJTJA

Vlerësimi i Përpyjekjeve të Mia	ii
Për Ndërmjetësit	iv
1. Të Bërit një Kujdestar i Mençur dhe Besnik	1
2. Unifikimi i Qasjes Sonë ndaj Financave	17
3. Pagimi i së Dhjetës dhe Ofertave	33
4. Krijimi i një Buxheti	51
5. Qëndrimi Brenda Buxhetit	69
6. Mbrojtja e Familjes Tuaj nga Vështirësitë	87
7. Të Kuptuarit e Borxhit	107
8. Dalja nga Borxhi	125
9. Përballimi i Krizave Financiare	141
10. Investimi për të Ardhmen (Pjesa 1)	159
11. Investimi për Të Ardhmen (Pjesa 2)	179
12. Të Vazhdojmë t'u Japim të Tjerëve dhe t'i Bekojmë Ata	197

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA

UDHËZIME: Vlerësojeni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Përsiatni mbi mënyrat se si mund të vazhdoni të përmirësoheni teksa ushtroheni për formimin e këtyre zakoneve të rëndësishme.

Ⓐ			Ⓑ		
E vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im			I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia		
Shembull	Të jem i/e bindur		Regjistroj shpenzimet		
Java 1	Mbështetja te vetja është një parim shpëtimi		Regjistroj shpenzimet		
Java 2	Të ushtroj besim te Jezu Krishti		Regjistroj shpenzimet		
Java 3	Të pendohem dhe të jem i/e bindur		Regjistroj shpenzimet		
Java 4	Të jetoj një jetë të baraspeshuar		Hartoj një buxhet		
Java 5	Të zgjidh problemet		Zgjedh një sistem për buxhetin		
Java 6	Ta përdor kohën me mençuri		Caktoj para për një përparësi financiare		
Java 7	Të tregoj integritet moral		Vendos para për një përparësi financiare		
Java 8	Puna: Të marr përgjegjësi dhe të këmbëngul		Vendos para për një përparësi financiare		
Java 9	Të komunikoj: Të bëj kërkesa dhe të dëgjoj		Vendos para për një përparësi financiare		
Java 10	Kërkoj të mësoj: Vendoseni se ku po shkoni dhe se si të arrini atje		Vendos para për një përparësi financiare		
Java 11	Të bëhemi një, të shërbejmë së bashku		Vendos para për një përparësi financiare		

LEGJENDA:

- Përpjekje Minimale
- Përpjekje Mesatare
- Përpjekje të Rëndësishme

© Mbaj një Këshill të Familjes		D Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Germat Nistore të Partnerit në Veprim
Këshillohuni mbi bindjen	● ● ●	● ● ●	
Këshillohuni me Zotin	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi të ardhurat dhe shpenzimet	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi të dhjetat dhe ofertat	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi bërjen e buxhetit	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi bërjen e buxhetit	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi fondin për raste të ngutshme, sigurimin	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi borxhin	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi borxhin	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi administrimin e rasteve të krizës	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi kursimet, pronësinë e shtëpisë, arsimimin	● ● ●	● ● ●	_____
Këshillohuni mbi planifikimin për pensionin	● ● ●	● ● ●	_____

PËR NDËRMJETËSIT

Ju falënderojmë që po ndërmjetësoni për një grup të mbështetjes te vetja. Grupi duhet të funksionojë si një këshill me Frymën e Shenjtë si mësues. Roli juaj është ta ndihmoni çdo person të ndihet i çlirët për të treguar idetë, sukseset dhe dështimet.

GJËRA QË DUHEN BËRË	GJËRA QË NUK DUHEN BËRË
PËRPARA ÇDO MBLEDHJEJE ◦ Shkarkojini materialet filmike në srs.lds.org/videos. ◦ Kontrolloni a punon pajisja për materialet filmike. ◦ Shqyrtojeni shkurtimisht kapitullin. ◦ Përgatituni shpirtërisht. GJATË ÇDO MBLEDHJEJE ◦ Filloni dhe mbaroni në kohë. ◦ Sigurohuni që çdokush të raportojë, edhe ata që mbërrijnë vonë. ◦ Zgjidhni dikë që të matë kohën. ◦ Nxitiini të gjithë që të marrin pjesë. ◦ Jini një anëtar grupi. Bëni, mbani dhe raportoni zotimet tuaja. ◦ Argëtohuni dhe ngazëllehuni në suksesin tuaj. ◦ Mirëbesoni te fletorja e punës dhe përmbajuni asaj. PAS ÇDO MBLEDHJEJE ◦ Vihuni në kontakt me anëtarë të grupit gjatë javës dhe nxitiini ata. ◦ Vlerësojeni veten duke përdorur “Vetëvlerësimi i Ndërmjetësit” (faqe v).	◦ Përgatitni një mësim. ◦ Anuloni mbledhjet. Nëse nuk mund të merrni pjesë, ju lutemi, kërkojini një anëtar të grupit që të jetë ndërmjetësi në vendin tuaj. ◦ Jepni mësim ose veproni si profesionist. ◦ Flisni më shumë se të tjerët. ◦ Përgjigjeni çdo pyetjeje. ◦ Jini qendra e vëmendjes. ◦ Uleni në krye të tavolinës. ◦ Ngriheni në këmbë për të ndërmjetësuar. ◦ Kapërceni pjesën “Përsiatni”. ◦ Jepni mendimin tuaj pas çdo komenti. ◦ Harroni ta përditësoni specialistin e kunjit për mbështetjen te vetja për përparimin e grupit.

E RËNDËSISHME: RAPORTONI DHE PËRMIRËSOHUNI

- Plotësojeni Formularin e Regjistrimit të Grupit në mbledhjen tuaj të parë dhe Raportin e Mbarimit të Grupit dhe Formularin e Kërkesës për Certifikatë në mbledhjen tuaj të fundit. Vizitoni srs.lds.org/report.
- Shqyrtojeni broshurën *Ndërmjetësimi i Grupeve* në srs.lds.org/facilitator.

VETËVLERËSIMI I NDËRMJETËSIT

Pas mbledhjes së çdo grupi, shqyrtojini pohimet e mëposhtme. Sa mirë po ia dilni mbanë?

SI PO IA DAL SI NDËRMJETËS?	Kurrë	Ndonjë-herë	Shpesh	Gjithmonë
1. Vihem në kontakt me anëtarë të grupit gjatë javës.	☐	☐	☐	☐
2. E shpreh ngazëllimin dhe dashurinë time për çdo anëtar të grupit.	☐	☐	☐	☐
3. Ndhmoj për t'u siguruar që çdo anëtar i grupit të mund të raportojë për zotimet e veta.	☐	☐	☐	☐
4. Unë flas më pak se anëtarët e tjerë të grupit. Secili merr pjesë në mënyrë të barabartë.	☐	☐	☐	☐
5. I lë anëtarët e grupit t'u përgjigjen pyetjeve në vend që t'u përgjigjem vetë.	☐	☐	☐	☐
6. Qëndroj brenda kohës së rekomanduar për çdo pjesë dhe veprimtari.	☐	☐	☐	☐
7. Lë kohë për pjesën "Përsiatni" që Fryma e Shenjtë të mund t'i udhërrëfjë anëtarët e grupit.	☐	☐	☐	☐
8. E ndjek fletoren e punës siç është shkruar dhe i plotësoj të gjitha pjesët dhe veprimtaritë.	☐	☐	☐	☐
SI PO ECËN GRUPI IM?	Kurrë	Ndonjë-herë	Shpesh	Gjithmonë
1. Anëtarët e grupit e duan, e nxitin dhe i shërbejnë njëri-tjetrit.	☐	☐	☐	☐
2. Anëtarët e grupit i mbajnë zotimet e tyre.	☐	☐	☐	☐
3. Anëtarët e grupit po arrijnë rezultate si materiale edhe shpirtërore.	☐	☐	☐	☐
4. Partnerët në veprim vihen në kontakt dhe e nxitin rregullisht njëri-tjetrin gjatë javës.	☐	☐	☐	☐



1

TË BËRIT NJË KUJDESTAR I MENÇUR DHE BESNIK

PARIMI NGA THEMELI IM

- Mbështetja te Vetja Është një Parim Shpëtimi

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Bëhuni një Kujdestar i Mençur dhe Besnik
2. Këshillohuni me Zotin për Financat Tuaja
3. Kontrollonini të Ardhurat dhe Shpenzimet Tuaja

UDHËZIME TË FILLIMIT – Koha Maksimale: 15 Minuta

Bëni një lutje hapje.

Paraqiteni veten. Secili nga ju të harxhojë një minutë për të treguar emrin e vet dhe diçka rreth vetes.

MIRË SE VINI NË GRUPIN TONË PËR MBËSHTETJEN TE VETJA!

Lexoni: Ky grup do t'ju ndihmojë të mësoni rreth buxhetit, ta krijoni dhe ta përdorni atë. Ju do të filloni të mbledhni një fond për raste të ngutshme, të krijoni një plan për eliminimin e borxhit, të mësoni të kurseni për shpenzimet në të ardhmen dhe të planifikoni për pensionin. Më e rëndësishmja, ju do të mësoni më shumë rreth marrëdhënies suaj me Atin Qiellor dhe do të ftoheni t'i administroni paratë tuaja në mënyra që janë të kënaqshme për Të. Çdo mbledhje e grupit zgjat rreth dy orë.

SI FUNKSIONON KJO?

Lexoni: Grupet e mbështetjes te vetja funksionojnë si një këshill. Nuk ka mësues apo njeri të specializuar. Përkundrazi, ju ndiqni materialet siç janë shkruar. Me udhërrëfimin e Shpirtit, ju do ta ndihmoni njëri-tjetrin si vijon:

- Kontribuoni njëtrajtësisht në diskutime dhe veprimtari. Askush, veçanërisht ndërmjetesi, nuk duhet të mbizotërojë gjatë bisedës.
- Duajeni dhe përkrahni njëri-tjetrin. Tregoni interes, bëni pyetje dhe mësoni për njëri-tjetrin.
- Jepni komente pozitive dhe të rëndësishme.
- Bëni dhe mbajini zotimet.

Plaku M. Rasëll Ballard dha mësim: “Nuk ka problem në familje, lagje apo kunj që nuk mund të zgjidhet nëse kërkojmë zgjidhje sipas mënyrës së Zotit duke u këshilluar – duke u këshilluar vërtet – me njëri-tjetrin” (*Counseling with Our Councils*, bot. i rish. [2012], f. 4).

Shihni: “My Self-Reliance Group” [“Grupi Im për Mbështetjen te Vetja”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Kaloni te pjesa “Pa Mësues, Si Do ta Dimë Se Çfarë të Bëjmë?” në faqen 3.)

Diskutoni: Çfarë e bëri të suksesshëm grupin te materiali filmik? Çfarë do të bëjmë si grup për të pasur një përvojë që të ndryshon jetën?

PA MËSUES, SI DO TA DIMË SE ÇFARË TË BËJMË?

Lexoni: Është e lehtë. Thjesht ndiqni materialet. Çdo kapitull në fletoren e punës ka gjashtë pjesë:

Raportoni: Diskutoni për përparimin që bëtë gjatë javës me zotimet tuaja.

Themeli: Shqyrtoni një parim të ungjillit që do t'ju udhëheqë te një mbështetje më e madhe shpirtërore te vetja.

Mësoni: Mësoni aftësi praktike që do t'ju udhëheqin te një mbështetje më e madhe materiale te vetja.

Përsiatni: Dëgjoni Frymën e Shenjtë që t'ju ofrojë frymëzim.

Zotohuni: Premtoni se do të veproni sipas zotimeve gjatë javës që do t'ju ndihmojnë të përparoni.

Veproni: Gjatë javës, ushtrojeni atë që mësuat.

SI TË PËRDORET KJO FLETORË PUNE

KUR T'I SHIHNI KËTO NXITJE, NDIQINI KËTO DREJTIME				
LEXONI	SHIHNI	DISKUTONI	PËRSIATNI	VEPRIMTARIA
Një person e lexon me zë të lartë për të gjithë grupin.	I gjithë grupi sheh materialin filmik.	Pjesëtarët e grupit japin mendime për dy deri katër minuta.	Individët qetësisht shqyrtojnë, meditojnë dhe shkruajnë për dy deri në tre minuta.	Anëtarë të grupit punojnë në mënyrë të pavarur ose me të tjerë gjatë kohës së caktuar.

CERTIFIKATË PËRFUNDIMI

Lexoni: Anëtarët e grupit që marrin pjesë në mbledhje dhe i mbajnë zotimet e tyre, mund të marrin një certifikatë nga Kolegji i Biznesit SHDM për mbështetjen te vetja. Shih faqen 208.



THEMELI IM: MBËSHTETJA TE VETJA ËSHTË NJË PARIM SHPËTIMI – Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Gjoni 10:10 (në të djathtë)

Diskutoni: Çfarë është një jetë me bollëk?

Shihni: “He Polished My Toe” [“Më Lustroi Gishtin e Këmbës”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 5.)

Diskutoni: A besoni se ka zgjidhje për problemet tuaja? Si mund të kualifikohemi që fuqia e Zotit të na ndihmojë?

Lexoni: Referencën nga *Manuali 2* dhe citimin nga Plaku Dallin H. Oaks (në të djathtë). Të jesh i/e mbështetur te vetja nuk do të thotë që ne mund të bëjmë apo arrijmë çdo gjë që na vjen në mendje. Përkundrazi, është të besosh se nëpërmjet hirit, apo fuqisë aftësuese, të Jezu Krishtit dhe vetë përpjekjes sonë, ne jemi në gjendje të plotësojmë gjithë nevojat shpirtërore e materiale të jetës që kërkojmë për veten tonë dhe familjet tona. Mbështetja te vetja është provë e mirëbesimit ose besimit tonë te fuqia e Perëndisë për të lëvizur malet në jetën tonë dhe për të na dhënë forcë që të triumfojmë mbi sprova dhe vuajtje.

Diskutoni: Si ju ka ndihmuar hiri i Krishtit për t’i plotësuar nevojat shpirtërore dhe materiale të jetës?

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexojeni secilin parim më poshtë.

Hapi 2: Diskutoni përse besimi te këto të vërteta mund t’ju ndihmojë të bëheni më i mbështetur te vetja.

PARIMET DOKTRINORE TË MBËSHTETJES TE VETJA

1. Mbështetja te vetja është një urdhërim.	“Kisha dhe anëtarët e saj urdhërohen nga Zoti që të jenë të mbështetur te vetja dhe të pavarur” (<i>Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball</i> [2006], f. 116).
2. Perëndia mund dhe do të sigurojë një mënyrë që fëmijët e Tij të drejtë të bëhen të mbështetur te vetja.	“Dhe është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi, sepse gjithë gjërat janë të miat” (DeB 104:15).
3. Materialja dhe shpirtërorja janë një për Perëndinë.	“Si rrjedhim, me të vërtetë unë ju them se gjithë gjërat për mua janë shpirtërore” (DeB 29:34).

“Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.”

GJONI 10:10

“Mbështetja tek vetja është aftësia, zotimi dhe përpjekja për të siguruar nevojat shpirtërore dhe fizike të jetës për vete dhe familjen. Kur anëtarët bëhen të mbështetur tek vetja, ata janë gjithashtu më të aftë që të shërbejnë e të kujdesen për të tjerët.”

MANUALI 2: ADMINISTRIIMI I KISHËS (2010), 6.1.1

“Çfarëdo që na bën të jemi të varur nga dikush tjetër për vendime apo burime që mund t’i siguronim vetë, na dobëson shpirtërisht dhe e vonon rritjen tonë drejt asaj që plani i ungjillit synon që ne të jemi.”

DALLIN H. OAKS,
“Repentance and Change”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2003, f. 40

Diskutoni: Lexojeni citimin nga Presidenti Marion G. Romni (në të djathtë). Si e dini nëse po bëheni më i mbështetur te vetja?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta plotësoni secilin zotim.

- ☐ Lexojeni letrën nga Presidenca e Parë brenda kapakut të përparmë dhe nënvizojini bekimet e premtuara. Çfarë duhet të bëni për t'i marrë ato? Shkruajini mendimet tuaja më poshtë.

- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth mbështetjes te vetja.

MË LUSTROI GISHTIN E KËMBËS

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PLAKU ENRIKE R. FALABELA: Kur po rritesha, ne nuk kishim shumë të ardhura. Më kujtohet një ditë kur iu afrova babait tim dhe i thashë: "Baba, dua të kem një palë këpucë të reja. Këto që kam thujse janë grisur tashmë." Ai ndaloi dhe vështroi këpucët e mia dhe pa që vërtet ishin të grisura. Ai tha: "Mendoj se kjo është diçka që mund ta rregullojmë". Ai mori pak bojë të zezë dhe m'i lustroi këpucët, duke i lënë me shkëlqim dhe të bukura. Ai më tha: "Tani i ke në rregull, bir". U përgjigja: "Jo, ende jo. Ende mund ta shohë gishtin që më del nga këpuca." Ai tha: "Epo, mund ta rregu-

llojmë edhe atë!" Ai mori edhe pak bojë dhe lustroi gishtin tim!

Atë ditë mësova se ka zgjidhje për çdo problem. Unë jam i bindur se ky parim i mbështetjes te vetja dhe kjo nismë është një mënyrë për ta përshpejtuar punën e Zotit. Ajo është pjesë e punës për shpëtim. Të gjithë ne mund të bëhemi më të mirë nga sa jemi tani. Ju duhet ta largoni apatinë. Shumë herë bëhemi të vetëkënaqur dhe kjo e shkatërron përparimin tonë. Çdo ditë është një ditë që mund të përparoj nëse vendos të bëj diçka ndryshe për ta përmirësuar atë që e kam bërë keq në të kaluarën. Nëse e bëni me besim, duke ushtruar besim e shpresë te Krishti që Ai do të jetë atje për t'ju ndihmuar, ju do ta gjeni mënyrën për të përparuar në gjëra materiale dhe shpirtërore. Kjo ndodh sepse Perëndia jeton dhe ju jeni biri apo bija e Tij.

Kthehuni te faqja 4.

"Pa mbështetje te vetja një njeri nuk mund t'i ushtrojë këto dëshira të brendshme për të shërbyer. Si mundemi të japim nëse nuk na ka mbetur asgjë? Ushqimi për të uriturit nuk mund të vijë nga raftet bosh. Paratë për të ndihmuar nevojtarët nuk mund të vijnë nga një portofol bosh. Përkrahja dhe mirëkuptimi nuk mund të vijnë nga dikush i etur emocionalisht. Mësimdhënia nuk mund të vijë nga një i/e pamësuar. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, udhërrëfimi shpirtëror nuk mund të vijë nga i/e dobëti/a shpirtërisht."

MARION G. ROMNEY,
"The Celestial Nature of Self-Reliance",
Ensign, nëntor 1982,
f. 93



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

1. BËHUNI NJË KUJDESTAR I MENÇUR DHE BESNIK

Përsiatni: Harxhoni një minutë kohë për ta përsiatur në heshtje pyetjen vijuese dhe hidhni në letër mendimet tuaj.

- Sa i sigurt jam për të ardhmen time financiare?

Lexoni: Te shëmbëlltyra e talentave, Krishti na mëson se ne duhet të kujdesemi për atë që na është dhënë. Zoti na lejon që të jemi rojtarë – ose kujdestarë – për dhuratat që Ai na ka dhënë. Atyre që janë besnikë ndaj dhuratave të Tij, Krishti u premton: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik në gjëra të vogla, unë do të të vë mbi shumë gjëra; hyr në gëzimin e zotit tënd” (Mateu 25:21).

Diskutoni: Çfarë do të thotë për ju se të gjitha gjërat i përkasin Zotit?

Lexoni: Për pjesën e kujdestarisë tonë, ne nxitemi që të jemi të zgjuar me financa tona. Presidenti Gordon B. Hinkli dha mësim:

“Unë ju nxit . . . të shihni gjendjen e financave tuaja. Unë ju nxit të jeni modestë me shpenzimet tuaja; ta disiplinoni veten në blerjet tuaja që ta shmangni borxhin sa më shumë të jetë e mundur. Shlyejeni borxhin sa më shpejt që mundeni dhe çlirohuni nga skllavëria.

Kjo është pjesë e ungjillit material në të cilin ne besojmë. Zoti ju bekoftë që t’i vini shtëpitë tuaja në rregull. Nëse i keni paguar borxhet tuaja, nëse keni një rezervë, ndonëse është e vogël, atëherë, nëse stuhitë ulërijnë mbi kokën tuaj, ju do të keni strehë për [familjen] tuaj dhe paqe në zemrën tuaj” (“To the Boys and to the Men”, *Ensign*, nëntor 1998, f. 54).

Ndërsa përpigëni t'i përdorni paratë tuaja me mençuri, besimi juaj në Krisht mund të rritet, duke e hapur rrugën për bekime të mëtejshme.

Diskutoni: Si ju bën kujdestarë më të mirë administrimi i financave tuaja?

Ne Mund t'i Administrojmë Financat Tona me Mençuri

Lexoni: Skema në faqen 8 – Harta e Suksesit për Kujdestarinë Financiare – ilustron parime për një administrim financiar me mençuri dhe besnikëri. Ju do t'i studioni dhe do t'i zbatoni këto parime gjatë 12 javëve të ardhshme. Gjatë gjithë këtij kursi, ju do të punoni për ta rritur besimin tuaj në Jezun Krisht, duke krijuar unitet me bashkëshortin/en tuaj dhe duke e forcuar zotimin tuaj për mbështetjen e vetja. Çdo mësim do të përqendrohet te një pjesë specifike e Hartës së Suksesit për Kujdestarinë Financiare.

Diskutoni: Lexojini me radhë pikat e Hartës së Suksesit për Kujdestarinë Financiare (faqe 8). Si mund t'ju ndihmojë secila nga këto në shtegun tuaj drejt kujdestarisë së suksesshme financiare?

2. KËSHILLOHUNI ME ZOTIN PËR FINANCAT TUAJA

Lexoni: Pa dyshim sfida do të dalin teksa ju i zbatoni këto parime të kujdestarisë së suksesshme financiare. Teksa kërkon ndihmën e bashkëshortëve të grupit dhe kërkon vazhdimisht ndihmën e Zotit, ju do të forcoheni për t'i mposhtur ato vështirësi. Kujtoni, Zoti e jep gjithmonë një rrugë për t'i përmbushur urdhërimet e Tij (shih 1 Nefi 3:7).

Amuleku i mësoi të varfrit mes zoramitëve: "Përgjëroju [Zotit] për bereqetin e fushave tuaja, që ai t'ju sjellë begati. Përgjëroju atij për tufat e fushave tuaja, që ato të mund të shtohen" (Alma 34:24–25). Ndërsa këshilloheni me Zotin rreth nevojave dhe sfidave tuaja materiale dhe punoni për të qenë të mbështetur te vetja financiarisht, Ai do t'ju bekojë dhe do t'ju forcojë.

Të këshillohesh me Zotin për financat e tua do të thotë që t'i lutesh Atit Qiellor dhe t'i kërkoh udhërrëfim rreth çështjeve financiare. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë që të këshilloheni me Zotin rreth financave tuaja.

HARTA E SUKSESIT PËR KUJDESTARINË FINANCIARE



3. KONTROLLOJINI TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET TUAJA

Lexoni: Hapi i parë për kujdestarinë e suksesshme financiare është ta kuptoni situatën tuaj aktuale financiare. Kur merrni një kuptim më të mirë se ku i shpenzoni paratë tuaja, ju mund të planifikoni më mirë se për çfarë dëshironi t'i shpenzoni. Ju do të filloni duke kontrolluar të ardhurat dhe shpenzimet tuaja për katër javët e para të këtij kursi.

Përsiatni: Harxhoni pak minuta dhe mendoni në heshtje rreth pyetjeve të mëposhtme:

- A e di se ku i shpenzoj paratë e mia çdo muaj?
- A mendoj se e kam nën kontroll situatën se për çfarë i shpenzoj paratë?

VEPRIMTARIA (25 minuta)

Hapi 1: Në mënyrë të pavarur, mendoni rreth të gjitha mënyrave se si i shpenzoni paratë. Më poshtë janë kategoritë e zakonshme se ku i shpenzojnë njerëzit paratë. Qarkojini fushat se ku i shpenzoni paratë më shpesh dhe hidhni në letër kategoritë shtesë si të jetë e përshtatshme. Kategoria “të ndryshme” është për shpenzimet që nuk përshtaten kryesisht në kategoritë e tjera.

Të dhjetat dhe ofertat	Transporti	Zbavitja	
Qiraja ose kredia	Kursimet	Restorantet	
Sigurimet	Artikujt ushqimorë	Të ndryshme	
Shërbimet komunale të shtëpisë	Telefonat celularë		

Hapi 2: Si grup, diskutoni për kategoritë shtesë që krijuat. Ju do t'i përdorni më vonë kategoritë e lartpërmendura për t'i organizuar të ardhurat dhe shpenzimet tuaja ndërsa i kontrolloni.

Hapi 3: Gjatë gjithë javëve të ardhshme, mbajeni shënim çdo herë që i merrni apo i shpenzoni paratë. Në një tabelë përlogaritëse ose në një bllok shënimesh, krijoni një tabelë që duket si shembulli i mëposhtëm. Plotësojeni çdo ditë tabelën. Kur merrni para, shënojeni shumën të kolona e të ardhurave; kur shpenzoni para, shënojeni shumën të

kolona e shpenzimeve. Për t'u ushtruar, harxhoni disa minuta dhe hidhni në letër sa më shumë shpenzime që të mbani mend nga 24 orët e fundit. Përfshijini kategoritë që krijuat.

DATA	PËRSHKRIMI	KATEGORIA	TË ARDHURAT	SHPENZIMET
1/6	Paga	Të ardhurat	1 500,00	
1/6	Dyqani i Huanit	Artikuj ushqimorë		78,32

Diskutoni: Çfarë sfidash mund të keni hasur kur i kontrolloni shpenzimet tuaja?

Përsiatni: Shkruajini disa mënyra për t'i mposhtur këto sfida.



KONTROLLIMI I SHPENZIMEVE ËSHTË BËRË NJË ZAKON!

Nuk besoj se ishte e mundur t'i kontrolloja shpenzimet për një kohë të gjatë. Por tani mbaj faturat e mia gjatë ditës dhe më pas i hedh në letër të gjitha shpenzimet e mia çdo pasdite. Duhet vetëm pak minuta çdo mbrëmje dhe pak nga hapësira e portofolit për t'i ruajtur faturat gjatë ditës.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Unë, Zoti, i shtriva qiejt dhe ndërtova tokën, pikërisht me punën e duarve të mia; dhe gjithë gjërat në to janë të miat. Dhe është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi, sepse gjithë gjërat janë të miat” (DeB 104:14–15).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?

PARTNERËT NË VEPRIM

DOBIA E PARTNERËVE NË VEPRIM

Lexoni: Me ndihmën e të tjerëve, ju mund të arrini gjëra të mëdha. Për shembull, misionarët kanë shokë ose shoqe shoqëruese për përkrahje. Në grupet tona, ne kemi partnerë në veprim. Çdo javë, ne do të zgjedhim dhe do të punojmë me një partner tjetër në veprim. Partnerët në veprim e ndihmojnë njëri-tjetrin për t'i mbajtur zotimet duke:

- Marrë në telefon, duke shkruar mesazhe me celular ose duke e vizituar njëri-tjetrin gjatë javës.
- Biseduar për atë që mësuam në grup.
- E nxitur njëri-tjetrin për t'i mbajtur zotimet.
- U këshilluar së bashku rreth sfidave.
- U lutur për të tjerët.

Diskutoni: Si ju ka ndihmuar një person tjetër që të arrini diçka të vështirë?

Lexoni: Të jesh një partner në veprim nuk është e vështirë ose nuk merr shumë kohë. Për ta filluar bisedën, ju mund të pyetni:

- Çfarë ju pëlqeu nga mbledhja jonë e fundit me grupin?
- Çfarë gjërash të mira ju kanë ndodhur këtë javë?
- Si e keni përdorur parimin nga Themeli Im këtë javë?

Pjesa më e rëndësishme e diskutimit do të jetë të ndihmojmë njëri-tjetrin për t'i mbajtur zotimet. Ju mund të pyetni:

- Si po ecni me zotimet tuaja?
- Nëse nuk i keni mbajtur disa prej tyre, a ju nevojitet ndihmë?
- Si mund t'ju përkrah më mirë në përpjekjet tuaja?

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Hapi 1: Zgjidhni dikë në grup që të jetë partneri juaj në veprim.

- Ju mund t'i ndryshoni partnerët çdo javë nëse dëshironi.
- Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Hapi 2: Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Çdo javë ne bëjmë zotime. Kur të takohemi javën e ardhshme, do të fillojmë duke raportuar për zotimet tona. Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do t'i kontrolloj të ardhurat e mia dhe shpenzimet çdo ditë këtë javë.
- Ⓒ Do të këshillohem me Zotin për financat e mia dhe do të kërkoj ndihmën e Tij.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim

SHĚNIME

[illegible]

SHĚNIME

[illegible]



2

UNIFIKIMI I QASJES SONË NDAJ FINANCE

PARIMI NGA THEMELI IM

- Ushtroni Besim te Jezu Krishti

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Punoni dhe Merrni Përgjegjësi
2. Punoni së bashku për t'i Administruar Paratë
3. Zhvilloni Rregullisht Këshilla Familjarë



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ T'i kontrolloj të ardhurat dhe shpenzimet e mia.
- Ⓒ Të këshillohem me Zotin për financat e mia.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për të vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bën çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Përdorni mënyrën se si mund të vashdori të përmirësuarve tekste ushtrohen për formimin e kësaj tabeleve të vlerësimit.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme					
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia	Ⓒ Mbaj një Këshill të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjermani Niveli të Partnerit në Veprim	
Shembull Të jem në bindur	Regjistroj shpenzimet	Këshillohem me bindur			
Javë 1 Mësohetja të vetës së mirë për parimin shpenzimet	Regjistroj shpenzimet	Këshillohem me Zotin			
Javë 2 Të ushtroj besim në Jesus Krisht	Regjistroj shpenzimet	Këshillohem me të ardhurat dhe shpenzimet			
Javë 3 Të përdorhem dhe të jem në bindur	Regjistroj shpenzimet	Këshillohem me të ardhurat dhe shpenzimet			
Javë 4 Të jem një jetë të baraspeshuar	Harroj një buxhet	Këshillohem me bindur e buxhetit			
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një sistem për buxhetin	Këshillohem me bindur e buxhetit			
Javë 6 Të përvojë këmbëzim me mangut	Calloj para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur për rastet e ngatërshme, sigurimin			
Javë 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur			
Javë 8 Puna të marr përgjegjësi dhe të këmbejë	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur			
Javë 9 Të kuptoj Të bëj kështu dhe të bëj	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur administrativin e rastit të krishterë			
Javë 10 Kërkohet të mësoj Vlerësimin se ku po ofton dhe se si të arrij atë	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur, prandaj e ofton, arsimin			
Javë 11 Të bëjmë një, të shprehim vetë bashku	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohem me bindur për partnerin			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash kishit ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Në ç'mënyrë po ju ndihmon këshillimi me Zotin?
 - Çfarë mësuar nga kontrollimi i shpenzimeve tuaja?
 - Në ç'mënyrë po ju ndihmon puna me partnerin në veprim?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: USHTRONI BESIM TE JEZU KRISHTI

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Si ndikon besimi im te Jezui Krishti në mbështetjen time te vetja?

Shihni: “Exercise Faith in Jesus Christ” [“Ushtroni Besim te Jezui Krishti”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 21.)

Diskutoni: Përse besimi i vërtetë çon gjithnjë në veprim? Përse besimi është i nevojshëm që Perëndia të na ndihmojë materialisht dhe shpirtërisht?

Lexoni: Mateu 6:30 dhe citimin nga *Lectures on Faith* [Leksione mbi Besimin] (në të djathtë)

VEPRIMTARIA

Shtegu drejt mbështetjes te vetja është një udhëtim besimi. Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve janë duke na ftuar që ta bëjmë rritjen e besimit tonë tek Ati Qiejlor dhe Biri i Tij një përparësi në jetën tonë.

Hapi 1: Si grup, lexojini përparësitë profetike në kutinë më poshtë.

Hapi 2: Diskutoni se si nderimi me besnikëri i Shabatit, marrja e sakramentit dhe leximi i Librit të Mormonit do t’ju ndihmojnë të bëheni më të mbështetur te vetja.

PËRPARËSITË DHE PREMTIMET PROFETIKE

“Përfytyrojeni madhësinë e asaj thënie! Plotësia e tokës u premtohet atyre që e mbajnë ditën e Shabatit të shenjtë” (Rasëll M. Nelson, “Shabati Është një Kënaqësi”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2015, f. 130; shih edhe DeB 59:16).

“Shpirtshmëria nuk është e amullt dhe as besëlidhjet [e sakramentit] nuk janë të tilla. Besëlidhjet nuk sjellin vetëm zotime, por ato sjellin fuqi shpirtërore” (Neil L. Andersen, mbledhje trajnimi me Autoritetet e Përgjithshme, prill 2015).

“Ju jap dëshmi se [Libri i Mormonit] mund të bëhet një ‘Urim dhe Thumim’ vetjak në jetën tuaj” (Richard G. Scott, “The Power of the Book of Mormon in My Life”, *Ensign*, tetor 1984, f. 11).

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Tregojeni besimin tuaj këtë të diel duke e mbajtur ditën e Shabatit të shenjtë dhe duke e marrë me nderim sakramentin.
- ☐ Lexoni nga Libri i Mormonit çdo ditë.
- ☐ Lexojini shkrimet e shenjta në faqen 21. Zgjidhni njërin prej tyre dhe tregojani atë familjes apo miqve tuaj.

“Tani nëse Perëndia e vesh kështu barin e fushës, që sot është dhe nesër hidhet në furrë, vallë nuk do t’ju veshë shumë më tepër ju, njerëz besimpakë?”

MATEU 6:30

“A nuk varen të gjitha përpjekjet tuaja të çdo lloji, nga besimi juaj? . . . Ndërsa i marrim me anë të besimit të gjitha bekimet materiale që vërtet i marrim, po ashtu ne, në mënyrë të ngjashme marrim me anë të besimit të gjitha bekimet shpirtërore që vërtet i marrim. Por besimi nuk është vetëm parimi i veprimit, por edhe i fuqisë.”

LECTURES ON FAITH (1985), f. 2, 3

SHKRIME TË SHENJTA RRETH BESIMIT NË VEPRIM

Për shkak se Danieli nuk ndalonte së luturi, atë e hodhën në një gropë luanësh, por “Perëndia . . . dërgoi engjëllin e tij që . . . mbyll[i] gojën e luanëve, . . . dhe nuk u gjet mbi të asnjë lëndim sepse kishte pasur besim te Perëndia i tij” (Daniel 6:22–23; shih edhe vargjet 16–21).

Zoti ia dha Lehit Liahonën për ta udhëhequr familjen e tij dhe “ajo punoi për ta sipas besimit të tyre në Perëndi. . . . [Kur] ata ishin përtacë dhe harronin të ushtronin besimin dhe zellin e tyre, . . . ata nuk përparonin në udhëtimin e tyre” (Alma 37:40–41).

“Sillni gjithë të dhjetat në shtëpinë e thesarit . . . dhe pastaj më vini në provë për këtë gjë . . . në se unë nuk do t’i hap pragjet e qiellit dhe nuk do të derdh mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini” (Malakia 3:10).

Gjatë një zie buke, Elija i kërkoi një të veje që t’i jepte vaktin e saj të fundit. Elija i premtoi se, për shkak të besimit të saj, Zoti do t’i siguronte asaj ushqim dhe ushqimi i saj nuk do të mbaronte kurrë. (Shih 1 Mbretërve 17.)

“Të mjerët dhe të varfërit kërkojnë ujë, por mungon; gjuha e tyre u është tharë nga etja; unë, Zoti do t’ua plotësoj dëshirën; unë, Perëndia i Izraelit, nuk do t’i braktis” (Isaia 41:17; shih edhe vargun 18).

USHTRONI BESIM TE JEZU KRISHTI

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PLAKU DEJVID A. BEDNAR: Ndërmarrja e veprimit është ushtrim i besimit. Fëmijët e Izraelit po mbajnë arkën e besëlidhjes. Ata vijnë te Lumi Jordan. Premtimi është se ata do të kalojnë nga ana tjetër në tokë të thatë. Kur ndahet uji? Kur këmbët e tyre lagen. Ata ecin nëpër lumë – veprojnë. Fuqia pason – uji ndahet.

Ne shpeshherë besojmë: “Do ta kem këtë kuptueshmëri të përkryer dhe më pas do ta shndërroj atë në ato që bëj”. Do të sugjeroja që ne kemi mjaftueshëm sa për të filluar nga puna. Ne kemi një ndjesi për drejtimin e duhur. Besimi është një parim – parimi – i veprimit dhe i fuqisë. Besimi i vërtetë përqendrohet në dhe te Zoti Jezus Krisht dhe gjithnjë të çon drejt veprimit.

(Shih “Seek Learning by Faith” [fjalim drejtuar mësuesve të fesë të Sistemit Arsimor të Kishës, 3 shkurt 2006], lds.org/media-library)

Kthehuni te faqja 20.



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

- **Besimi në Jezu Krisht**
- **Uniteti me Bashkëshortin/en**
- **Zotimi ndaj Mbështetjes te Vetja**

1. PUNONI DHE MERRNI PËRGJEGJËSI


Lexoni: Kur Adamit dhe Evës iu kërkua të largoheshin nga Kopshti i Edenit, Perëndia tha: “Do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe” (Zanafilla 3:19). Ndërkohë që Zoti dëshiron të na japë gjithçka që na nevojitet nga ana materiale, Ai pret prej nesh të punojmë fort dhe të mbajmë përgjegjësitë për vetë nevojat tona. Vëreni që një nga muret mbështetëse të Harta e Suksesit për Kujdestarinë Financiare (shih faqen 8) është “puna”. Për t’u bërë të mbështetur te vetja nga ana materiale kërkohet shumë punë dhe zell i vazhdueshëm.

Presidenti Diter F. Uhtdorf dha mësim: “Zoti nuk pret që të punojmë më shumë nga sa jemi në gjendje. Ai nuk i krahason përpjekjet tona me ato të të tjerëve (as ne nuk duhet). Ati ynë Qiellor kërkon vetëm që ne të bëjmë më të mirën që mundemi. . . . Puna është një kundërhelm për shqetësimin, një melhem për hidhërimin dhe një portë drejt mundësisë. . . . Kur karroja jonë ngec në baltë, Perëndia ka shumë më tepër gjasa të ndihmojë burrin që del jashtë për ta shtyrë sesa burrin që thjesht ngre zërin e tij në lutje – pavarësisht sa me gojëtarë të jetë fjalimi” (“Dy Parime për Cilëndo Ekonomi”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 56).

Diskutoni: Mendoni për shembuj të punëtorëve të palodhur në jetën tuaj. Çfarë tiparesh kanë të përbashkët këta njerëz?

Ne Duhet ta Eliminohet Mbështetjen Tonë Materiale tek të Tjerët

Lexoni: Presidenti Spencer W. Kimball dha mësim: “Përgjegjësia për mirëqenien shoqërore, emocionale, shpirtërore, fizike ose ekonomike të çdo personi bie së pari mbi atë vetë, së dyti mbi familjen e tij dhe së treti mbi Kishën nëse ai është anëtar besnik i saj. Asnjë shenjtë i vërtetë i ditëve të mëvonshme, ndërsa është i aftë fizikisht ose emocionalisht, nuk do ta kalojë vullnetarisht barrën e vetë mirëqenies së tij apo të familjes së tij të dikush tjetër. Për aq sa mundet, nën frymëzimin e Zotit dhe me vetë punët e tij, ai do t’i sigurojë vetes dhe familjes së tij gjërat e nevojshme shpirtërore dhe materiale të jetës” (*Teachings of President Spencer W. Kimball* [2006], f. 116).



Plaku Dejl G. Renland, duke cituar Plakun Uilford W. Andersen, dha mësim: “Sa më e madhe largësia midis dhënësit dhe marrësit, aq më shumë marrësi zhvillon ndjesinë se i takon ta marrë diçka” (“Që t’i Tërheq të Gjithë Njerëzit tek Unë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2016, f. 39). E drejta për të pasur diçka sepse të takon është kur mendon se meriton diçka pa e bërë dhe pa e përfunduar siç duhet veprimin që nevojitet për ta fituar atë. Kjo është e kundërta e përgjegjshmërisë. Kur ndieni se ju takojnë bekime materiale, Shpirti largohet nga jeta juaj. Ndërsa afroheni më shumë te Krishti, ndjenjat e përgjegjshmërisë për vetë mirëqenien tuaj do ta mbushin zemrën tuaj dhe ndjenjat se gjërat ju takojnë do të zhduken.

- Diskutoni:**
- Si mund ta kufizojë rritjen tonë vetjake varësia tek të tjerët?
 - Përse është e rëndësishme që t’i shmangim varësitë nga qeveritë apo programet shoqërore?
 - Çfarë rreziqesh të tjera e shoqërojnë mbështetjen tek të tjerët, duke përfshirë familjen, për nevojat tona vetjake?

2. PUNONI SË BASHKU PËR T'I ADMINISTRUAR PARATË

Përsiatni: Si kanë ndikuar te ju shpirtërisht dhe emocionalisht financa?

Lexoni: Një nga faktorët më të përhapur dhe më të fuqishëm të Satanit për t'i shkatërruar familjet është pakujdesia financiare dhe stresi që e shoqëron atë. Për arsye se familjet janë thelbësore në planin e Atit Qiellor (shih *Familja: Një Proklamata drejtuar Botës*), është e rëndësishme që ta shmanjim fajin, mosbesimin dhe zemërimin në shtëpitë tona. Qofshi të martuar ose beqarë, kujdestaria financiare me mençuri mund t'i sjellë ata që duam më pranë njëri-tjetrit dhe Perëndisë dhe mund të jetë një mbrojtje nga e liga; një qasje e unifikuar ndaj kujdestarisë financiare mund të sjellë pa dyshim mirënjohje, harmoni dhe paqe.

Diskutoni: Përse është e rëndësishme që bashkëshortët/et të jenë në një mendje për çështjet financiare?

Lexoni: Bashkëshortët/et shpesh vijnë nga kultura, ekonomi dhe nga besime të ndryshme fetare. Ata mund të kenë tradita, teknika të ndryshme se si i rritin fëmijët dhe zakone të ndryshme për shpenzimet. Një bashkëshorti/eje mund t'i vijë natyrshëm interesimi për t'i kontrolluar shpenzimet dhe për t'ju përmbajtur një buxheti dhe tjetrit/ës mund t'i duket e lodhshme dhe e mundimshme. Kjo mund të ndezë mosmarrëveshje. Gjithsesi, pranimi i ndryshimeve të njëri-tjetrit dhe dëgjimi me të vërtetë me dashuri dhe përulësi do të prodhojë një mjedis uniteti. Nëse jeni beqarë/e, është e rëndësishme të jeni të ndershëm/me me veten dhe ta përfshini Zotin në vendimet tuaja për kujdestarinë financiare.

Shumë çifte besojnë se zgjidhja për problemet e tyre financiare është rritja e të ardhurave të tyre. Sidoqoftë, një qasje e përçarë për t'i administruar paratë mund të jetë shumë më tepër dëmtuese për një marrëdhënie sesa të ardhurat e ulëta ose mungesa e burimeve financiare.

Diskutoni: Si mund të jenë mosmarrëveshjet financiare më shumë dëmtuese sesa të ardhurat e ulëta ose mungesa e burimeve financiare?

Lexoni: Plaku Marvin J. Ashton dha mësim: “Administrimi i financave familjare duhet të jetë i përbashkët ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes në një mënyrë transparente dhe të besueshme. Kontrolli i parave nga njëri bashkëshort si një burim fuqie dhe autoriteti shkakton pabarazi në martesë dhe është i papërshtatshëm. E anasjella, nëse një nga partnerët në martesë, me dëshirë e spraps veten krejtësisht nga administrimi financiar familjar, ajo është një dorëheqje nga përgjegjësia e nevojshme” (*One for the Money: Guide to Family Finance* [broshurë], 2006, f. 3).

Diskutoni: Si do ta ndryshojë jetën tuaj të qenit i bashkuar me bashkëshortin/en tuaj?

Kujdestaria Financiare me Mençuri Na Përgatit për Martesë

Lexoni: Ndonëse po përgatiteni për martesë apo jeni beqarë/e, të shkurorëzuar/a ose të ve/ja, kujdestaria financiare me mençuri mund t’ju ndihmojë të jeni gati për marrëdhënie të ardhshme. Shumë çifte të reja janë të rënduar me borxhe dhe me zakone për shpenzime pa kriter që i kanë sjellë në marrëdhënie, të cilat mund të shkaktojnë një fillim të vështirë në martesën e tyre. Përpjekja për të zhvilluar zakone të mira për shpenzime, mbledhje të fondeve për kursime dhe zvogëlimin ose eliminimin e borxhit, do ta ftojë Shpirtin në marrëdhënien tuaj dhe do të krijojë një themel për një martesë të suksesshme.

Diskutoni: Si mund t’ju ndihmojë të qenit një kujdestar financiar i mençur që të përgatiteni për të qenë një bashkëshort/e më i/e mirë në të ardhmen?

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Përgjigjuni me sinjeritet secilës nga pyetjet e mëposhtme.

SI NDIHEM RRETH SHPENZIMEVE TË MIA?	Kurrë	Ndonjë-herë	Shpesh	Gjithmonë
1. Këshillohem me Zotin për financat e mia.	☐	☐	☐	☐
2. Këshillohem me bashkëshortin/en rreth financave tona.	☐	☐	☐	☐
3. Financat janë një burim stresi vetjak.	☐	☐	☐	☐
4. Ia fsheh (ose do të doja t'ia fshihja) shpenzimet e mia bashkëshortit/es.	☐	☐	☐	☐
5. Nuk bie dakord me bashkëshortin/en për financat.	☐	☐	☐	☐

Hapi 2: Me radhë jepjani përgjigjet tuaja të mësipërme bashkëshortit/es ose një partneri/eje. Nëse bashkëshorti/ja juaj nuk është i/e pranishëm/me, kërkojini atij ose asaj të përfundojë po atë vlerësim kur të jeni bashkë dhe më pas shqyrtojini përgjigjet tuaja. Kujtohuni t'i dëgjoni me dashuri dhe përlësi përgjigjet e partnerit tuaj.

Përsiatni: Si mund ta lidhni më mirë veten me bashkëshortin/en dhe me Zotin?

3. ZHVILLONI RREGULLISHT KËSHILLA FAMILJARË

Lexoni: Javën e kaluar diskutuat për rëndësinë e këshillimit me Zotin. Ai dëshiron që ju t'ia dilni mbanë. Përveç këshillimit me Zotin, profetët kanë dhënë mësim për rëndësinë e zhvillimit rregullisht të këshillave familjarë.

Shihni: “Family Councils” [“Këshilla të Familjes”] në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 31.)



Diskutoni: Si mund të ketë dobi për ju dhe familjen tuaj zhvillimi i këshillave familjarë?

DISKUTONI PËR KUJDESTARINË FINANCIARE NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Një këshill ekzekutiv i rregullt familjar ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes është mjedisi i përkryer për të diskutuar për kujdestarinë financiare. Nëse jeni beqarë, zgjidhni një prind ose një pjesëtar tjetër të familjes, shokun e dhomës, këshilluesin ose mikun tuaj dhe zhvilloni një këshill të rregullt dhe të ndershëm me personin për financat tuaja. Nëse jeni të martuar, me siguri do të keni nevojë të bëni diskutime të rëndësishme me bashkëshortin/en tuaj gjatë gjithë këtij kursi. Pas këtij kursi, zhvillimi i këshillave të rregullt familjarë do t'ju ndihmojë të vazhdoni të bëheni më të bashkuar dhe më të mbështetur te vetja.

Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë të përcaktoni një kohë për të zhvilluar një këshill të rregullt familjar. Si pjesë të këshillit tuaj familjar, ju duhet të diskutoni për financat. Ju mund të doni të përdorni përvijimin “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar” në faqen tjetër për t'ju udhërrëfyer te kjo pjesë e këshillit tuaj familjar.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- A po i kontrolloni siç duhet shpenzimet tuaja? Çfarë po mësoni rreth shpenzimit të parave tuaja? Si mund ta përmirësoni procesin tuaj të kontrollimit për shpenzimet tuaja?
- Diskutoni për përfundimet e vlerësimit në faqen 26.

Pjesa 2: Planifikoni

- Si mund të komunikoni më mirë për financat tuaja?
- Çfarë mund të bëni, nëse është nevoja, që ta eliminoni mbështetjen tuaj materiale të familja, qeveria, kisha ose ndihma shoqërore?



SË BASHKU, ÇDO NATË

Na u desh të bënim pesë fëmijë dhe shumë vjet për ta kuptuar këtë gjë (ndoshta më shumë se 20 vjet), por bërja e një lutje çdo mbrëmje si çift – vetëm unë dhe ajo, me zë të lartë, duke u gjunjëzuar dhe duke mbajtur duart – është një nga gjërat më të fuqishme që kemi bërë ndonjëherë për ta bekuar dhe forcuar marrëdhënien tonë. Kur njëri nga ne është në udhëtim, ne e bëjmë lutjen nëpërmjet telefonit!



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Unë ju them, jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë” (DeB 38:27).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- (A)** Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- (B)** Do të vazhdoj t'i kontrolloj të ardhurat dhe shpenzimet e mia këtë javë.
- (C)** Do të zhvilloj një këshill familjar dhe do të diskutoj për kujdestarinë financiare.
- (D)** Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



KËSHILLAT FAMILJARË

Plaku M. Rasëll Ballard, u shpreh si vijon rreth këshillave familjarë:

“Unë besoj që këshillat janë mënyra më dobiprurëse për të arritur rezultate të vërteta. Përveç kësaj, unë e di se këshillat janë mënyra e Zotit dhe se Ai i krijoi të gjitha gjërat e gjithësisë nëpërmjet një këshilli qiellor, siç përmendet në shkrimin e shenjtë.

Megjithatë, deri tani asnjëherë nuk kam folur në konferencën e përgjithshme rreth këshillit më bazë dhe më themelor – dhe ndoshta këshillit më të rëndësishëm – të të gjithë këshillave: këshillit të familjes.

Këshillat e familjeve gjithmonë kanë qenë të nevojshëm. Ata janë, në fakt, të përzetshëm në natyrë. Ne i përkritim një këshilli të familjes në ekzistencën paratokësore, kur jetuam me prindërit tanë qiellorë si fëmijët e tyre shpirtërorë.

Një këshill i familjes, kur mbahet me dashuri dhe me tipare të ngjashme me të Krishtit, do ta pakësojë ndikimin e teknologjisë bashkëkohore që shpesh na e largon vëmendjen prej të shpenzuarit të kohës cilësore me njëri-tjetrit dhe gjithashtu ka prirje të sjellë ligësi drejtpërsëdrejti brenda në shtëpitë tona.

Ju lutem, mbajeni mend që këshillat e familjeve janë të ndryshëm nga mbërmbet familjare të shtëpisë që mbahen të hënave. Mbërmbet familjare përqendrohen kryesisht mbi udhëzimin e ungjillit dhe veprimtaritë familjare. Këshillat e familjeve, nga ana tjetër, mund të mbahen në çfarëdo dite të javës dhe janë kryesisht një mbledhje në të cilën prindërit dëgjojnë – njëri-tjetrit dhe fëmijët e tyre.

Besoj se ka të paktën katër lloje të këshillave të familjeve:

- Së pari, një këshill i përgjithshëm i familjes që përfshin të gjithë familjen.
- Së dyti, një këshill ekzekutiv i familjes që përfshin një nënë dhe një baba.
- Së treti, një këshill i kufizuar i familjes që përfshin prindërit dhe një fëmijë.
- Së katërti, një këshill vetëm-për-vetëm i familjes që përfshin një prind dhe një fëmijë.”

(“Këshillat e Familjeve”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2016, f. 63)

Kthehuni te faqja 27.

SHËNIME

[illegible]



3

PAGIMI I SË DHJETËS DHE OFERTAVE

PARIMI NGA THEMELI IM

- Pendohuni dhe jini të Bindur

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Ndryshojeni Qasjen Tuaj ndaj Administrimit të Parave
2. Paguajini Të Dhjetën dhe Ofertat



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ T'i kontrolloj të ardhurat dhe shpenzimet e mia.
- Ⓒ Të diskutoj për kujdestarinë financiare në këshillin tim familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta për-krah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjake partnerit tuaj në veprim. Përdorni mënyrën se si mund të vlerësoni të përmendshmet nësa ushtrohen për formimin e këtyre zakonave të rëndësishme.					
		LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme			
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mja	Ⓒ Mëq një Këshill të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjithë Koha e Partnerit në Veprim	
Shembull: Të jem në bisedë	Regjistroj shpenzimet	Këshillohuni më shpesh			<i>DN</i>
Javë 1 Mëkëmbja në vetë bursën një parim shqiptar	Regjistroj shpenzimet	Këshillohuni më shpesh			
Javë 2 Të ushtroj besim në punën kryesore	Regjistroj shpenzimet	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 3 Të përkrahem dhe të jem në kontakt	Regjistroj shpenzimet	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 4 Të jem një yll të bashkëpunimit	Harxhoj një bursë	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një problem për bashkëpunimin	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 6 Të përkrah bashkëpunimin me partnerin	Çelësi për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 7 Të mësoj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 8 Puna të marr përgjegjësi dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 9 Të komunikoj të bëj kërkime dhe të bëj	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 10 Kërkim të mësoj vendosmëri në punë dhe si të arrijnë ajo	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			
Javë 11 Të bëhem një të shprehjeve të bashkuar	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni më shpesh dhe diskutoni			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë modelesh ose zakonesh keni zbuluar ndërsa kontrolloni shpenzimet tuaja?
 - Çfarë mësuat nga këshilli juaj familjar? Çfarë mësuat nga vlerësimi financiar (shih faqen 26)?
 - Në ç'mënyrë po ju ndihmon puna me partnerin në veprim?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: PENDOHUNI DHE JINI TË BINDUR

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Si lidhen pendimi dhe bindja me mbështetjen te vetja?

Shihni: “Obedience Brings Blessings” [“Bindja Sjell Bekime”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 37.)

Diskutoni: Çfarë bekimesh keni marrë me anë të bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë? Si na ndihmon pendimi që të përparojmë?

Lexoni: Doktrinën e Besëlidhjet 130:20–21 dhe citimin nga Profeti Jozef Smith (në të djathtë)

“Ka një ligj . . . mbi të cilin të gjitha bekimet bazohen – Dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet.”

**DOKTRINA E
BESËLIDHJE 130:20–21**

VEPRIMTARI

Bindja ndaj ligjeve të posaçme çon drejt bekimeve të posaçme.

Hapi 1: Në mënyrë të pavarur, në kolonën e majtë, shkruani disa bekime që ju i dëshironi.

Hapi 2: Përcaktoni se cilat ligjeve ose parimeve keni nevojë t’i bindeni me qëllim që t’i merrni bekimet që dëshironi.

BEKIMET QË DËSHIROJ TË MARR	LIGJET OSE PARIMET QË DUHET T’I BINDEM
Tre muaj kursime	E dhjeta dhe ofertat (Malakia 3:10–12) Ecni sipas një buxheti

Diskutoni: Lexoni te Jozueut 3:5 dhe citimet nga Plaku Xhefri R. Holland dhe Presidenti Spenser W. Kimball (në faqen 37). Përse kemi nevojë të pendohemi, ta shenjtërojmë veten tonë dhe të përpiqemi të bëjmë mirë ndërsa kërkojmë të bëhemi të mbështetur te vetja?

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjoni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Bindjuni ligjit që zgjodhët në veprimtarinë më lart.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth bindjes.

“Unë e bëra këtë rregullin tim: Kur Zoti urdhëron, bindu.”

MËSIMET TË PRESIDENTËVE TË KISHËS: JOZEF SMITH (2009), f. 168

BINDJA SJELL BEKIME

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PRESIDENTI TOMAS S. MONSON:

Çfarë premtimi i lavdishëm! “Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat” [DeB 93:28]. . . .

Vëllezërit dhe motrat e mia, prova e madhe e kësaj jete është bindja. “Dhe ne do t’i provojmë me këtë”, tha Zoti, “për të parë nëse ata do t’i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t’i urdhërojë” [Abraham 3:25].

Shpëtimtari shpalli: “Sepse të gjithë ata që dëshirojnë të kenë bekim nga dora ime, duhet t’i binden ligjit që u caktua për atë bekim dhe kushteve të tij, siç u ngritën që përpara krijimit të botës” [DeB 132:5].

Nuk ekziston shembull më i shkëlqyer për bindjen se ai i Shpëtimtarit tonë: Për të Pali vërejti:

“Edhe pse ishte Bir, mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi,

dhe, si u bë i përkryer, u bë vepronjësi i shpëtimtari të amshuar për të gjithë ata që i binden” [Hebrenjve 5:8–9].

Shpëtimtari tregoi dashuri të sinqertë për Perëndinë duke jetuar jetë të përsosur, duke e nderuar misionin e

shenjtë që ishte i Tij. Kurrë nuk ishte Ai arrogant. Kurrë nuk ishte Ai i fryrë me krenari. Kurrë nuk ishte Ai i pabesë. Gjithmonë ishte Ai i përlulur. Gjithmonë ishte Ai i sinqertë. Gjithmonë ishte Ai i bindur. . . .

Kur u përball me agoninë e Gjetsemanit, kur Ai duroi dhembje të tillë që “djersa iu bë sikur të ishte pika të mëdha gjaku që binin në tokë” [Lluka 22:44], Ai dha shembullin e Birit të bindur duke thënë: “O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yt” [Lluka 22:42].

Sikurse Shpëtimtari i udhëzoi Apostujt e Tij të hershëm, kështu ju udhëzon Ai ju dhe mua: “Ti ndiqmë” [Gjoni 21:22]. A jemi të gatshëm të bindemi?

Dituria që kërkojmë, përgjigjet për të cilat jemi të dëshiruar, dhe forca që dëshirojmë sot për të përballuar sfidat e një bote të ndërlikuar dhe në ndryshim, mund të jenë tonat kur u bindemi me gatishmëri urdhërimeve të Zotit. Po i citoj edhe një herë fjalët e Zotit: “Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat” [DeB 93:28].

Është lutja ime e përlulur që të mund të bekohemi me shpërblimet e bollshme që u premtohen të bindurve. Në emrin e Jezu Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, amen.

(“Bindja Sjell Bekime”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2013, f. 89, 92)

Kthehuni te faqja 36.

“Shenjtërohuni, sepse nesër Zoti ka për të bërë mrekulli midis jush.”

JOZUEUT 3:5

“Zoti i bekon ata që dëshirojnë të përmirësohen, që e pranojnë nevojën për urdhërime dhe përpiqen t’i zbatojnë ato. . . . Ai do t’ju ndihmojë të pendoheni, të ndreqni, të rregullojnë çfarëdo që duhet rregulluar dhe të vazhdoni. Shumë shpejt do ta keni suksesin që kërkon.”

XHEFRI R. HOLLAND,
“Nesër Zoti Ka për të Bërë Mrekulli midis Jush”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2016, f. 126

“Nëse na pëlqen luksi ose madje domosdoshmëritë më tepër sesa na pëlqen bindja, ne do t’i humbasim bekimet që Atij do t’i pëlqente të na i jepte.”

SPENCER W. KIMBALL, në *Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball (1982), f. 212



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

1

**PAGUAJINI TË DHJETËN
DHE OFERTAT**



**HARTA E SUKSESIT PËR
KUJDESTARINË FINANCIARE**

Diskutoni: Si mendoni, përse “paguani të dhjetën dhe ofertat” është shkalla e parë në Hartën e Suksessit për Kujdestarinë Financiare?

Lexoni: Anëtarët e Kishës janë këshilluar që të paguajnë të dhjetën dhe ofertat e tyre përpara se të paguajnë shpenzime të tjera, madje gjërat e nevojshme. Plaku Dallin H. Ouks dha mësim: “Pagesa e së dhjetës është një provë përparësish” (“Tithing”, *Ensign*, maj 1994, f. 35). Ndërsa ia tregoni Perëndisë përparësitë tuaja, ju do të hapni mundësi të mëdha për Të që t’ju bekojë. Shkrimet e shenjta shpesh theksojnë që gjërat duhen bërë me rregull. (Për shembull, shih 1 Korintasve 14:40, Mosia 4:27, dhe Doktrina e Besëlidhje 93:43.)

Presidenti Hiber J. Grant dha mësim: “Burrat dhe gratë që kanë qenë plotësisht të ndershëm me Perëndinë, që e kanë paguar të dhjetën e tyre, . . . Perëndia u ka dhënë atyre diturinë kur kanë mundur të përdorin pjesën e mbetur nga nëntë e dhjeta dhe ka qenë një shumë e madhe për ta dhe ata kanë përmbushur me të shumë më tepër [nevoja] sesa po të mos kishin qenë të ndershëm me Zotin” (në Conference Report, prill 1912, f. 30).

Diskutoni: Si mendoni që ju ndihmon pagimi i së dhjetës së pari, për ta përdorur më mirë pjesën e mbetur nga nëntë e dhjeta e parave që keni?

1. NDRYSHOJENI QASJEN TUAJ NDAJ ADMINISTRIMIT TË PARAVE


Lexoni: Në mënyrë që të paguani të dhjetën dhe ofertat së pari, mund të jetë e nevojshme të ndryshoni qasjen tuaj të përgjithshme ndaj administrimit të parave. Kujdesi ndaj shpenzimeve aktuale jetësore shpesh mund ta rëndojnë aftësinë tonë që të kursejmë për të ardhmen dhe që të krijojmë siguri financiare. Shumë njerëz e ndjekin këtë qasje për kujdestarinë financiare: ata paguajnë për nevoja të përditshme së pari, si ushqimi, strehimi, transporti dhe kujdesi mjekësor, ndërkohë që synojnë të kursejnë para dhe të paguajnë të dhjetën me atë që mbetet. Kjo metodë është e ilustruar në skemën vijuese.

QASJA E ZAKONSHME



Lexoni: Ndërkohë që kjo praktikë mund të jetë shumë e zakonshme, ka një qasje më të mirë për kujdestarinë financiare: Kur ju merrni të ardhura, së pari paguani të dhjetën dhe më pas vini para mënjatë për veten tuaj në të ardhmen – edhe nëse shuma është mjaft e pakët. Më pas përdoreni atë që ka mbetur (pjesën më të madhe të të ardhurave tuaja) për të paguar shpenzimet tuaja të jetesës. Kjo metodë është e ilustruar në skemën vijuese.

QASJA E MBËSHTETJES TE VETJA




Diskutoni: Cilat janë disa ndryshime ndërmjet këtyre dy qasjeve? Përse kaq shumë njerëz përfundojnë duke ndjekur qasjen e zakonshme për kujdestarinë financiare?

Lexoni: Ne do të përdorim ilustrimin më poshtë me një kavanoz, disa gurë dhe rërë për të treguar se sa gjë e mençur është vënia e parave mënjane për Zotin së pari dhe për veten tonë në të ardhmen (shih Stephen R. Covey, A. Roger Merrill, dhe Rebecca R. Merrill, *First Things First: To Live, to Love, to Learn, to Leave a Legacy* [1994], f. 88–89).

Kavanozi përfaqëson të ardhurat tona: një burim me madhësi të kufizuar. Secili nga ne ka kavanoz me madhësi të ndryshme, por parimi që diskutohet këtu është i njëjti për cilindo. Gurët dhe rëra, kur vendosen në kavanoz përfaqësojnë mënyrat se si ne mund t'i përdorim paratë tona. Në këtë shembull, gurët e mëdhenj dhe të vegjël përfaqësojnë përparësitë tona afatgjate – vënien e parave mënjane për Zotin dhe për veten në të ardhmen – dhe rëra përfaqëson nevojat dhe dëshirat tona aktuale.

Le t'i vendosim në kavanoz artikujt duke përdorur qasjen e zakonshme për kujdestarinë financiare.


QASJA E ZAKONSHME



Lexoni: Vëreni se kur hidhni rërën së pari, nuk ka vend mjaftueshëm për të nxënë të gjithë gurët.

Tani le t'i vendosim artikujt në kavanoz duke përdorur qasjen e mbështetjes te vetja për kujdestarinë financiare.

QASJA E MBËSHTETJES TE VETJA



Lexoni: Vëreni se kur vendosni gurët së pari, ka ende vend për të gjithë rërën.

Diskutoni: Si lidhet ky shembull i kavanozit me pagimin e së dhjetës dhe kursimin e parave? Përse të gjithë artikujt zunë vend në kavanoz herën e dytë? Në ç'mënyrë është vënia e gurëve në kavanoz së pari, një shembull që tregon besim?

Lexoni: Gjatë këtij kursi ju do të mësoni vazhdimisht se si të ndiqni më shumë qasjen e mbështetjes te vetja për kujdestarinë financiare. Ndonëse ndjekja e kësaj qasje të mbështetjes te vetja mund të mos jetë e rehatshme në fillim, ajo do t'ju ndihmojë të përgatiteni më mirë për të ardhmen. Është e natyrshme të shqetësoheni që mund të mos keni para të mjaftueshme për nevojat tuaja aktuale nëse e paguani të dhjetën dhe vini para mënjane për kurseme së pari. Ajo është një provë besimi. Një peshkop i mençur dikur i tha një të sapokthyeri në besim që ishte në siklet: "Nëse pagimi i së dhjetës nënkupton që ti nuk mund të paguash për ujë ose energji elektrike, paguaje të dhjetën. Nëse pagimi i së dhjetës nënkupton që ti nuk mund ta paguash qiranë, paguaje të dhjetën. Nëse pagimi i së dhjetës nënkupton se nuk ke para të mjaftueshme për ta ushqyer familjen tënde, paguaje të dhjetën. Zoti nuk do të të braktisë" (në Aaron L. West, "Sacred Transformations", *Ensign*, dhjetor 2012, f. 38).

Ndërsa keni mbajtur kontrollin për shpenzimet tuaja, me shumë mundësi keni marrë edhe të ardhura gjithashtu.

Shqyrtoni se si i administroni aktualisht paratë tuaja dhe si mund të përmirësoheni për pagimin e së dhjetës, dhe për veten tuaj në të ardhmen së pari. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë t'i zbatoni këto parime dhe të vazhdoni t'i kontrolloni të ardhurat dhe shpenzimet tuaja këtë javë.

Ndërsa po të zgjidhni qasjen e mbështetjes te vetja për kujdestarinë financiare, kërkon të ushtroni besim në Jezu Krisht, ajo kërkon edhe zbatimin e aftësive të duhura financiare. Javën tjetër, ju do të filloni të përvetësoni aftësinë se si ta përdorni siç duhet një buxhet, i cili do t'ju ndihmojë ta keni nën kontroll shpenzimin dhe t'i përdorni paratë për të paguar të gjitha shpenzimet tuaja.

Diskutoni: Si mund ta ndryshojë jetën tuaj pagimi i së dhjetës dhe kursimi i parave së pari?

2. PAGUAJENI TË DHJETËN DHE OFERTAT

Lexoni: “Ligji i së dhjetës është i thjeshtë”, dha mësim Presidenti Xhejms E. Faust i Presidencës së Parë. “Ne paguajmë një të dhjetën e rritjes sonë individuale çdo vit. *Rritje* është interpretuar nga Presidenca e Parë me nënkuptimin të ardhurat. Çfarë shume nga 10 përqindëshi i të ardhurave tona individuale na ndan ne me Krijuesin tonë. . . . Si një i sapokthyer në besim në Kore njëherë thashë: ‘Me të dhjetën nuk ka rëndësi nëse je i pasur apo i varfër. . . . Nëse fitoni shumë para, ju paguani 10 përqind. Nëse fitoni pak para, ju prapëseprapë paguani 10 përqind’” (“Opening the Windows of Heaven”, *Ensign*, nëntor 1998, f. 59).

Shihni: “Widow of Zarephath [Vejusha e Sareptas]”, në dispozicion te [srs.lds.org/videos](https://www.srs.lds.org/videos). (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 49.)



Diskutoni: Përse vejusha e Sareptas ia dha vaktin e saj të fundit profetit Elija? A mund të kishit vepruar kështu? Përse po ose përse jo?

Lexoni: Ligji i së dhjetës ka ekzistuar që në kohët e Dhiatës së Vjetër. Te Malakia ne lexojmë se, nëse e paguajmë të dhjetën tonë, Zoti do të na i hapë “pragjet e qiellit” (shih Malakia 3:10).

Plaku Dejvid A. Bednar dha mësim: “Shëmbëlltyra e ‘pragjeve’ të qiellit, e përdorur nga Malakia, është shumë udhëzuese. Dritaret lejojnë dritë natyrale që të futet në ndërtesë. Në mënyrë të ngjashme, ndriçim dhe perspektivë shpirtërore derdhen përmes pragjeve të qiellit dhe në jetën tonë, kur ne e nderojmë ligjin e së dhjetës. . . . Ne mund të kemi nevojë dhe mund të lutemi për ndihmë që të gjejmë punësim të përshtatshëm. . . . Dhurat[a] shpirtërore [e] dallimit të shtuar, . . . mund të na fuqizojë për të përcaktuar mundësi punësimi që shumë njerëz të tjerë mund të mos i vënë re. . . . Ne, në mënyrën e duhur, mund të dëshirojmë dhe punojmë për të marrë një rritje rroge në punësimin tonë për t’i siguruar më mirë domosdoshmëritë e jetës. . . . [Ose në disa raste] ne mund të dëshirojmë dhe presim një rrogë më të madhe, por bekimi që na vjen përmes pragjeve qiellore, mund të jetë aftësi më e madhe për të vepruar dhe për t’i ndryshuar vetë rrethanat tona, në vend që të presim që rrethanat tona të ndryshohen nga dikush ose diçka tjetër” (“Pragjet e Qiellit”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 18).

Diskutoni: Në çfarë mënyrash ju ka udhërrëfyer ndriçimi shpirtëror (ose frymëzimi vetjak) për t'i ndryshuar vetë rrethanat tuaja?

Ligji i Agjërimit

Lexoni: “Një respektim me vend i ditës së agjërimit, zakonisht përfshin heqjen dorë nga ushqimi dhe pijet për dy vakte të njëpasnjëshme në një periudhë 24-orëshe, duke marrë pjesë në mbledhjen e agjërimit e të dëshmimeve dhe duke dhënë një ofertë bujare agjërimi për të ndihmuar ata në nevojë” (*Handbook 2 [Manuali 2]* [2010] 21.1.17).

Ofertat e agjërimit janë përdorur për t'i ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët dhe ata në nevojë. Dhënia e një oferte bujare agjërimi do ta rritë gjithashtu aftësinë tonë vetjake për të qenë të mbështetur te vetja.

Plaku Xhefri R. Holland dha mësim: “Ju jap dëshmi të mrekullive, si shpirtërore ashtu edhe materiale, që u vijnë atyre që e jetojnë ligjin e agjërimit. . . . Gëzojeni atë privilegj të shenjtë të paktën çdo muaj dhe jini aq zemërgjerë sa e lejojnë rrethanat në ofertën tuaj të agjërimit dhe në dhurimet e tjera humanitare, arsimore dhe misionare. Ju premtoj se Perëndia do të jetë zemërgjerë me ju dhe ata që gjejnë ndihmë nga dora juaj, do ta quajnë emrin tuaj të bekuar përherë” (“A Nuk Jemi Ne të Gjithë Lypësa?” *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 41–42).

Diskutoni: Çfarë mund të bëni për ta përmirësuar agjërimin tuaj?

DISKUTONI PËR TË DHJETËN DHE OFERTAT NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Gjatë këshillit tuaj familjar këtë javë, diskutoni për dobinë që ka pagimi i së dhjetës dhe vënia e disa parave mënjane për kursime sapo t'i merrni të ardhurat tuaja. Vendosni me bashkëshorten/in tuaj se si ta përmirësoni agjërimin tuaj.

Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë "Model Diskutimi Në Këshillin Familjar".

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- A po paguani një të dhjetë të plotë dhe të ndershme?
- A po jepni një ofertë bujare agjërimi?
- Si po ecni me kontrollimin e të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja (shih kapitullin 1)?

Pjesa 2: Planifikoni

- Çfarë mund të bëni për të paguar një të dhjetë të plotë dhe të ndershme?
- Çfarë konsideroni ju një ofertë bujare agjërimi?
- Si mund ta përmirësoni agjërimin tuaj?
- Si mund ta përshtatni qasjen e mbështetjes te vetja për kujdes-tarinë financiare (shih faqet 39–40)?

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Përgjigjuni secilës pyetje me sinqeritet.

SI NDIHEM RRETH KËSAJ PËRVOJE?	Kurrë	Ndonjë-herë	Shpesh	Gjithmonë
1. Çdo anëtar i grupit raporton për zotimet e veta.	☐	☐	☐	☐
2. Grupi ynë fillon dhe mbaron në kohë.	☐	☐	☐	☐
3. Ndiej një lidhje me anëtarët e grupit.	☐	☐	☐	☐
4. E ndiej Shpirtin në mbledhjet tona në grup.	☐	☐	☐	☐
5. Secili në grup merr pjesë njëtrajtësisht.	☐	☐	☐	☐
6. Ndiej se po bëj përparim për mbështetjen te vetja.	☐	☐	☐	☐
7. Ndiej se anëtarët e grupit më duan.	☐	☐	☐	☐

Diskutoni: Çfarë mund të bëjmë për ta përmirësuar përvojën në grupin tonë?

**ISHTE KAQ E THJESHTË!**

Një mbrëmje në shtëpi pas takimit me grupin, bashkëshortja ime dhe unë vendosëm të fillonim të vinim para mënjanë për kursimet, përpara se të paguanim për shpenzimet tona aktuale të jetesës. Ajo bisedoi me dikë në bankën tonë ditën tjetër dhe ata i thanë asaj se mund të hidhnin automatikisht një pjesë nga secila pagë në llogari dhe një pjesë tjetër – pavarësisht shumës që kishim vendosur – te kursimet. Tani sa herë që e marr pagën, ajo shkon automatikisht në llogari të ndara. Ishte kaq e thjeshtë! Kursimi i parave tani është diçka që as kemi pse e mendojmë!



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Sillni gjithë të dhjetat në shtëpinë e thesarit . . . dhe pastaj më vini në provë për këtë gjë, thotë Zoti i ushtrive, ‘në se unë nuk do t’i hap pragjet e qiellit dhe nuk do të derdh mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini” (Malakia 3:10–12).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- (A)** Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- (B)** Do të vazhdoj t'i kontrolloj të ardhurat dhe shpenzimet e mia këtë javë.
- (C)** Do të zhvilloj një këshill familjar dhe do të diskutoj për të dhjetën dhe ofertat.
- (D)** Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



VEJUSHA E SAREPTAS

Vejusha e Sareptas, e cila ishte ndër më të varfrat e të varfërve, faktikisht ishte një njeri që mbështetej shumë te vetja në mes të skamjes, në një tokë të shkretë. Tani, juve mund t'ju vijë ndërmend se asaj po i mbaronte ushqimi dhe po mblidhte shkopinj për të ndezur një zjarr që të gatunte vaktin e fundit. Kjo duket krejt e kundërta me mbështetjen te vetja. Por rrënjët e saj shpirtërore të mbështetjes te vetja ishin aq të thella, sa që kur një profet i Perëndisë i kërkoi racionin e saj të fundit të ushqimit, “ajo shkoi dhe veproi sipas fjalës së Elias” (1 Mbretërve 17:15). Shkrimet e shenjta na tregojnë se pasi ajo përdori grurin e saj të fundit për të ushqyer profetin, “ena e miellit nuk mbaroi dhe qypi i vajit nuk u pakësua” (vargu 16), dhe “kështu hëngrën ajo, Elia dhe gjithë familja e saj për një kohë të gjatë” (vargu 15). Asaj po i mbaronte ushqimi, por nuk ndodhi – jo ngaqë kishte para mjaftueshëm por ngaqë kishte besim mjaftueshëm. Ndërsa bëjmë më të mirën tonë për ta jetuar ungjillin dhe bëjmë gjithçka që mundemi për t'u mbështetur te vetja, Zoti do ta shpërblejë besimin dhe mundimin tonë.

Kthehuni te faqja 43.

SHĚNIME



4

KRIJIMI I NJË BUXHETI

PARIMI NGA THEMELI IM

- Jetoni një Jetë të Drejtpeshuar

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Mblidhni një Buxhet
2. Drejtpeshojeni Buxhetin



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ T'i kontrolloj të ardhurat dhe shpenzimet e mia.
- Ⓒ Të diskutoj për të dhjetën dhe ofertat në këshillin tim familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta për-krah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për të vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bën çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjake partnerit tuaj në veprim. Partneri më mirë do të mund të vlerësojë të përmirësuarit të ushtrimit për partnerin e tij dhe zotimet që i mbajti.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Mëdha					
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Gjurmë Ndore të Partnerit në Veprim	
E vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia	Mbaj një Këshill të Familjes	Vihej në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim		
Shembull: Të jem në bisedë	Regjistroj shpenzimet	Kishiheshim më bashkë			
Javë 1 Më shpeshja të vëla edhe një pjesë shpirtore	Regjistroj shpenzimet	Kishiheshim me Zotën			
Javë 2 Të ushtroja besim të jashtë krishter	Regjistroj shpenzimet	Kishiheshim më të ardhurat dhe shpenzimet			
Javë 3 Të përdorshem dhe të jem në bisedë	Regjistroj shpenzimet	Kishiheshim më të ofruesit dhe ofertat			
Javë 4 Të jem një jetë të baraspeshuar	Hartoj një buxhet	Kishiheshim më bashkë në buxhet			
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një dilemë për buxhetin	Kishiheshim më bashkë në buxhet			
Javë 6 Të përdor krahun me mangut	Gratë për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë për vlerat e ngathtësisë, sigurtimit			
Javë 7 Të integroja integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë			
Javë 8 Puna: Të merr përgjegjësi dhe të këmbej	Vendos para për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë			
Javë 9 Të këmbej: Të bëj kërkesa dhe të mësoj	Vendos para për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë për vlerat e ngathtësisë, sigurtimit			
Javë 10 Kërkoj të mësoj: Vlerësojmë se ku po ofrojmë dhe se si të arrijmë më	Vendos para për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë, grumblojmë dhe përmirësojmë			
Javë 11 Të bëjmë një të ardhmë të bashkë	Vendos para për një përparim financiar	Kishiheshim më bashkë për parimet			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Në ç'mënyrë po ju ndihmon këshillimi me Zotin?
 - Çfarë mësuat nga kontrollimi i të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja?
 - Në ç'mënyrë po ju ndihmon puna me partnerin në veprim?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: JETONI NJË JETË TË DREJTPESHUAR

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Si t'i mbaj të drejtpeshuara kërkesat e përditshme të jetës?

Shihni: "Of Regrets and Resolutions" ["Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 55.)

Diskutoni: Çfarë bëri Shpëtimtari për të arritur një jetë të drejtpeshuar?

Lexoni: Mosia 4:27, 2 Nefi 9:51, dhe citimet nga Plaku M. Rasëll Ballard (në të djathtë) dhe Presidenti Xhejms E. Faust (në faqen 55)

Diskutoni: Çfarë gjërash mund të thjeshtohen ose të eliminohen nga jeta jonë, në mënyrë që të mund të përfetojmë më shumë gëzim?

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Lexojini citimet nga Plaku Dallin H. Oaks (në faqen 55).

Hapi 2: Në mënyrë të pavarur, mendoni rreth mënyrës se si e jetoni jetën çdo javë. Tani përfytyroni sikur jeni 25 vjeç dhe po jetoni ende në po të njëjtën mënyrë. Përfundojini dy thëniet më poshtë rreth jetës suaj:

Thjesht nuk shpenzova shumë kohë

Shpenzova shumë kohë

Hapi 3: Për të shmangur keqardhjet në të ardhmen, shkruani një ose dy gjëra që mund të bëni për të sjellë më shumë drejtpeshim në jetën tuaj.

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojini kutitë kur ta përfundoni secilin veprim:

- ☐ Veproni sipas idesë suaj për të sjellë më shumë drejtpeshim në jetën tuaj.
- ☐ Tregojini familjes ose miqve tuaj atë që keni mësuar rreth gjetjes së drejtpeshimit.

"Shikoni, që të gjitha këto gjëra që jenë bërë në urtësi dhe rregull; pasi nuk është e nevojshme që një njeri duhet të vrapojë më shpejt sesa ai ka fuqi."

MOSIA 4:27

"Mos shpenzoni para për atë që nuk ka vlerë, as punën tuaj për atë që nuk mund të japë kënaqësi."

2 NEFI 9:51

"Thjesht bëni më të mirën që mundeni çdo ditë. Bëni gjërat bazë dhe përpara se ta kuptoni, jeta juaj do të jetë plot me kuptueshmëri shpirtërore që do t'ju pohojë se Ati juaj Qiellor ju do. Kur një njeri e di këtë, atëherë jeta do të jetë plot me qëllim e kuptim, duke e bërë drejtpeshimin më të lehtë për t'u mbajtur."

M. RUSSELL BALLARD, "Keeping Your Life in Balance", *Liahona*, shtator 2012, f. 50

LIDHUR ME KEQARDHJET DHE VENDIMET

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PRESIDENTI DITER F. UHTDORF: A nuk është e vërtetë që ne shpesh zihemi shumë me punë? Dhe, e trishtueshme për ta thënë, [por] ne madje e quajmë faktin që jemi të zënë simbol nderi, sikur të qenit i zënë, në vetvete, të qe një arritje ose shenjë e një jete të mrekullueshme.

A është kështu?

Mendoj për Zotin tonë dhe Shembullin e përsosur, Jezu Krishtin, dhe jetën e Tij të shkurtër midis njerëzve të Galileës dhe Jerusalemit. Jam përpjekur ta përfytyroj Atë duke u ngutur nga

një mbledhje te tjetra ose duke bërë shumë gjëra njëkohësisht për të përmbushur një listë me gjëra të ngutshme.

Nuk mund ta shoh Atë duke bërë këtë gjë.

Përkundrazi, shoh Birin e dhembshur e dashmirës të Perëndisë duke e jetuar çdo ditë me qëllim. Kur Ai bashkëveproi me njerëzit përreth Tij, ata u ndien të rëndësishëm dhe ndien që Ai i donte. Ai e njihte vlerën e pafundme të njerëzve që takoi. Ai i bekoi dhe iu shërbeu atyre. Ai i lartësoi dhe i shëroi ata. Ai iu dha atyre dhuratën e çmuar, kohën e Tij.

(Diter F. Uhtdorf, "Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 22)

Kthehuni te faqja 54.

"Drejtëpeshimi në masë të madhe do të thotë të kuptosh gjërat që mund të ndryshohen, duke i vënë ato në këndvështrimin e duhur dhe duke i kuptuar gjërat që nuk do të ndryshojnë."

JAMES E. FAUST, "The Need for Balance in Our Lives", *Ensign*, mars 2000, f. 5

"Shumë mbajtës të familjes shqetësohen se profesionet iu lënë shumë pak kohë për familjen e tyre. . . . Megjithatë, nuk kam njohur asnjë burrë që, të kujtonte jetën e tij në punë e të thoshte: 'Nuk kam kaluar aq kohë sa duhej në punën time.'"

DALLIN H. OUKS, "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2007, f. 105

"Numri i gjërave të mira që mund të bëjmë e tejkalon shumë kohën në dispozicion për t'i kryer ato. Disa gjëra janë më të mira se vetëm mirë dhe këto janë gjërat që duhet të marrin vëmendje me përparësi në jetën tonë."

DALLIN H. OAKS, "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2007, f. 104



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

BUXHETI



HARTA E SUKSESIT PËR KUJDESTARINË FINANCIARE

Diskutoni: Përse mendoni se “buxheti” është një mur te Harta e Suksesit për Kujdestarinë Financiare në vend që të jetë një shkallë?

Lexoni: Sot ne do të diskutojmë për një nga mjetet më jetësore për të krijuar siguri financiare dhe për t’u bërë të mbështetur te vetja: duke krijuar dhe duke përdorur me efektshmëri një buxhet. Një **buxhet** është një plan. Duke përdorur buxhetin, ju planifikoni se si do t’i përdorni paratë tuaja për një kohë të caktuar.

Ndjekja e një buxheti do t’ju ndihmojë juve dhe familjen tuaj të merrni nën kontroll jetën tuaj tokësore, ta zhvishni njeriun e natyrshëm (shih Mosia 3:19) dhe ta ftoni Shpirtin në shtëpinë tuaj. Plani financiar gjithashtu mund t’ju ndihmojë që ta mbron familjen tuaj nga vështirësitë kur e përdorni që të vini para për të mbledhur një fond për raste të ngutshme, për të paguar borxhin dhe për të kursyer për shpenzimet në të ardhmen.

Krijimi dhe ndjekja e një buxheti është një vepër besimi. Ne nuk mund ta parashikojmë të ardhmen dhe kostot shpesh rriten papritmas. Është e rëndësishme të kujtojmë se një buxhet duhet të jetë i ndryshueshëm – i rregullueshëm dhe i përmirësuar vazhdimisht. Kur ta krijoni një buxhet këtë javë, kujtoni se do të duhet të shqyrtohet dhe të rishikohet vazhdimisht gjatë këshillit tuaj të rregullt familjar. Nëse e tejkaloni buxhetin, mos u dorëzoni! Mund të duhen disa muaj rregullime përpara se të keni një buxhet të efektshëm.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Hapi 1: Harxhoni një minutë kohë për të shqyrtuar në heshtje paragrafët që sapo lexuat rreth përdorimit të një buxheti. Nënviçezoni bekimet specifike për përdorimin e një buxheti.

Hapi 2: Më pas ecni rreth grupit dhe tregojeni bekimin e nënvizuar që është më domethënësi për ju.

1. MBLIDHNI NJË BUXHET

Lexoni: Në veprimtaritë vijuese, ne do të ushtrojmë krijimin e një buxheti.

Tani për tani, ju do të përlogaritni shumat që kërkojnë nga njerëzit në bazë të asaj që dini dhe asaj që keni mësuar nga kontrollimi i të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë ta përsëritni këtë ushtrim me shifra të vërteta duke përdorur tabelën në fund të këtij kapitulli.

Për të mbledhur një buxhet, filloni me të ardhurat tuaja.

VEPRIMTARIA (3 minuta)

Te shembulli i buxhetit në faqen 60, plotësoni kutinë e parë të kolonës të “Ardhurat” me të ardhurat mujore neto të përlogaritura. **Neto** do të thotë të ardhurat që çoni në shtëpi.

Lexoni: Hapi tjetër për të krijuar një buxhet është të klasifikoni dhe të përlogaritni shpenzimet tuaja. Ju keni mbajtur kontrollin për shpenzimet tuaja dhe i keni vendosur ato në kategoritë që krijuat në kapitullin 1. Tani ne do t'i ndajmë shpenzimet tona në dy lloje: “Të pandryshueshme” dhe “Të ndryshueshme”. Më poshtë janë disa shembuj.

SHPENZIME TË PANDRYSHUESHME (P)	SHPENZIME TË NDRYSHUESHME (N)
Kredia/qiraja	Faturat për ujin, dritat
Pagesa e makinës	Artikujt ushqimorë
Pagesa e sigurimeve	Ngrënia në restorante
E dhjeta	Karburanti dhe transporti
Fondi për raste të ngutshme	Pajisje shtëpiake
Fatura të tjera	Zbavitja

Shpenzime të Pandryshueshme

Lexoni: Shpenzimet e pandryshueshme janë për një shumë të përcaktuar dhe nuk ndryshojnë. Shumica e këtyre shpenzimeve do të jetë mujore, por mund të ketë disa shpenzime që mund të jenë më të shpeshta ose më të rralla. Shpenzimet e pandryshueshme nuk mund të kontrollohen drejt-përdrejt nga zakonet për shpenzimet, përkundrazi, shpenzimet e pandryshueshme kontrollohen duke e vlerësuar situatën tuaj dhe duke bërë ndryshime. Një mënyrë e mirë për të përcaktuar shpenzimet e pandryshueshme është të pyesësh: “A ndodh rregullisht ky shpenzim dhe a është shuma e këtij shpenzimi e njëjtë çdo herë?” Shembuj të zakonshëm përfshijnë një kredi, qiranë, pagesën e makinës dhe shpenzime specifike si faturat e internetit, abonimit për programe televizive ose të telefonit celular.

Ka edhe shpenzime të pandryshueshme që nuk janë domosdoshmërisht mujore; ndonjëherë shpenzimet ndodhin në mënyrë vjetore, gjashtë mujore ose tremujore. Për shembull, nëse paguani sigurimin e makinës çdo 6 muaj ose sigurimin për jetën çdo 12 muaj, ky është një shpenzim i pandryshueshëm. Për ta kthyer këtë shpenzim të pandryshueshëm që t'i përshtatet buxhetit tuaj, ndajeni shumën që paguani sipas numrit të pagesave për çdo muaj. Ndonëse mund të mos e paguani këtë faturë çdo muaj, ju do të vini mënjatë pjesën e nevojshme çdo muaj, në mënyrë që të mund ta paguani faturën kur ta ketë afatin.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Shkruajini shpenzimet tuaja të pandryshueshme te shembulli për buxhetin në faqen tjetër. Shkruani një *P* te kolona "Lloji" dhe përlllogaritni shumën e shpenzimit në kolonën e tretë. Ndërsa i shtoni shpenzimet, ruajeni rrjedhën e bilancit të shumës së të ardhurave që mbeten te kolona "Balanci". Shihni për ndihmë shembullin për buxhetin.

Shpenzimet e Ndryshueshme

Lexoni: Shpenzimet e ndryshueshme nuk kanë të njëjtën shumë çdo muaj. Ka disa shpenzime të ndryshueshme që nuk kontrollohen direkt nga zakonet tuaja për shpenzimet. Për shembull, shpenzimet si faturat për shërbimet komunale (ujin, gazin, energjinë elektrike e më tej) luhaten në varësi të përdorimit. Sidoqoftë, edhe pse shuma mujore mund të ndryshojë, ju prapëseprapë mund të mbani buxhet për këto.

Kur vjen puna për planin financiar, shpenzimet e ndryshueshme më të rëndësishme janë ato mbi të cilat keni kontrollin më të madh. Këto kontrollohen drejtpërdrejt nga zakonet tuaja për shpenzimet. Një mënyrë e mirë për të përcaktuar shumicën e këtyre shpenzimeve është ta pyetni veten: "A ta blej këtë në dyqan (apo në internet)?" Për shumë shpenzime të ndryshueshme, ju mund ta bëni zgjedhjen për të shpenzuar më shumë ose më pak në këto fusha. Shembujt përfshijnë artikujt ushqimorë, karburantin, ngrënien në restorante, telefonat celularë dhe zbavitjen.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Shkruajini shpenzimet tuaja të ndryshueshme të shembulli për buxhetin. Shkruani një "N" te kolona "Lloji" dhe përlogariteni shumën e shpenzimeve në kolonën e tretë. Ndërsa i shtoni shpenzimet, ruajeni rrjedhën e bilancit të shumës së të ardhurave që mbeten te kolona "Bilanci". Shihni për ndihmë shembullin për buxhetin.

Veprimtaria Shembulli për Buxhetin (Duke Përdorur Vlerat e Përlllogaritura)

[illegible]

Shembulli për Buxhetin

PËRSHKRIMI	LLOJI	TË ARDHURAT	SHPENZI-MET	BILANCI
Të ardhurat	(PZ)	1 000		
◦ E dhjeta dhe ofertat	P		110	890
◦ Fond njëmuor për raste të ngutshme	P		50	840
◦ Sigurimet	P		80	760
◦ Qiraja	P		300	460
◦ Shërbimet komunale	N		30	430
◦ Artikujt ushqimorë dhe ushqimet	N		230	200
◦ Pagesat e borxhit	N		80	120
◦ Transporti	N		50	70
◦ Zbavitja	N		30	40
◦ Të ndryshme	N		40	0
Bilanci				0

2. DREJTPESHOJENI BUXHETIN

Lexoni: Kur bëni një përmbledhje të buxhetit tuaj, ju mund të zbuloni se keni më shumë shpenzime sesa të ardhura. Nëse kjo është situata juaj, nuk jeni vetëm. Dhe ky është një problem që mund ta zgjidhni. Ka dy mënyra për ta zgjidhur këtë sfidë: Fitoni më shumë të ardhura ose shpenzoni më pak para. Tani për tani, le të diskutojmë se si ne mund ta përdorim buxhetin për të na ndihmuar që të shpenzojmë më pak duke mësuar se si të kontrollojmë se sa para shpenzojmë për dëshirat tona.

Shihni: “Continue in Patience” [“Vazhdoni me Durim”] në dispozicion te [srs.ids.org/videos](https://www.srs.ids.org/videos). (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 66.)



Diskutoni: Si bëheni ju hera-herës si këta fëmijë? Si cili fëmijë jeni?

VEPRIMTARIA (7 minuta)

Hapi 1: Në mënyrë të pavarur analizojini modelet tuaja aktuale për shpenzimet duke i shenjuar kutitë përzgjedhëse në tabelën vijuese. A mund t'i rregulloni shpenzimet tuaja për t'i vënë përparësi më mirë nevojave afatgjate mbi dëshirat afatshkurtra?

SI NDIHEM RRETH SHPENZIMEVE TË MIA?	Shpenzoj tepër pak	Ndihem mirë për shpenzimet e mia	Shpenzoj me tepri
Ngrënia në restorante	☐	☐	☐
Artikujt ushqimorë	☐	☐	☐
Ushqimet e lehta dhe pijet	☐	☐	☐
Zbavitja	☐	☐	☐
Qiraja ose kredia	☐	☐	☐
Shërbimet komunale	☐	☐	☐
Veshjet	☐	☐	☐
Gjërat për shtëpinë	☐	☐	☐
Transporti	☐	☐	☐
Sigurimet	☐	☐	☐
Telefoni celular	☐	☐	☐

Hapi 2: Bashkohuni me bashkëshortin/en tuaj ose partnerin në veprim. Përcaktoni se ku mund të shpenzoni më pak në buxhetin tuaj dhe shkruani idetë tuaja më poshtë.

**PROBLEMI ME PËRQINDJEN**

Bashkëshorti im paguhet me përqindje, kështu që paga nuk është kurrë e njëjtë si ajo e kaluara. Dhe ndonjëherë ndodh që e merr pagën pas një kohe të gjatë! Ne kemi mësuar që thjesht të 'shkojmë sipas rendit': të paguajmë së pari faturat më të rëndësishme, pastaj ato më pak të rëndësishmet. Çdokush duhet të vendosë se çfarë do të thotë për ta 'gjërat më të rëndësishme'.

DISKUTONI PËR PLANIN FINANCIAR NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Plaku Robert D. Hejls na mësoi: “Një . . . mënyrë e rëndësishme si i ndihmojmë fëmijët tanë të jenë kujdestarë të [matur] është duke hartuar një buxhet familjar. Ne duhet të shqyrtojmë rregullisht planin e të ardhurave, kursimeve dhe shpenzimeve të familjes tonë në mbledhje të këshillit familjar. Kjo do t’u mësojë fëmijëve tanë të njohin ndryshimin mes dëshirave e nevojave dhe që të planifikojnë paraprakisht [për] përdorim[in] kuptimplotë të burimeve familjare” (“Të Bëhemi Kujdestarë të Matur, Materialisht dhe Shpirtërisht”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 10).

Gjatë këshillit tuaj familjar këtë javë, punoni së bashku me bashkëshortin/en tuaj për të krijuar buxhetin tuaj familjar. Nëse jeni beqarë ose nëse do të donit më shumë ndihmë, këshillohuni me një mik, prind, pjesëtar të familjes, këshillues ose anëtar të grupit. Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar”.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Sa shpenzoni për secilën kategori?
 - Në ç’mënyrë është plani financiar një vepër besimi?
-

Pjesa 2: Planifikoni

- Krijoni një buxhet duke përdorur udhëzimet në këtë kapitull. Plotësojeni tabelën “Buxheti Im” në faqen 67.
- A po tregoheni realistë për çdo kategori të buxhetit?
- Nëse është e nevojshme, ku mund të shpenzoni më pak në buxhetin tuaj në mënyrë që të jetë i drejtpeshuar ose që shpenzimi juaj të përputhet ngushtë me nevojat apo vlerat tuaja?



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Organizoni veten tuaj; përgatitsni çdo gjë të nevojshme” (DeB 88:119).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do të krijoj një buxhet duke përdorur tabelën “Buxheti Im” në faqen 67.
- Ⓒ Do të diskutoj për buxhetin tim gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

VAZHDONI ME DURIM

Presidenti Diter F. Uhtdorf shprehu këshillën vijuese:

“Në vitet 1960 një profesor i Universitetit të Stanfordit nisi një eksperiment të thjeshtë ku provonte forcën e vullnetit të fëmijëve katërvjeçarë. Ai vendosi para tyre një bonbone të madhe dhe u tha pastaj se mund ta hanin menjëherë ose, nëse do të prisnin për 15 minuta, ata do të mund të kishin dy bonbone.

Pastaj ai i la vetëm fëmijët dhe vështroi se çfarë ndodhi pas një pasqyre gjysmë të tejdukshme. Disa nga fëmijët e hëngrën menjëherë bonbonen; disa mundën të prisnin vetëm disa minuta përpara se t'i jepeshin tundi-mit. Vetëm 30 përqind qenë të aftë të prisnin. . . .

Çka filloi si një eksperiment i thjeshtë me fëmijë dhe bonbone, u bë një studim domethënës që sugjeroi se aftësia për të pritur – për të qenë të duruar – që një tipar kyç i karakterit, që mund të parashikonte sukses të mëvonshëm në jetë. . . .

. . . Premtimet e Perëndisë nuk përmbushen gjithmonë aq shpejt ose në mënyrën si mund të shpresojmë. . . .

Durim do të thotë të këmbëngulim për diçka deri në fund. Do të thotë të shtyjmë për më vonë kënaqje të menjëhershme për bekime të ardhshme.

. . .

. . . Puna e durimit në thelb është kjo: mbani urdhërimet; besojini Perëndisë, Atit tonë Qiellor; shërbejini Atij me butësi dhe dashuri si ajo e Krishtit; ushtroni besim dhe shpresë tek Shpëtimtari; dhe kurrë mos u dorëzoni.”

(“Vazhdoni me Durim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2010, f. 56, 58, 59)

Kthehuni te faqja 61.

BUXHETI IM

[illegible]

SHĚNIME

[illegible]



5

QËNDRIMI BRENDA BUXHETIT

PARIMI NGA THEMELI IM

- Zgjidhni Problemet

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Vendosni Synime Financiare Reale e Shtytëse
2. Gjeni një Sistem Plani Financiar dhe Përdoreni Atë
3. Jini Përgjegjës për Vetën
4. Kërkojeni Ndhmën e Zotit dhe Vazhdoni të Përpiqeni



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të krijoj një buxhet.
- Ⓒ Të zhvilloj një këshill familjar dhe të diskutojmë për buxhetin tonë.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta për-krah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën "Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia" në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bën çdo javë. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj në veprim. Partneri mbi mënyrën se si mund të ushtrohet të përmirësoheni tek ushtroheni për formimin e këtyre zakonave të rëndësishme.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme					
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj partnerit Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administronj Financat e Mia	Ⓒ Mëq një Këshill të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjendja Nivelo e Partnerit në Veprim	
Shprehja (2 jeta në bisedë)	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohuni mbi bërjen			
Javë 1 Mësohet se vepra e kësaj rreze (përdoret)	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohuni mbi bërjen			
Javë 2 Të ushtroj besim të jashtëm	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohuni mbi të ushtrohet dhe shpenzimet			
Javë 3 Të përdorim dhe të jeta në bisedë	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohuni mbi të shprehjet dhe ofertat			
Javë 4 Të jeta një jetë të barabartë	Harxhoj një buxhet	Ndihmohuni mbi bërjen e buxhetit			
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një sistem për buxhetin	Ndihmohuni mbi bërjen e buxhetit			
Javë 6 Të përdor kohën me mençuri	Calloj para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi bërjen për rritje të rëndësishme, ligjorimit			
Javë 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi bërjen			
Javë 8 Puna: Të marr përgjegjësi dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi bërjen			
Javë 9 Të komunikoj, të bëj kërkime dhe të shpreh	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi administrimin e rasteve të krizës			
Javë 10 Ndihmohuni mbi vendosim të hapësirës dhe të të ardhurave	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi komunikimin, përmirësimin e shprehjet, arsimimit			
Javë 11 Të bashkëpunoj, të shprehim dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohuni mbi planifikimin për partnerin			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë mësuat nga krijimi i një buxheti?
 - Si ju ndihmoi këshilli juaj familjar gjatë krijimit të buxhetit?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: ZGJIDHINI PROBLEMET

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Përse Ati Qiellor lejon që të përballemi me probleme dhe sfida?

Shihni: “A Bigger Truck?” [“Një Kamion më i Madh?”] në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 73.)

Diskutoni: Cili është problemi i vërtetë në këtë histori? Cilat janë disa nga mundësitë për të dy burrat?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhjet 9:7–9 dhe citimin nga Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë)

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexojini hapat më poshtë.



Hapi 2: Zgjidhni një problem që po hasni dhe shkruajeni poshtë.

Hapi 3: Zbatoni çdo hap për problemin tuaj.

Përcaktoni: _____

Mundësitë e studimit: _____

Vendosni dhe veproni: _____

“Vër re, ti nuk ke kuptuar; ke menduar se do të ta jap atë, kur ti nuk e more mundimin as për të më pyetur.

Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.

Por nëse nuk është e drejtë, ti nuk do të kesh ndjenja të tilla, por do të kesh një mpirje të mendimit që do të të bëjë ta harrosh gjënë që është e gabuar.”

DOKTRINA E BESËLIDHJE 9:7–9

“Zoti pret nga ne që të ndihmojmë për zgjidhjen e vetë problemeve tona. . . . Ne jemi qenie njerëzore që mendojmë e arsyetojmë. Ne kemi zotësinë t’i dallojmë nevojat tona, të planifikojmë, të vendosim synime dhe t’i zgjidhim problemet tona.”

ROBERT D. HALES,
“Every Good Gift”,
New Era, gusht 1983,
f. 8, 9

Lexoni: 1 Nefi 17:51 dhe 1 Nefi 18:2–3 (në të djathtë)

Diskutoni: Në ç'mënyrë qe në gjendje Nefi ta ndërtonte një anije?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni rutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Veproni sipas hapave që diskutuat te veprimtaria me qëllim që të filloni ta zgjidhni problemin tuaj. Mbani mend, mos hiqni dorë! Duhet kohë për t'i zgjidhur problemet e për të bërë ndryshime.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth zgjidhjes së problemeve.

NJË KAMION MË I MADH?

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PLAKU DALLIN H. OUKS: Dy burra formuan një ortakëri. Ata ndërtuan një depo të vogël anës një rruge të rrahur. Ata siguruan një kamion dhe shkuan me të në fushën e një fermeri, ku blenë një ngarkesë të plotë me shalqinj me një dollar copa. Ata e çuan kamionin e ngarkuar në depon e tyre, ku i shitën shalqinjtë me një dollar

copa. Ata shkuan përsëri te fusha e fermerit dhe blenë një ngarkesë tjetër të plotë me shalqinj me një dollar copa. Duke i çuar anës rrugës, ata e shitën sërish një shalqi me një dollar. Duke u kthyer drejt fushës së fermerit për të marrë një ngarkesë tjetër, njëri nga ortakët i tha tjetrit: "Ne nuk po bëjmë shumë para me këtë biznes, apo jo?" "Jo, nuk po bëjmë", u përgjigj ortaku i tij. "A mendon se na duhet një kamion më i madh?"

("Focus and Priorities", *Ensign*, maj 2001, f. 82)

Kthehuni te faqja 72.

"Dhe tani, në qoftë se Zoti ka fuqi kaq të madhe dhe ka bërë kaq shumë mrekulli mes fëmijëve të njerëzve, si është e mundur që ai nuk mund të më udhëzojë që unë të ndërtoj një anije?"

1 NEFI 17:51

"Tani, unë, Nefi, nuk i punova trarët sipas mënyrës që mësohej nga njerëzit, as nuk e ndërtova anijen sipas mënyrës së njerëzve; por e ndërtova atë sipas mënyrës që Zoti më tregoi; prandaj ajo nuk ishte sipas mënyrës së njerëzve.

Dhe unë, Nefi, shkova në mal shpesh dhe iu luta Zotit shpesh; prandaj Zoti më tregoi gjëra të mëdha."

1 NEFI 18:2–3



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

BUXHETI

Lexoni: Përgëzime për mbledhjen e buxhetit! Buxheti mund të jetë një mjet i fuqishëm për të kontrolluar situatën tuaj financiare dhe për të ulur stresin në jetën tuaj. Në shkrimet e shenjta ne mësojmë se “e vërteta është dituri për gjërat siç janë dhe siç ishin, dhe siç do të jenë” (DeB 93:24).

Diskutoni: Si mund të zbatohet ky varg nga Doktrina e Besëlidhjet për financat tuaja dhe përdorimin e një buxheti?

Lexoni: Dijenja se cila është vërtet gjendja financiare e familjes tuaj, është thelbësore për kujdestarinë e suksesshme financiare. Plaku Jozef B. Uirthlin dha mësim: “Ata që jetojnë brenda mundësive të tyre e dinë se sa para u vijnë çdo muaj dhe ndonëse është e vështirë, ata e disiplinojnë veten që të shpenzojnë më pak se ajo shumë” (“Earthly Debts, Heavenly Debts”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2004, f. 42).

Të qëndrosh brenda buxhetit mund të jetë e vështirë. Ajo kërkon zotim, disiplinë dhe këmbëngulje – mund të nevojiten përpjekje të shumta për ta bërë siç duhet! Ndërsa përpiqeni t’i ndryshoni sjelljet tuaja për shpenzimet, kujtoni që të këshilloheni me Zotin dhe bashkëshortin/en tuaj ose një partner përgjegjës. Me përpjekje të vazhdueshme dhe përkrahje dashamirëse, ju mund të bëheni më shumë si fëmijët që pritën gjatë eksperimentit me bonbone (e diskutuar në kapitullin e kaluar).

Diskutoni: Si mund të na ndihmojë Zoti të zhvillojmë cilësi si të Krishtit, duke përfshirë vetëdisiplinimin dhe zellin?

Lexoni: Sot do të diskutojmë katër parime për të qëndruar brenda buxhetit.

1. Vendosni synime financiare reale e shtytëse.
2. Gjeni një sistem plani financiar dhe përdoreni atë.
3. Jini përgjegjës për veten.
4. Kërkoni ndihmën e Zotit dhe vazhdoni të përpiqeni!

1. VENDOSNI SYNIME FINANCIARE REALE E SHTYTËSE

Lexoni: Vendosja e synimeve është një mjet i fuqishëm që na ndihmon të zhvillojmë dhe të mbajmë një këndvështrim afatgjatë.

Plaku M. Rasëll Ballard dha mësim: “Më lejoni t’ju tregoj diçka rreth vendosjes së synimeve. Unë jam plotësisht i bindur se në qoftë se ne nuk vendosim synime në jetën tonë dhe nuk mësojmë si ta përvetësojmë teknikën e të jetuarit për t’i arritur synimet tona, mund të arrijmë në një moshë të vjetër dhe të hedhim vështrimin pas në jetën tonë veç për të parë se kemi arritur vetëm një pjesë të vogël të potencialit tonë të plotë. Kur një njeri mëson ta përvetësojë parimin e vendosjes së një synimi, atëherë ai do të jetë në gjendje të bëjë një ndryshim madhor në rezultatet që arrin në këtë jetë” (“Do Things That Make a Difference”, *Ensign*, qershor 1983, f. 69–70).

Diskutoni:

- Si ju kanë ndihmuar synimet të përparoni në të kaluarën?
- Në ç’mënyrë është vendosja e synimeve një vepër besimi?

Lexoni: Është e rëndësishme të vendosim synime financiare që janë si reale dhe shtytëse. Gjatë disa kapitujve të tjerë, ne do të mësojmë rreth shumë synimeve dhe përparësive financiare, duke përfshirë mbledhjen e një fondi njëmuor për raste të ngutshme, daljen nga borxhi, mbledhjen e një fondi afatgjatë për raste të ngutshme, investimin për pensionin dhe kursimin për shpenzime të tjera të vlefshme. Veprimtaria në vijim do t’ju ndihmojë të përcaktoni se cila nga këto duhet të jetë prioriteti juaj aktual financiar.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Përgjigjuni vetë pyetjeve më poshtë. Pyetja e parë së cilës i përgjigjeni "jo" përfaqëson se cila duhet të jetë përparësia juaj aktuale financiare.

CILA ËSHTË PËRPARËSIA IME AKTUALE FINANCIARE?	PO	JO
1. A e paguaj të dhjetën? (Shih kapitullin 2.)	☐	☐
2. A kam një fond njëmuor për raste të ngutshme? (Shih kapitullin 6.)	☐	☐
3. A kam sigurime shëndetësore apo ndonjë kujdes tjetër mjekësor në dispozicion?	☐	☐
4. A jam i/e lirë nga borxhi konsumator, si kartat e kreditit dhe huat për makinën? (Shih kapitullin 7.)	☐	☐
5. A kam një fond tre deri gjashtë muor për raste të ngutshme? (Shih kapitullin 9.)	☐	☐
6. A po derdh kontribute te fondi për kursimet e pensionit? (Shih kapitullin 11.)	☐	☐
7. A po punoj për ta eliminuar kredinë dhe huat për arsimin? (Shih kapitullin 10.)	☐	☐
Shkruajini përparësitë tuaja aktuale: _____		

Lexoni: Ju mund të zgjidhni të punoni për synime të tjera afatgjate përveç përparësisë suaj aktuale financiare, që mund të përfshijë kursimin për arsimin, një mision, një makinë, një shtëpi ose pushime familjare apo shpenzime për veprimtari të tjera. Do të ketë shumë tundime për të zgjedhur këndvështrimin afatshkurtër mbi këndvështrimin afatgjatë. Synimet mund t'ju japin një arsye për të thënë "jo" duke ju dhënë diçka për të parë drejt së ardhmes.

Diskutoni: Çfarë ju jep shtysë juve personalisht që të dëshironi të qëndroni brenda buxhetit tuaj?

2. GJENI NJË SISTEM PLANI FINANCIAR DHE PËRDORENI ATË

Lexoni: Ka shumë mjete dhe sisteme në dispozicion që t'ju ndihmojnë për administrimin e buxhetit dhe për kontrollimin e shpenzimeve tuaja. Sistemet e efektshme për planin financiar variojnë nga sisteme të thjeshta me laps e letër tek telefonat celularë dhe programet kompjuterike.

Ka dy mënyra kryesore për të paguar për të mira materiale dhe shërbime: me të holla në dorë ose pagesa elektronike. Secila nga këto metoda të përgjithshme ka të mirat dhe të këqijat e veta dhe do të ndikojë te mënyra se si ju e administroni buxhetin tuaj dhe i kontrolloni shpenzimet tuaja. Te disa pjesë të tjera, ne do të shqyrtojmë dy sisteme të zakonshme për planin financiar. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë të gjeni sistemin e duhur për vete.

Shihni: "The Envelope System" ["Sistemi me Zarf"], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 83.)



Shihni: "Digital Systems" ["Sistemet Dixhitale"], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 84.)



VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Ndahuni në grupe të vogla me nga dy deri në katër njerëz.

Hapi 2: Në grupe të vogla, lexojini nga tabela më poshtë të mirat dhe të këqijat që lidhen me çdo sistem për planin financiar.

Hapi 3: Diskutoni për të mirat dhe të këqijat shtesë që ju vijnë ndërmend dhe shkruajini ato tek tabela vijuese.

Hapi 4: Kthehuni sërish në grup. Ftojini një anëtar/e nga secili grup i vogël t'i tregojë të mirat dhe të këqijat shtesë të tij ose saj me të gjithë grupin.

KRAHASIMI I SISTEMEVE PËR ADMINISTRIMIN E BUXHETIT

SISTEMI	PRO	KUNDËR
ZARFI ME TË HOLLA	Kufizimet e qarta: ju e dini kur ju kanë mbaruar paratë e buxhetit	Proces tepër manual: duhet t'i organizoni të hollat tuaja pas çdo here që keni paguar; duhet të mbani shënime me shkrim
SISTEMET DIXHITALE	Informacion në kohë reale për buxhetin tuaj	Për disa njerëz mund të jetë e lehtë që t'i shpërfillin ose të harrojnë që t'i shënojnë apo t'i shqyrtojnë shpenzimet

Lexoni: Me cilëndo metodë, sigurohuni që ju:

- Të mos mashtroni duke e ndryshuar shumën e vendosur nga ju apo t'i merrni hua nga kategoritë e tjera. Të këshilloheni me bashkëshortin/en tuaj ose partnerin përgjegjës nëse nevojiten rregullime.
- T'i kontrolloni mirë të gjitha shpenzimet dhe t'i rregulloni kategoritë e buxhetit tuaj muajin tjetër sipas nevojës.

3. JINI PËRGJEGJËS PËR VETEN

Lexoni: Ju mund t'ia dilni mbanë që të qëndroni brenda buxhetit vetëm duke qenë përgjegjës për veten. Këshilli juaj i përjavshëm familjar mund të shërbejë si një mënyrë për t'i shqyrtuar synimet dhe buxhetin tuaj dhe për të bërë rregullime nëse është e nevojshme. Nëse e keni të vështirë që të jeni përgjegjës për veten, do të ishte gjë me mend t'ia raportoni përparimin tuaj dikujt tjetër – një miku, partnerit në veprim, këshilluesit ose këshilltarit financiar. Gjëja e rëndësishme është që ju të gjeni kohë për ta vlerësuar vazhdimisht përparimin tuaj dhe që të bëni ndryshime sipas nevojës.

Diskutoni: Përse është e rëndësishme që të jeni përgjegjës për veten? Si do të jeni përgjegjës për veten ndaj buxhetit tuaj?

4. KËRKONI NDIHMËN E ZOTIT DHE VAZHDONI TË PËRPIQENI

Lexoni: Kujtoni se kujdestaria financiare me besnikëri mund t'ju kërkojë që të ndryshoni këndvështrimin, zakonet dhe sjelljet tuaja. Besimi te Jezu Krishti dhe te Shlyerja e Tij do t'ju ndihmojë ta tejkaloni këtë shndërrim. Për shkak se këto ndryshime mund të çrrënjosin zakone të ngulura thellë dhe për shkak se plani financiar është një proces mësimi, ju mund të mos ia dilni hera-herës që të qëndroni brenda buxhetit tuaj.

Përveç kësaj, ju mund ta lëshoni dorën dhe të bëni blerje të rrëmbyera ose të hasni kriza financiare si humbja e punës, raste të ngutshme mjekësore ose kosto të paparashikuara për mirëmbajtjen. Ju do të mësoni se si të mblidhni një fond për raste të ngutshme dhe të përballoni kriza financiare në kapitujt e mëtejshëm por, tani për tani, është e rëndësishme të kujtoni se buxheti është i rregullueshëm dhe se për të qëndruar brenda buxhetit kërkohet këmbëngulje.

Kur të hasni pengesa te buxheti juaj, diskutojini ato në këshillin tuaj familjar dhe shqyrtojini pikat në buxhetin tuaj që kanë nevojë të rregullohen. Ndonëse mund të ndiheni i shkurajuar dhe gati për të hequr dorë nga qëndrimi brenda buxhetit, kujtoni se ju mund të vazhdoni të përpiqeni dhe duke u këshilluar me Zotin dhe duke kërkuar ndihmën e Tij, ju do të merrni fuqinë dhe aftësinë për të këmbëngulur në përpjekjet tuaja.

Diskutoni: Çfarë do të bëni kur të hasni pengesa te buxheti juaj?

DISKUTONI SE SI TË QËNDRONI BRENDA BUXHETIT NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Për të qëndruar brenda buxhetit kërkohet unitet me bashkëshortin/en dhe me familjen tuaj. Këtë javë, diskutoni rreth sistemeve të mundshme për planin financiar që mund të përdorni dhe mënyrat se si mund ta rregulloni buxhetin kur hasni vështirësi. Përveç kësaj, diskutoni për përparësinë tuaj financiare aktuale dhe synime të tjera afatgjate dhe planet tuaja për t'i arritur ato. Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë "Model Diskutimi Në Këshillin Familjar". Kujtoni, nëse nuk jeni i/e martuar, këshilli juaj familjar mund të përfshijë një shok/shoqe të dhomës, mik/mikeshë, pjesëtar/e të familjes ose këshillues/e.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Çfarë mund të bëni për ta përmirësuar buxhetin tuaj?
- Cila është përparësia juaj financiare aktuale? Diskutoni për vlerësimin në faqen 76.

Pjesa 2: Planifikoni

- Cilat janë përparësitë financiare dhe synimet tuaja afatgjate?
- Çfarë sistemi për planin financiar do të përdorni për të mbajtur një buxhet dhe për t'i kontrolluar shpenzimet?
- Si do t'i përmbaheni buxhetit tuaj dhe çfarë do të bëni nëse e kaloni atë?



MOS MERRNI PARA KUR DILNI NGA SHTËPIA

Unë dhe gruaja ime kuptuam se për një arsye apo një tjetër ne shpenzojmë gjithnjë më shumë për gjëra pa vlerë në fund të muajit; ndoshta për një shpërblim psikologjik a diçka e tillë. Kështu që krijuam rregullin tonë që të mos merrnim para kur të dilnim nga shtëpia për pesë ditët e fundit të muajit. Ne e quajmë atë 'java MONPASH [mos nxirr para nga shtëpia]' dhe na ka kursyer para dhe na ka ndihmuar ta planifikojmë më mirë pjesën e mbetur të muajit.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Kush nga ju, pra, kur do të ndërtojë një kullë, nuk ulet më parë të llogaritë koston, për të parë nëse ka mjaftueshëm për ta mbaruar?”
(Lluka 14:28).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- (A)** Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- (B)** Do të zgjedh një sistem plani financiar.
- (C)** Do të diskutoj se si të qëndroj brenda një buxheti në këshillin tim familjar.
- (D)** Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

SISTEMI ME ZARF

Sistemi me zarfi për të hollat është i thjeshtë: menjëherë pasi jeni paguar, ju e vendosni shumën e parave që keni ndarë për ta shpenzuar në secilën kategori buxhetore brenda zarfit përkatës.

Për shembull, të themi që keni vënë 400 dollarë te kategoria “artikujt ushqimorë” këtë muaj. Kur ta merrni pagesën e muajit ose javëve të ardhshme, depozitoheni shumën (në të holla) brenda një zarfi të emërtuar “Artikujt Ushqimorë”. Asnjë lek – dhe kjo nënkupton që asnjë lek – nuk do të dalë nga ai zarf, përveçse për të paguar për ushqim. Nëse shkoni në dyqan dhe zbuloni se e keni lënë zarfin në shtëpi, shkoni në shtëpi dhe merreni zarfin! Mbani shënim (në një bllok të thjeshtë shënimesh) të gjitha shpenzimet, në mënyrë që më vonë ta shqyrtoni atë gjatë këshillit tuaj familjar, që të kujtoheni se për çfarë po i shpenzoni paratë.

Në një zarf tjetër, vendoseni shumën buxhetore për shpenzimet tuaja të transportit. Ju do të nxirrni nga ky zarf i dytë sa herë është e përshtatshme pjesën që ju nevojitet për ato kosto dhe kontrolloni çdo shpenzim në bllokun tuaj të shënimeve.

Ndajeni secilën nga kategoritë tuaja të buxhetit në mënyrë të njëjtë: qiranë ose pagesat e kredive në një zarf; shërbimet komunale në një tjetër; të dhjetën dhe ofertat e agjërimit në një tjetër; pjesën mjekësore, sigurimet dhe kështu me radhë – secilën në zarfin e vet.

Sa herë që paguheni, depozitoheni pjesën e përshtatshme të shumës suaj mujore buxhetore në secilin zarf, në mënyrë që shuma totale e vendosur në secilin zarf çdo muaj të jetë shuma e përcaktuar në buxhetin tuaj të shkruar.

Mos shpenzoni më tepër para nga ajo që keni caktuar. Kur zarfi të zbrazet, duhet të mbetet me kaq! Nëse shpenzoni më tepër në atë kategori, do t’ju duhet t’i nxirrni paratë nga një zarf tjetër. Për dy muajt e parë, kjo do të kërkojë rregullime. Brenda asaj periudhe kohore ju duhet të merrni një ide më të saktë nëse shifrat buxhetore fillestare janë të përshtatshme – ju do ta zbuloni shumën mesatare reale gjatë dy muajve.

Disa e përdorin sistemin me zarf për gjithçka. Të tjerët e përdorin këtë sistem vetëm me të holla për ato kategori që i tundojnë ata ta tejkalojnë shumën ose për atë që është e lehtë ta humbasësh pasjen nën kontroll, si për ushqimin, restorantet, zbavitjen, karburantin dhe veshjet. Çdo gjë që mbetet duhet të shkojë për përparësinë tuaj financiare.

Kthehuni te faqja 77.

SISTEMET DIXHITALE

Nëse pasja e të hollave shtesë ju tndon të shpenzoni më shumë nga ç'mund të shpenzonit, atëherë përdorimi i një karte debiti mund të jetë mundësia juaj më e mirë. Sikundër metoda e zarfit me të holla, një kartë debiti tërheq para tashmë nga llogaria juaj bankare.

Kur përdorni një kartë debiti, është e vështirë të kontrolloni shpenzimet tuaja sepse, ndryshe nga sistemi i zarfit me të holla, një kartë debiti nuk ju mundëson kufizime të rrepta për shumën ndërmjet kategorive buxhetore. Ju mund t'i shënoni shpenzimet tuaja me laps dhe letër ose në një celular apo program kompjuterik.

Programe të shumta për administrimin financiar janë në dispozicion për celularë ose pajisje të tjera kompjuterike. Këto programe kompjuterike mund ta ruajnë dhe ta organizojnë për ju informacionin dhe ju më pas mund të hyni nga kompjuteri juaj në shtëpi ose edhe nga pajisje të tjera kompjuterike.

Shpenzoni pak kohë këtë javë për të bërë kërkime për programet më të mira kompjuterike në dispozicion në gjuhën dhe rajonin tuaj, duke përdorur terma kërkimorë si: "administrimi i parave", "mjete vetjake për financat" ose "programe buxhetore". Shumë programe vërtet të mira janë falas ose kushtojnë shumë pak.

Kujtoni, që ta mbani të sigurt informacionin tuaj, hyni tek informacioni vetjak financiar vetëm nga pajisjet tuaja private kompjuterike, jo nga kompjuterat publikë.

Kthehuni te faqja 78.

[illegible]

SHĚNIME



6

MBROJTJA E FAMILJES TUAJ NGA VËSHTIRËSITË

PARIMI NGA THEMELI IM

- Përdoreni Kohën me Mençuri

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Mbrojeni Familjen Tuaj nga Vështirësitë
2. Mblidhni një Fond Njëmuor për Raste të Ngutshme
3. Merrni Sigurime të Përshtatshme



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të zgjedh një sistem për planin financiar.
- Ⓒ Të diskutoj se si të qëndroj brenda një buxheti gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJËKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bën çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Përdorni mënyrën se si mund të vashdhen të përmirësohen telosa ushtrohen për formimin e këtyre zakonave të rëndësishme.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme					
Ë vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia	Mbaj një Këshill të Familjes	Vihe në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjermani Në Kontakt me Partnerin në Veprim	
Shembull Të jem i bindur	Rregullon shpenzimet	Këshillohuni mbi bindjen			
Javë 1 Mësojta të vëllatë dhe të miat për parimin	Rregullon shpenzimet	Këshillohuni me Zoti			
Javë 2 Të ushtroj besim të Jesus Krishtit	Rregullon shpenzimet	Këshillohuni mbi të ardhurat dhe shpenzimet			
Javë 3 Të përdorshem dhe të jem i bindur	Rregullon shpenzimet	Këshillohuni mbi të dhjetat dhe ofertat			
Javë 4 Të jem një jesh të baraspeshuar	Harroj një buxhet	Këshillohuni mbi bërjen e buxhetit			
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjedh një sistem për buxhetin	Këshillohuni mbi bërjen e buxhetit			
Javë 6 Të përdor kohën me mirënjohje	Çelësi para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi fondin për rastet të ngutshme, sigurimin			
Javë 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi borxhin			
Javë 8 Puna: Të marr përgjegjësi dhe të këmbëngul	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi borxhin			
Javë 9 Të komunikoj të bëj kërkesa dhe të dhigja	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi administrimin e rastit, veç veç veç			
Javë 10 Kërkësi të mësoj, vendosimi se ku po shkon dhe se si të arrij atje	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi kursimet, pronat dhe shpërndarjen			
Javë 11 Të bëhem një të shërbimit të bashku	Vendos para për një përparim financiar	Këshillohuni mbi planifikimin për pensionin			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë sistemi për planin financiar zgjodhët dhe përse? Çfarë veçorish të sistemit janë më të rëndësishmet për ju?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: PËRDORENI KOHËN ME MENÇURI

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Përse koha është një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë?

Shihni: “The Gift of Time” [“Dhurata e Kohës”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 91.)

Diskutoni: Çfarë mësuat nga motra Benkozi?

Lexoni: Alma 34:32 dhe citimin nga Presidenti Brigham Jang (në të djathtë)

“Pasi vini re, kjo jetë është koha për njerëzit që të përgatiten të takohen me Perëndinë; po, vini re, dita e kësaj jete është dita për njerëzit që të kryejnë punët e tyre.”

ALMA 34:32

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Me një partner, lexojini pesë hapat që mund të ndërmerrni çdo ditë për ta përdorur mirë kohën tuaj.

1	2	3	4	5
RENDITINI DETYRAT	LUTUNI	VENDOSINI PËRPARËSITË	VENDOSNI SYNIME, VEPRONI	RAPORTONI
Çdo mëngjes, bëni një listë me detyrat që duhen bërë. Shtoni emra të njerëzve që duhet t’u shërbeni.	Lutuni për udhërrëfim. Shqyrtojeni listën tuaj të detyrave. Dëgjoni. Zotohuni për të bërë më të mirën tuaj.	Në listën tuaj të detyrave, vini një 1-sh pranë detyrës më të rëndësishme, një 2-sh pranë detyrës tjetër më të rëndësishme, e kështu me radhë.	Dëgjojeni Shpirtin. Vendosni synime. Punoni fort. Filloni me detyrën më të rëndësishme e vazhdoni deri në fund të listës.	Çdo natë, raportojini Atit Qiellor në lutje. Bëni pyetje. Dëgjoni. Pendohuni. Ndiejeni dashurinë e Tij.

Hapi 2: Në një copë letre të veçantë, renditni detyrat tuaja. Këto duhet të jenë detyra të rëndësishme për punën tuaj, për shkollimin tuaj, për kishën apo shërbimin familjar – jo vetëm punët e përditshme të shtëpisë. Lutuni rreth listës suaj dhe renditni përparësitë në të.

Hapi 3: Nesër ju duhet të vendosni synime, të veproni dhe të raportoni se si e keni përdorur kohën tuaj.

“Koha është gjithë fondi i kapitalit që gjendet këtu në tokë. . . . Nëse përdoret siç duhet, ajo sjell atë çfarë do ta shtojë ngushëllimin, volinë dhe kënaqësinë tuaj. Le ta marrim parasysh këtë e të mos rrimë më ulur duarkryq, duke e çuar kohën dëm.”

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- ☐ Ushtroni këta hapa çdo ditë për ta përdorur kohën tuaj më me mençuri. Çdo natë, raportojini Atit Qiellor në lutjet tuaja.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth përdorimit të kohës me mençuri.

BRIGHAM YOUNG,
në *Discourses of Brigham Young*,
përzgj. John A. Widtsoe (1954),
f. 214

DHURATA E KOHËS

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, zgjidhni rolet dhe lexojeni këtë skenar.



KOFI: Përshëndetje, motra Benkozi. Si je?

MOTRA BENKOZI: A je mirë, Kofi?

KOFI: O, motra Benkozi. Jam kaq i zënë. Duhet të punoj dhe të shërbej e ta ndihmoj familjen time . . . dhe pastaj kam edhe futboll. Nuk kam kohë!

MOTRA B.: Kofi, ti ke gjithë kohën në dispozicion.

KOFI: Çfarë?

MOTRA B.: Biri im, Perëndia na ka dhënë një dhuratë të madhërishtme – kohën tonë. Ne duhet të bëjmë me të atë që ka më shumë rëndësi.

KOFI: Por si, motra Benkozi? Ti gjithnjë ke bërë kaq shumë gjëra. Ia ke dalë mbanë me familjen tënde, me biznesin tënd. Ti u ke shërbyer e ke bekuar shumë njerëz, si unë. Nuk e di se si ia del.

MOTRA B.: Dëshiron vërtet ta dish? Nëse do të qëndrosh ulur e të dëgjosh, do të ta tregoj sekretin tim.

Çdo mëngjes unë ngrihem përpara lindjes së diellit. Vishem dhe laj fytyrën e duart e mia.

I lexoj shkrimet e shenjta. Pastaj bëj një listë me ato që duhet të bëj atë ditë.

Mendoj se kujt mund t'i shërbej. Lutem për të ditur vullnetin e Perëndisë. Dhe dëgjoj.

Ndonjëherë, emrat ose fytyrat e njerëzve më vijnë në mendje. I shtoj ata në listën time.

KOFI: A është kjo mënyra se si ti e di gjithnjë saktësisht se kush ka nevojë për shërbimin tënd?

MOTRA B.: Po, Kofi. Dhe unë lutem për forcë e urtësi. Unë lutem që Perëndia ta “shenjtërojë kryerj[en time]”. Ajo thuhet te 2 Nefi 32.

Unë e falënderoj Atë. I premtoj se do të bëj më të mirën time. I kërkoj që Ai të bëjë atë që unë nuk mundem.

Pastaj e vështroj listën time. Vë një 1-sh pranë gjësë më të rëndësishme, pastaj një 2-sh.

KOFI: Nga i di përparësitë?

MOTRA B.: Unë mbaj vesh kur lutem! Pastaj shkoj në punë. Vështroj numrin 1 dhe përpiqem ta bëj të parin, pastaj numrin 2.

Ndonjëherë gjërat ndryshojnë. Fryma e Shenjtë më thotë të bëj diçka tjetër. Ajo është gjë e mirë.

Unë punoj shumë fort, por kam paqe. E di se Perëndia do të më ndihmojë.

Prandaj, me listën dhe Shpirtin, unë bëj atë që ka rëndësi, Kofi.

KOFI: Kjo duket e thjeshtë dhe e vështirë në të njëjtën kohë.

MOTRA B.: Ke të drejtë! Kur më në fund përgatitem për shtrat, unë lutem. I raportoj Atit Qiellor. I them si shkoi dita. I bëj pyetje. E pyes se çfarë mund të bëj më mirë. Dëgjoj. Shpesh e ndiej dashurinë e Tij. E di se Ai e lartëson atë që përpiqem të bëj. Më pas kam paqe, Kofi, dhe fle.

KOFI: Ajo është gjë e mirë, nënë Benkozi. Unë e dëshiroj këtë paqe. Dëshiroj ta përdor kohën time. Dëshiroj të punoj e të shërbej më mirë.

Kthehuni te faqja 90.



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

2

**MBROJENI FAMILJEN TUAJ
NGA VËSHTIRËSITË**



**HARTA E SUKSESIT PËR
KUJDESTARINË FINANCIARE**

1. MBROJENI FAMILJEN TUAJ NGA VËSHTIRËSITË

Lexoni: Përgatitja është një parim i fuqishëm i ungjillit. Zoti premton se, “nëse jeni të përgatitur, ju s’do të frikësoheni” (DeB 38:30).

Pas detyrimit tonë për t’i paguar Zotit të parit me anë të së dhjetës dhe ofertave të tjera, detyrimi ynë i dytë është të punojmë për ta mbrojtur familjen tonë nga vështirësitë. Ne mund ta bëjmë këtë vetëm nëse zhvillojmë një këndvështrim afatgjatë. Në këtë kapitull ne do të mësojmë dy hapa për ta mbrojtur familjen tonë nga vështirësitë financiare:

- Zhvilloni një fond njëmuor për raste të ngutshme
- Merrni sigurime të përshtatshme

Diskutoni: Harxhoni pak minuta që të shikoni Hartën e Suksesit për Kujdestarinë Financiare. Si mendoni, përse mbrojtja e familjes suaj nga vështirësitë është përparësia e dytë pas pagimit të së dhjetës dhe ofertave?

2. MBLIDHNI NJË FOND NJËMUOR PËR RASTE TË NGUTSHME

Lexoni: Duke i kontrolluar shpenzimet tuaja për të paktën katër javë, ju tani duhet ta keni përcaktuar shumën e parave që kërkohet për vlerën e një muaji për shpenzimet e jetesës. Fondi juaj njëmuor për raste të ngutshme duhet të jetë i barabartë me këtë shumë.

Për fondin tuaj njëmuor për raste të ngutshme, ju duhet të kurseni të holla në një vend të sigurt dhe të arritshëm, e tillë si një llogari bankare. Mos i përdorni këto para për asgjë tjetër përveç rasteve të ngutshme. Nëse keni një rast të ngutshëm dhe duhet t’i përdorni paratë nga fondi juaj njëmuor për raste të ngutshme, filloni menjëherë të hidhni sërish para te fondi derisa ta keni plotësuar. Pastaj, pasi ta keni paguar të gjithë borxhin tuaj konsumator, ju do të filloni të kurseni mjaftueshëm para për të mbuluar shpenzimet tuaja për tre deri në gjashtë muaj (ne do ta trajtojmë këtë hap në kapitullin 9).

Ju duhet të punoni për të mbledhur një fond njëmuor për raste të ngutshme sa më shpejt të jetë e mundur. Vendosini ato para shtesë që keni te fondi juaj për raste të ngutshme derisa të plotësohet. Edhe nëse keni borxhe, bëni vetëm pagesën minimale të borxhit që kërkohet derisa të keni mbledhur një fond njëmuor për raste të ngutshme. Për t’ju

ndihmuar që ta përshpejtoni këtë proces, ju mund të doni të gjeni punë shtesë ose një punë më të mirë, të shitni disa gjëra pa të cilat mund të jetoni, ose të eliminoni disa shpenzime të panevojshme.

Diskutoni: Çfarë bekimesh mund t'i vijë familjes suaj prej pasjes së një fondi njëmu-
jor për raste të ngutshme? Përse duhet të mblidhni një fond për raste të
ngutshme përpara se ta paguani borxhin?

3. MERRNI SIGURIME TË PËRSHTATSHME

Lexoni: Si do të ndikonte financiarisht te ju ose familja juaj nëse njëri nga ju do të sëmurej rëndë ose do të bëhej i paaftë fizikisht apo qoftë të ndërronte jetë? Çfarë ndikimi financiar do të kishte diçka si rënia e zjarrit në shtëpi ose një aksident i rëndë automobilistik? Këto lloj vështirësish ndodhin dhe nëse nuk jemi të përgatitur, ato mund të shkaktojnë probleme madhore financiare. Një burim i mirë mbrojtjeje kundër vështirësive të mundshme është sigurimi. **Sigurimi** është një marrëveshje në të cilën një organizatë (zakonisht një agjenci sigurimi) garanton ta dëmshpërblejë një individ për vështirësi të caktuara kundrejt një pagese të pandryshueshme.

Presidenti N. Eldon Taner dha mësim: "Asgjë nuk duket kaq e sigurt sa gjërat e papritura në jetën tonë. Me kostot mjekësore gjithnjë e në rritje, sigurimi i shëndetit është e vetmja mënyrë me anë të të cilit shumica e familjeve mund të përballojë aksidente të rënda, sëmundje ose kosto për shtatzëninë. . . . Sigurimet për jetën sigurojnë të ardhura në vazhdimësi kur paguesi vdes para kohe. Çdo familje duhet të derdhë para për shëndetin dhe sigurimin e duhur për jetën" ("Constancy amid Change", *Ensign*, nëntor 1979, f. 82).

Diskutoni: Përse janë sigurimet kaq vendimtare? Çfarë bekimesh mund të vijë nga pasja e një sigurimi të përshtatshëm?

Dobia e Sigurimeve

Lexoni: Sigurimet mund t'ju ndihmojnë që të mbroheni nga rrënimi financiar që mund të sjellin aksidentet dhe vështirësitë e tjera.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Si grup shqyrtojini dy skenarët më poshtë. Pastaj diskutoni se si sigurimet ishin dobiprurëse në këto situata.

Skenari 1: U përfshive në një aksident automobilistik dhe ishte faji yt. Makina juaj u dëmtua rëndë po ashtu edhe makina e shoferit tjetër. Si ju edhe shoferi tjetër morën disa dëmtime dhe iu duhej të merrnit kujdes mjekësor. Kostoja e përgjithshme për t'i riparuar të dyja automjetet dhe për të paguar faturat mjekësore shkojnë mbi 15 000 dollarë.

	PA SIGURIME	ME SIGURIME
Kostoja e përgjithshme	15 000	15 000
Kostoja e mbuluar nga sigurimi	0	12 000
Kostoja që duhet të mbuloni	15 000	3 000

Skenari 2: Një baba në moshën 45-vjeçare ka punuar si elektrikist dhe ka fituar 3 500 dollarë në muaj. Ai është sigurveksi i vetëm i të ardhurave për gruan dhe tre fëmijët e tij. Ai dëmtoi kurrizin dhe nuk do të jetë më në gjendje të punojë si elektrikist. Nuk do të fitojë para derisa të mund të gjejë një punë tjetër, e cila mund të kërkojë shkollim ose trajnime të tjera.

	PA SIGURIME	ME SIGURIME
Të ardhurat mujore nga punësimi	0	0
Të ardhurat mujore nga sigurimi	0	3 000
Të ardhurat mujore gjithsej	0	3 000

Lloji i Sigurimit

Lexoni: Ju nuk keni nevojë t'i siguronit të gjitha gjërat – ja përse po mblidhni një fond për raste të ngutshme dhe kursime të tjera. Sidoqoftë, është e rëndësishme që ju ta mbronit veten nga vështirësitë që mund të jenë rrënuese nga ana financiare. Presidenti Marion G. Romney dha mësim se, “ne jemi . . . këshilluar [të] kemi një rezervë të hollash për të përballuar rastet e ngutshme dhe për të marrë sigurimin e përshtatshëm për shëndetin, shtëpinë dhe jetën” (“Principles of Temporal Salvation”, *Ensign*, prill 1981, f. 6).

Ka shumë lloje sigurimesh, por katër më të zakonshmit janë këto:

- **Sigurimi për pronën:** Sigurimi për pronën, si pronarët e shtëpive, qiradhënësit dhe sigurimi për automjetin, mund të ndihmojë që të mbulojë koston për ta zëvendësuar ose riparuar pronën në rast dëmtimi serioz, vjedhjeje ose shkatërrimi.
- **Sigurimi për shëndetin:** Sigurimi për shëndetin mund të ndihmojë që të mbulojë koston e kujdesit shëndetësor, që nga vizitat e duhura mjekësore dhe trajtimin e sëmundjeve deri në pagimin e ngjarjeve madhore mjekësore. Në varësi të vendndodhjes suaj, kujdesi mjekësor mund të jetë një shërbim shtetëror dhe nevoja juaj për sigurimin e shëndetit mund të ndryshojë.
- **Sigurimi për jetën:** Sigurimi për jetën i siguron një familjeje një shumë parash nëse një pjesëtar i siguar i familjes vdes.
- **Sigurimi për paaftësinë fizike:** Sigurimi për paaftësinë fizike garanton se një pjesë e të ardhurave të personit të siguar do të paguhet nëse ai ose ajo bëhet i paaftë nga ana fizike dhe nuk është në gjendje të punojë për një periudhë të gjatë kohe.

VEPRIMTARIA (3 minuta)

Bashkohuni me bashkëshortin/en ose partnerin në veprim dhe tregoni se si e kuptoni sigurimin për pronën, shëndetin, jetën dhe për paaftësinë fizike. Diskutoni se çfarë lloj mbulimesh nga sigurimet do të ishin të rëndësishme për ta pasur në rrethanat tuaja.

Kostot e Sigurimeve

Lexoni: Tani që kemi një kuptim bazë për sigurimet dhe për disa prej përfitimeve të tyre të mundshme, le të diskutojmë për disa nga kostot. Dy llojet kryesore të kostove ose shpenzimeve të lidhura me sigurimet janë sigurimet prim dhe me përqindje të zbritur.

Sigurimi me pagesë **periodike** përfaqëson çmimin e sigurimeve – ose paratë që paguani direkt (shpesh mujore ose vjetore) ndaj kompanisë së sigurimeve kundrejt një mbulimi.

Një sigurim me përqindje **të zbritur** përfaqëson shumën e parave që paguani kundrejt shpenzimeve tuaja (të tilla si shpenzime mjekësore ose kostot për riparimin e automjetit) përpara se kompania e sigurimeve të mbulojë shpenzimet e mbetura.

Analiza Kosto- Përfitimet

Lexoni: Kur krahasoni skemat e sigurimeve, ju kryesisht po përpiqeni të krahasoni se sa mund të kushtojë mundësisht skema kundrejt asaj që mund të sigurohet në mbulim. Mund të jetë e dobishme të krahasoni skenarin me rastin më të mirë me atë më të keq.

Kosto Vjetore Minimale (Skenari me Rastin më të Mirë)

Për të llogaritur koston vjetore minimale, thjesht shumëzoni shumën tuaj periodike mujore me 12 muaj (12 x shumën periodike mujore), ose shikoni shumën periodike vjetore nëse faturoheni vetëm një herë në vit. Ky skenar supozon se ju nuk keni një rast të siguar në vit.

Kosto Vjetore Maksimale (Skenari me Rastin më të Keq)

Për të llogaritur koston vjetore maksimale, shtojani koston tuaj vjetore minimale kostove vjetore me përqindje të zbritur. $([12 \times \text{shumën mujore prim}] + \text{me përqindje të zbritur})$. Ky skenar supozon se shpenzimet për rastin e siguar e kalojnë koston tuaj vjetore me përqindje të zbritur.

Me këtë informacion tani ju mund të krahasoni gamën e shpenzimeve për skema të ndryshme. Shembulli vijues tregon një mënyrë se si ju mund të krahasoni skemat.



USHTRIM ME MAKINË LLOGARITËSE

Hapi 1: Ndahuni në grupe të vogla me nga dy deri në katër njerëz.

Hapi 2: Lexojeni skenarin vijues me një grup të vogël. Çdonjëri në grup duhet të përdorë makinën e vet llogaritëse si të udhëzohet. Ndhimoheni njëri-tjetrit si të jetë nevoja dhe sigurohuni që çdo person të jetë në gjendje të marrë përgjigjet e saktë.

Shënim: Shihni pjesën “Burimet” në fund të kapitullit për përgjigjet.

Lexoni: Përfytyroni sikur jeni duke krahasuar skemat për sigurimet të dy qiradhënësve: një skemë me përqindje të zbritur të lartë prej 2 000 dollarësh që kushton 10 dollarë çdo muaj dhe një skemë me përqindje të zbritur të ulët prej 500 dollarësh që kushton 40 dollarë çdo muaj.

Llogarit: Çdo person në grup duhet të llogaritë kostot vjetore minimale dhe maksimale për secilën skemë. Shkruajini përgjigjet tuaja më poshtë.

	KOSTOJA VJETORE MINIMALE	KOSTOJA VJETORE MAKSIMALE
Skema me përqindje të zbritur të lartë		
Skema me përqindje të zbritur të ulët		

Llogarit: Sa para do t’ju kursejë skema me përqindje të zbritur të lartë, në skenarin me rastin më të mirë (duke supozuar që paguani vetëm koston vjetore minimale)? Shkruani përgjigjen tuaj më poshtë.

Përgjigja: _____

E dhënë: (Kostoja vjetore minimale për skemën me përqindje të zbritur të ulët) –
(Kostoja vjetore minimale për skemën me përqindje të zbritur të lartë)

Lexoni: Lexoni se në skenarin me rastin më të mirë, skema me përqindje të zbritur të lartë do t'ju kursejë 360 dollarë. Kjo do të thotë që edhe nëse ju duhet të nxirrni nga xhepi deri në 360 dollarë për shpenzimet në lidhje me pronën e qiradhënësit, prapëseprapë kushton më pak nëse ndiqni skemën me përqindje të zbritur të lartë, për këtë situatë. Megjithatë, kjo nuk është e vërtetë në rastin me skenarin më të keq.

Llogarit: Sa para do t'ju kursejë skema me përqindje të zbritur të ulët në skenarin me rastin më të keq (duke supozuar se do t'ju duhej të paguanit kostot vjetore maksimale)? Shkruani përgjigjen tuaj më poshtë.

Përgjigjja: _____

E dhënë: (Kostoja vjetore maksimale për skemën me përqindje të zbritur të lartë)
– (Kostoja vjetore maksimale për skemën me përqindje të zbritur të ulët)

Lexoni: Në skenarin me rastin më të keq, ku ju duhej të paguanit koston vjetore maksimale, ju do të shpenzonit pothuajse të paktën sa dyfishi i (1 000 dollarëve) duke zgjedhur skemën me përqindje të zbritur të ulët. Ndërsa përpiqeni të vendosni midis skemave dhe mundësive për sigurimet, merreni parasysh situatën tuaj ose atë të familjes suaj me qëllim që të zgjidhni skemën që i plotëson më mirë nevojat tuaja.

Shqyrtimi i Përfitimeve të Tjera

Lexoni: Te veprimtaria që sapo përfunduat, ne po vlerësonim një lloj skeme për sigurimin e pronës (sigurimin e qiradhënësve). Ne mund të përdorim po të njëjtin proces kur krahasojmë lloje të tjera sigurimesh. Megjithatë, shpesh ka edhe faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh, përtej shpenzimeve të mundshme minimale dhe maksimale. Këtu kemi disa pyetje shtesë për të bërë kur të analizojmë skemat e ndryshme për sigurimet:

- Çfarë shërbimesh apo ngjarjesh mbulohen?
- Cilat janë llojet dhe kufizimet e mbulimit?
- Çfarë nami ka kompania e sigurimeve?
- A mund të kualifikohem për të marrë ulje?
- Sa mundësi ka që ju të paguani me përafërsi vetëm shpenzimet minimale nga xhepi?
- Sa mundësi ka që ju të paguani shpenzimet maksimale nga xhepi?

DISKUTONI RRETH FONDIT PËR RASTE TË NGUTSHME NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Në këshillin tuaj familjar këtë javë, diskutoni rreth mënyrave se si të mblidhni fondin tuaj njëmuajor për raste të ngutshme. Përcaktoni gjithashtu se cilat skema për sigurimet janë të rëndësishme për familjen tuaj dhe kërkon për policat e sigurimeve. Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar”.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Si po ecni me ndjekjen e buxhetit tuaj?
- A keni sigurime të përshtatshme? Për çfarë policash të sigurimeve keni nevojë në rrethanën tuaj?

Pjesa 2: Planifikoni

- Nëse nuk keni sigurime të përshtatshme, çfarë mbulimesh sigurimi duhet të merrni? Zhvilloni një analizë kosto-përfitim për skemat në dispozicion (shih faqet 97–98).
- Çfarë mund të bëni për të mbledhur sa më shpejt fondin tuaj njëmuajor për raste të ngutshme?



KONTROLLI VJETOR

Dikur kam shitur sigurime dhe i di që përqindjet rriten me kalimin e kohës. Tani nuk shes më sigurime por i krahasoj përqindjet e skemave për sigurimet çdo vit që të sigurohem se po bëj marrëveshjen më të mirë. Çdo muaj nëntor i shqyrtoj skemat e mia dhe marr kuota nga kompani të tjera. Kjo i mban kostot e mia sa më të ulëta të jetë e mundur.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Vër në vijë punët e tua të jashtme, vër në rregull arat e tua dhe pastaj ndërto shtëpinë tënde” (Fjalët e Urta 24:27).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do të filloj të mbledh fondin tim njëmuor për raste të ngutshme dhe të kërkoj për mundësi të përshtatshme sigurimi.
- Ⓒ Do të diskutoj në lidhje me fondin tim për raste të ngutshme dhe skemat e sigurimeve në këshillin tim familjar.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET



PËRGJIGJET E VEPRIMTARISË PËR LLOGARITJE

Llogarit: Çdo person në grup duhet të llogaritë kostot vjetore minimale dhe maksimale për secilën skemë. Shkruajini përgjigjet tuaja më poshtë.

	KOSTOJA VJETORE MINIMALE	KOSTOJA VJETORE MAKSIMALE
Skema me përqindje të zbritur të lartë	$12 \times 10 = 120$	$120 + 2\,000 = 2\,120$
Skema me përqindje të zbritur të ulët	$12 \times 40 = 480$	$480 + 500 = 980$

Llogarit: Sa para do t'ju kursejë skema me përqindje të zbritur të lartë, në skenarin me rastin më të mirë (duke supozuar që paguani vetëm koston vjetore minimale)? Shkruani përgjigjen tuaj më poshtë.

Përgjigjja: $480 - 120 = 360$

E dhënë: (Kostoja vjetore minimale për skemën me përqindje të zbritur të ulët)
– (Kostoja vjetore minimale për skemën me përqindje të zbritur të lartë)

Llogarit: Sa para do t'ju kursejë skema me përqindje të zbritur të ulët në skenarin me rastin më të keq (duke supozuar se do t'ju duhej të paguanit kostot vjetore maksimale)?

Përgjigjja: $2\,120 - 980 = 1\,140$

E dhënë: (Kostoja vjetore maksimale për skemën me përqindje të zbritur të lartë)
– (Kostoja vjetore maksimale për skemën me përqindje të zbritur të ulët)

[illegible]

SHĚNIME

[illegible]



7

TË KUPTUARIT E BORXHIT

PARIMI NGA THEMELI IM

- Tregoni Integritet Moral

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Kuptojeni Borxhin
2. Kuptojeni Situatën e Vërtetë të Borxhit Tuaj
3. Kini Dëshirën për të Dalë nga Borxhi
4. Mposhteni "Njeri[un e] Natyrshëm"



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të filloj të mbledh fondin tim njëmuor për raste të ngutshme.
- Ⓒ Të diskutoj në lidhje me fondin për raste të ngutshme dhe skemat për sigurimet në këshillin familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën "Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia" në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA				
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Partneri më mbështet se si mund të veshkohen të përmendshmet të cilat u shprehën për formimin e këtyre zotimeve të rëndësishme.				
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Modëratë ● Përpjekje të Rëndësishme				
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj partnerit Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administron Financat e Mia	Ⓒ Mblodh rreth Mëkë të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjurmë: Niveli i Partnerit në Veprim
Shembull: T'jam vë bënur	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi bërjen		
Javë 1 Mblodh rreth të vepra të tjerë rreth qendrës shpenzimet	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi Zotim		
Javë 2 Të ushtroj basim në ju (kërkë)	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi të ardhurat dhe shpenzimet		
Javë 3 Të përdorim dhe të jemi me fondin	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi të shpenzuar dhe ofertat		
Javë 4 Të jetoj rreth për të bashkëpunuar	Harroj rreth bërjen	Kërkohet mbi bërjen e bërjen		
Javë 5 Të ushtroj përdorim	Zgjedh rreth basim për bërjen	Kërkohet mbi bërjen e bërjen		
Javë 6 Të përdorim kushin me mangut	Cartë para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi fondin për raste të ngutshme, sigurim		
Javë 7 Të ushtroj integritet moral	Vendos para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi bërjen		
Javë 8 Puna: Të marr përgjegjësi dhe të bashkëpunoj	Vendos para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi bërjen		
Javë 9 Të komunikoj: Të bëj kërkesa dhe të shpreh	Vendos para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi administrimin e rasteve të tjerë		
Javë 10 Harroj të mësoj: Vendojmë se ku po shkon dhe se si të arrijmë atje	Vendos para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi kushtet, prirjet dhe shprehjet, arsimet		
Javë 11 Të bashkoj rreth, të shprehim të bashkoj	Vendos para për rreth përparës financiare	Kërkohet mbi përdorim për përdorim		

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecnit rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë keni bërë ndryshe për të kursyer para për fondin tuaj njëmuja për raste të ngutshme?
 - Si shkoi diskutimi për skemat e sigurimeve dhe mbledhjen e një fondi për raste të ngutshme në këshillin tuaj familjar?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: TREGONI INTEGRITET MORAL

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Përse i do Zoti ata që kanë “integritet të zemrës”?

Shihni: “What Shall a Man Give in Exchange for His Soul?” [“Çfarë do të japë Njeriu si Shkëmbim të Shpirtit të Vet?”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 111.)

Diskutoni: Çfarë do të thotë të kesh integritet moral? Cilat janë disa mënyra të vogla në të cilat njerëzit japin shpirtat e vet për të marrë gjëra në këtë jetë?

Lexoni: Nenet e Besimit 1:13; Jobit 27:5 (në të djathtë)

VEPRIMTARIA

Në mënyrë të pavarur, vlerësojeni veten në fushat e mëposhtme.

VENDOSNI NJË NUMËR PËRPARA ÇDO PIKE PËR TË TRE-GUAR SE SA SHPESH VEPRONI NË KËTË MËNYRË

1 = kurrë, 2 = nganjëherë, 3 = shpesh, 4 = gjithnjë

- _____ 1. I mbaj të gjitha premtimet, zotimet dhe besëlidhjet e mia.
- _____ 2. Jam tërësisht i vërtetë në gjërat që them dhe në shënimet që mbaj.
- _____ 3. Nuk e teproj që t’i bëj gjërat të duken më të mira seç janë.
- _____ 4. E kthej çdo gjë që marr hua dhe nuk marr gjëra që nuk më përkasin.
- _____ 5. Jam tërësisht besnik ndaj bashkëshortit/es tim/sime në fjalët dhe veprimet e mia.
- _____ 6. Nuk mashtroj kurrë, edhe kur e di që nuk do kapem papandehur.
- _____ 7. Kur gjej diçka që nuk është e imja, ia kthej të zotit.
- _____ 8. Gjithmonë e shlyej borxhin e marrë.

Diskutoni: Lexoni te Mosia 4:28 (në të djathtë) dhe citimin nga Plaku Jozef B. Uirthlin (në faqen 111). Përse është shlyerja e një borxhi ose huaje biznesi apo studentore (e tillë si një hua nga FQA-ja) një çështje e integritetit moral vetjak?

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- ☐ Përmirësoni një nga tetë fushat që vlerësuat më sipër.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth integritetit moral.

“Ne besojmë në qenien të ndershëm.”

NENET E BESIMIT 1:13

“Deri në regëtimat e fundit nuk do të heq dorë nga ndershmëria ime.”

JOBIT 27:5

“Dhe unë do të doja që ju të mbanit mend se kushdo mes jush, që merr hua nga fqinji i tij duhet t’ia kthejë gjënë që ai ka marrë hua, sipas asaj që bini dakort, përndryshe do të bëni mëkat; dhe ndoshta do të shkaktoni që fqinji të bëjë mëkat gjithashtu.”

MOSIA 4:28

ÇFARË DO TË JAPË NJERIU SI SHKËMBIM TË SHPIRTIT TË VET?

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PLAKU ROBERT C. GEI: Shpëtimtari një herë u bëri dishepujve të Tij pyetjen në vijim: “Çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?”

Kjo është një pyetje që im atë më mësoi ta mendoja me maturi vite më parë. Ndërsa po rritesha, prindërit e mi më caktuan punë të përditshme përreth shtëpisë dhe më paguanin një shumë të vogël të hollash për atë punë. Shpesh ato para, pak më shumë se 50 qindarka në javë, i përdorja për të shkuar në kinema. Atëherë një biletë filmi kushtonte 25 qindarka për një 11-vjeçar. Më mbeteshin 25 qindarka për t’u shpenzuar me ëmbëlsira, që kushtonin 5 qindarka copa. Një film me pesë ëmbëlsira! Më mirë se kaq nuk bëhej.

Çdo gjë shkoi mirë derisa mbusha 12 vjeç. Një pasdite duke qëndruar në radhë, mora vesh se çmimi i biletës për një 12-vjeçar ishte 35 qindarka dhe kjo do të thoshte dy ëmbëlsira më pak. Jo shumë i përgatitur për ta bërë atë sakrificë, unë arsyetova me vete: “Ti dukesh njëlloj si një javë më parë”. Më pas hipa lart dhe kërkova një biletë 25 qindarkëshe. Sportelisti nuk më pa fare me sy hetues dhe unë bleva pesë ëmbëlsirat e mia të zakonshme në vend që të blija tri.

Më vonë, i ngazëllyer nga arritja ime, nxitova në shtëpi për t’i treguar tim eti për suksesin tim të madh. Kur po i tregoja hollësitë, ai nuk tha asgjë. Kur mbarova, ai thjesht më pa dhe tha: “Bir, a do të shisje shpirtin për një monedhë pesëqindarkëshe?” Fjalët e tij më therën në zemrën time 12-vjeçare. Është një mësim që nuk e kam harruar kurrë.

(“Çfarë do të Japë Njeriu si Shkëmbim të Shpirtit të Vet?” *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 34)

Kthehuni te faqja 110.

“Integritet moral do të thotë të bëjmë gjithmonë atë që është e drejtë dhe e mirë, pavarësisht nga pasojat e menjëhershme. Do të thotë të jemi të drejtë nga vetë thellësia e shpirtit tonë, jo vetëm në veprimet tona por, më e rëndësishmja, në mendimet tona dhe në zemrat tona. . . . Pak gënjeshtria, pak mashtrim ose marrja e një përfitimi të vogël të padrejtë, nuk janë të pranueshme për Zotin. . . . Shpërblimi i përkryer i integritetit moral është shoqërimi i vazhdueshëm i Frymës së Shenjtë, . . . [i cili do të] na udhërrëfjëjë në gjithçka bëjmë.”

JOSEPH B. WIRTHLIN,
“Personal Integrity”,
***Ensign*, maj 1990, f.**
30, 32, 33



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

3

ELIMINONI BORXHIN



HARTA E SUKSESIT PËR KUJDESTARINË FINANCIARE

1. KUPTOJENI BORXHIN

Lexoni: Borxhi është të marrësh hua para që nuk janë të tuat. Zakonisht vjen me një çmim, i njohur si interes. Interesi është një përqindje e shumës së marrë borxh. Ju përfundoni duke paguar më tepër nga ajo që keni marrë hua, ndonjëherë shumë më shumë. Borxhet vijnë me pagesa që priten dhe me një pritshmëri të përgjithshme për t'i kthyer të gjitha paratë që keni marrë hua plus interesin.

Diskutoni: Përse marrin njerëzit para hua?

Lexoni: Profetët na kanë këshilluar gjithnjë që ta shmangim borxhin. Presidenti Hiber J. Grant dha mësim: “Nëse ka ndonjë gjë që do të sjellë paqe dhe ngazëllim në zemrën njerëzore, dhe në familje, është të jetojmë brenda mundësive tona. E nëse ka ndonjë gjë që është gërryese, shkurajuese dhe dëshpëruese, është të kemi borxhe dhe detyrime që nuk mund t’i paguajmë” (*Gospel Standards: Sermons and Writings of Heber J. Grant*, përmb. G. Homer Durham [1941], f. 111).

Gjatë dy kapitujve të radhës ju do të mësoni të ndiqni këshillën e profetit për të dalë nga borxhi.

Përsiatni: Harxhoni dy minuta për të shqyrtuar vendimet financiare që keni marrë, të cilat kanë shkuar për keq. Cilat ishin pasojat? Për sa kohë ia ndiet ndikimin? Si ndikoi borxhi te ju, te martesja ose te familja juaj dhe tek aftësia juaj për t’u shërbyer të tjerëve?

Shmangeni Borxhin

Lexoni: Profetët kanë këshilluar se ka shumë pak arsye të justifikueshme për të hyrë në borxh dhe se kur ju e merrni borxhin, duhet ta shlyeni sa më shpejt të jetë e mundur. Presidenti Gordon B. Hinkli dha mësim se “një borxh i arsyeshëm për blerjen e një shtëpie që mund ta përballoni dhe ndoshta për disa gjëra të tjera të nevojshme është i pranueshëm. Por nisur nga pozicioni im, unë shoh në një mënyrë kaq të qartë tragjeditë e tmerrshme të shumë njerëzve që pa u menduar mirë kanë marrë hua para për gjëra që nuk i kanë të nevojshme” (“I Believe”, *Ensign*, gusht 1992, f. 6).

Në varësi të rrethanave, borxhi mund të jetë i pranueshëm për shpenzimet vijuese:

- Një shtëpi të thjeshtë, të përballueshme
- Shpenzime të arsyeshme për arsimimin që do t’ju çojnë në një punë më të mirë
- Mjet të thjeshtë, transporti (vetëm nëse është e nevojshme)

Mundësisht ju duhet ta shmangni futjen në borxh për gjëra të tjera nga këto. Në vend të kësaj, kurseni për shpenzimet.

Përsiatni: Harxhoni dy minuta për të menduar rreth pyetjes vijuese dhe shkruani mendimet tuaja: Çfarë ndjesie është të jesh i çliruar nga borxhi?



TA SHKURTOJMË ZINXHIRIN PREJ LETRE

Unë ndoqa një universitet të shtrenjtë. Më pas gjeta një punë të mirë por kisha më shumë se njëqind mijë dollarë borxh. Para meje shtrihej një kohë E GJATË përpara se ta shlyeja borxhin. Një ditë të shtune, unë dhe gruaja ime bëmë një zinxhir prej letre me çdo hallkë zinxhiri që përfaqësonte 1 000 dollarë. Ne bëmë 100 hallka! E mbajmë zinxhirin tonë në dhomën e ndenjes dhe këputim nga një hallkë sa herë që paguajmë këstin e radhës prej 1 000 dollarësh. Edhe pse do të na duhen disa vite për t’u liruar nga borxhi, ne na pëlqen të shohim që zinxhiri ynë shkurohet dhe kjo është një mënyrë e mrekullueshme për t’i mësuar fëmijët tanë rreth borxhit dhe për ta përfshirë të gjithë familjen në synimin tonë.

Dilni nga Borxhi

Lexoni: Ju mund të dilni nga borxhi! Përqendrimi te shlyerja e borxhit do të kërkojë sakrificë të konsiderueshme, por ju mund ta bëni atë. Më poshtë janë pesë parime të rëndësishme për të dalë nga borxhi. Ne do të trajtojmë tre parimet e para në këtë kapitull.

1. Kuptojeni situatën e vërtetë të borxhit tuaj
2. Kini dëshirën për të dalë nga borxhi
3. Mposhtini prirjet e njeriut të natyrshëm që çojnë drejt borxhit
4. Reshtni së marri borxh
5. Shlyejini borxhet tuaja

Diskutoni: Çfarë mendimesh apo mbresash keni pasi i lexuat këto pesë parime?

2. KUPTOJENI SITUATËN E VËRTETË TË BORXHIT TUAJ

Lexoni: Sa para borxh keni? Sa janë normat e interesit? Sa janë pagesat? Sa kohë do të duhet për ta shlyer borxhin dhe sa interes do t'ju kushtojë? Është e rëndësishme t'i dini këto gjëra ndërsa punoni për të dalë nga borxhi. Për ta bërë këtë, ju do të krijoni një inventar për borxhin. Më poshtë është një shembull për tabelën e inventarit të borxhit.

PËRSHKRIMI	BILANCI	NORMA E INTERESIT	PAGESA MUJORE
Karta nr. 1 e kreditit	4 000	17%	97
Karta nr. 2 e kreditit	6 500	19%	168
Makina	5 000	3,00%	145
Huaja studentore	18 000	5,50%	300
Kredia	170 000	4,50%	1 050

Në këshillin tuaj familjar këtë javë, do të krijoni një tabelë të ngjashme. Sigurohuni që ta hidhni të gjithë informacionin për çdo borxh.

3. KIJENI DËSHIRËN PËR TË DALË NGA BORXHI

Lexoni: Me qëllim që të bëni diçka të vështirë, përfshirë daljen nga borxhi, dëshira juaj duhet të jetë më e fortë sesa pengesat. Plaku Dallin H. Ouks dha mësim: “Kur kemi një përfytyrim të asaj që mund të bëhemi, dëshira jonë dhe fuqia jonë për të vepruar rriten jashtëzakonisht” (“Dëshirë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 44). Për të gjetur sukses, përqendrohuni te synimi juaj për të dalë nga borxhi dhe përfytyroni se si do të jetë jeta kur të jeni të lirë nga barra e borxhit. Plaku Nil A. Maksuell dha mësim: “Ajo çfarë dëshirojmë me ngulm, me kalimin e kohës, është ajo çka do të bëhemi përfundimisht” (“According to the Desire of [Our] Hearts”, *Ensign*, nëntor 1996, f. 21).

Diskutoni: Përse dëshironi të çliroheni nga borxhi? Çfarë do të jeni në gjendje të bëni atëherë, që nuk jeni në gjendje ta bëni sot?

4. MPOSHTENI “NJERIU[N E] NATYRSHËM”

Lexoni: Në Librin e Mormonit, mbreti Beniamin dha mësim: “Pasi njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe ka qenë që nga rënia e Adamit dhe do të jetë gjithmonë e përgjithmonë, nëse ai nuk dëgjon thirrjet e Frymës së Shenjtë dhe nuk zhvesh njeriun e natyrshëm dhe nuk bëhet një shenjtë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot, dhe nuk bëhet si një fëmijë, i nënshtruar, i bindur, i përlur, i duruar, plot me dashuri” (Mosia 3:19). Për ta zhveshur njeriun e natyrshëm, ne duhet të kujtojmë parimet që mësuam nga kapitulli 4 rreth ruajtjes së një këndvështrimi afatgjatë. Ashtu si fëmijët tek eksperimenti me bonbone, ne duhet të mësojmë që t’i mënjanojmë kënaqësitë afatshkurtra me qëllim që të arrijmë synime afatgjata.

Prirjet e “njeriu[t të] natyrshëm” përfshijnë:

- Shpenzimin e rrëmbyer dhe nga emocioni.
- Shpërfilljen ose shkujdesjen rreth situatës sonë financiare.
- Lakminë dhe krahasimin e vetvetes me të tjerët.

Dorëzimi ndaj njeriut të natyrshëm ka mundësi që të na çojë drejt borxhit dhe stresit financiar. Nga ana tjetër, ndërsa kërkojmë t’i ndjekim “thirrjet e Frymës së Shenjtë”, ne do të na jepet mundësia që nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes të bëhemi të fortë përballë vështirësive.

Diskutoni: Çfarë do të thotë ta zhvishni njeriun e natyrshëm?

Lexoni: Le të shohim më nga afër disa nga këto prirje të njeriut të natyrshëm në kontekstin e mbështetjes te vetja.

Shpenzimi i Rrëmbyer dhe nga Emocioni

Përsiatni: Harxhoni një minutë kohë për të menduar rreth pyetjeve vijuese dhe shkruajini përgjigjet tuaja më poshtë: Kur ka qenë hera e fundit që keni bërë një blerje të shtrenjtë e të rrëmbyer? Çfarë bletë? Si mund t'i kishit përdorur ato para me më efektshmëri për diçka tjetër?

Lexoni: Të gjithë ne me siguri kemi bërë një blerje të rrëmbyer ose nga emocioni. Nganjëherë ne shpenzojmë para kur ndihemi të shkurajuar ose të zemëruar. Nganjëherë ne shpenzojmë para ngaqë mendojmë se kemi të drejtë ta shpërblejmë veten. Nganjëherë një shitje ose reklamë na josh që të besojmë se kemi nevojë për diçka, kur në të vërtetë nuk kemi. Ka shumë arsye se përse ne shpenzojmë para për gjëra që nuk i kemi të nevojshme në vend që të paguajmë për gjëra që kanë më shumë rëndësi. Veprimtaria vijuese do të na ndihmojë ta kuptojmë arsyen përse ne bëjmë blerje të rrëmbyera.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Harxhoni pak minuta për t'i i vlerësuar zakonet tuaja për shpenzimet nga emocioni duke iu përgjigjur pyetjeve më poshtë.

Hapi 2: Pasi ta keni plotësuar pyetësin, bashkohuni me bashkëshortin/en (nëse ndodhet aty) ose partnerin në veprim dhe diskutoni për sa vijon:

- Cilat janë disa modele që i vutë re të cilat lidhen me shpenzimin nga emocioni ose shpenzimin e rrëmbyer?
- Çfarë mund të bëni për t'u mbrojtur nga vetvetja?

SI NDIHEM KUR BËJ SHPENZIME TË RRËMBYERA? *(Shenjoni të gjitha ato që zbatohen.)*

- | | |
|---|---|
| ☐ I/E vetmuar | ☐ I/E inatosur |
| ☐ I/E mërziur | ☐ I/E trishtuar |
| ☐ I/E emocionuar | ☐ I/E stresuar |
| ☐ Bujar/e | ☐ I/E lodhur |
| ☐ I/E lumtur | ☐ I/E nënvlerësuar |
| ☐ I/E uritur | |

PËR ÇFARË SHPENZOJ KUR BËJ SHPENZIME TË RRËMBYERA?

(Shenjoni të gjitha ato që zbatohen.)

- | | |
|---|---|
| ☐ Veshje | ☐ Dhurata |
| ☐ Ngrënie në restorante | ☐ Mobilie ose zbukurime për shtëpinë |
| ☐ Pajisje ose aksesore elektronike | ☐ Ushqime të lehta ose pije |
| ☐ Zbavitje | ☐ Udhëtimet |

ME CILIN JAM I SHOQËRUAR KUR BËJ SHPENZIME TË RRËMBYERA?

- | | |
|----------------------------------|---|
| ☐ Fëmijët | ☐ Askënd; vetëm |
| ☐ Kolegët | ☐ Bashkëshortin/en |
| ☐ Miqtë | |

Diskutoni: Si mund t'i mposhtim prirjet për të bërë blerje të rrëmbyera? Çfarë keni bërë në të kaluarën për t'i mposhtur të tilla sjellje të rrëmbyera?

Shpërfillja ose Shkujdesja rreth Situatës Sonë Financiare

Lexoni: Në Librin e Mormonit, Nefi e qorton Lamanin dhe Lemuelin që kishin “humbur ndjesinë” dhe nuk ishin në gjendje ta ndienin Shpirtin që të punonte brenda tyre (shih 1 Nefi 17:45). Zgjedhjet tona shpesh mund të na e ngurtësojnë zemrën, duke e bërë të vështirë për t’i ndier nxitjet e Shpirtit kur na duhet të ndryshojmë. Ndonjëherë “humb[ja e] ndjesi[s]ë” mund të bëjë që ne të zgjedhim ta shpërfillim realitetin e situatës sonë. Ne mund të duam ta shmangim kontrollimin e shpenzimeve ose këqyrjen e llogarive tona bankare. Nëse përdorim karta krediti ose kredi të tjera konsumatore, kjo shkujdesje mund të na çojë me të shpejtë në borxh.

Ndonjëherë njëri ose të dy partnerët në martesë do të shpenzojnë pa kujdes, duke hamendësuar se partneri tjetër është përgjegjës për situatën financiare të familjes. Kujtoni, të dy bashkëshortët janë njëtrajtësisht përgjegjës për financat e familjes së tyre dhe shpërfillja ose zhvendosja e përgjegjësisë sonë do të na shtyjë akoma më shumë drejt shqetësimeve financiare.

Diskutoni: Përse disa janë gati për ta shpërfillur realitetin e situatës së tyre? Si mund ta mposhtni “humb[jen e] ndjesi[s]ë” rreth situatës suaj financiare, nëse është e nevojshme?

Lakmia ndaj të Tjerëve dhe Krahasimi i Vetes me Ata

Lexoni: Për njerëzit është e natyrshme që ta krahasojnë veten me të tjerët dhe ne jemi të bombarduar me mesazhe dhe reklama që na nxitin të blejmë gjëra që nuk na nevojiten. Nganjëherë mendojmë se kemi të drejtën të kemi gjëra që nuk mund t’i përballojmë ose që nuk na nevojiten vërtet. Dhënia ndaj lakmisë mund të na çojë shumë shpejt që të bëjmë blerje të pamenduara mirë.

Diskutoni: Si mund ta mposhtim prirjen për ta krahasuar veten me të tjerët?

DISKUTONI PËR PËRPARËSITË FINANCIARE NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Gjatë këshillit tuaj familjar këtë javë, ju do të diskutoni për mënyra sipas të cilave mund ta mposhtni veten dhe ta mbron veten nga prirjet e “njeriu[t të] natyrshëm”. Së bashku, diskutoni për borxhet tuaja aktuale dhe krijoni një “inventar për borxhin” (shih fletën bosh të inventarit për borxhin në faqen 123). Ju mund të merrni parasysh të përdorni përvijimin më poshtë “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar” për të udhërrëfyer në këshillin tuaj. Ndërsa i përcaktoni së bashku borxhet dhe teksa zhvilloni mënyra për t’i mposhtur prirjet e “njeriu[t] [të] natyrshëm”, ju do të merrni ndihmën e Zotit për t’i eliminuar borxhet tuaja.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Cilat janë disa mënyra se si i shfaqni prirjet e njeriut të natyrshëm?
- Kur e bëtë blerjen tuaj të madhe të fundit e të rrëmbyer? Çfarë mund të kishit bërë me ato para në vend të blerjes?
- Kur të çliroheni nga borxhi, çfarë do të jeni në gjendje të bëni atëherë që nuk mund ta bëni sot?

Pjesa 2: Planifikoni

- Krijoni një inventar për borxhin duke përdorur tabelën në faqen 123.
- Pyeteni veten:
 - Çfarë mund të bëni ndryshe për t’i eliminuar borxhet?
 - Çfarë praktikash mund të vini në zbatim për t’i mposhtur dhe parandaluar prirjet e njeriut të natyrshëm?
 - Si mund ta përfshini Zotin që t’ju ndihmojë për ta zhveshur njeriun e natyrshëm?



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Dhe përsëri, në të vërtetë unë ju them, lidhur me borxhet tuaja – vini re, është vullneti im që ju duhet t’i paguani të gjitha borxhet tuaja” (DeB 104:78).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do ta bëj me inventar borxhin tim duke përdorur shembullin në fletoren e punës.
- Ⓒ Do ta diskutoj inventarin tim për borxhin dhe mënyrat për t'i mposhtur dhe parandaluar prirjet e “njeriu[t të] natyrshëm” me familjen time ose një partner përgjegjës.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

INVENTARI PËR BORXHIN

PËRSHKRIMI	BILANCI	NORMA E INTERESIT	PAGESA MUJORE

SHĚNIME

[illegible]



DALJA NGA BORXHI

PARIMI NGA THEMELI IM

- Punoni: Merrni Përgjegjësi dhe Këmbëngulni

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Reshtni së Marri Borxh
2. Shlyejini Borxhet Tuaja



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të krijoj një inventar për borxhin.
- Ⓒ Të diskutoj për inventarin për borxhin dhe mënyrat për t'i mposhtur prirjet e “njeriu[t të] natyrshëm” në këshillin tim familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për të vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Partneri më mirëjet se si mund të veshkoni të përmirësoheni tek u bashkoheni për formimin e këtyre zotimeve të rëndësishme.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Më e Mirë ● Përpjekje e Rëndësishme					
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Gjendja	
Si vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	I Planifikoj dhe i Admendoj Financat e Mja	Më kujt rrethat të Familjes	Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjendja	
Shembull: Të jem i bashkuar	Regjistroj shpenzimet	Kërkoheturi mbi bërjen			
Javë 1: Më bashkëtoja të vepra të tjera rreth parimit të bashkuar	Regjistroj shpenzimet	Kërkoheturi mbi bërjen			
Javë 2: Të ushtroj bashkë me ju në bërjen	Regjistroj shpenzimet	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 3: Të përdorim dhe të jem i bashkuar	Regjistroj shpenzimet	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 4: Të jem i bashkuar me bashkëpunuesin	Regjistroj shpenzimet	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 5: Të zgjedh problemet	Zgjedh një shtet për bashkëpunuesin	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 6: Të përdorim kohën me bashkëpunuesin	Callos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen për rastet e rëndësishme, ngjarjet			
Javë 7: Të tregoj imazhin timin	Vendos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen			
Javë 8: Punë të marr përparim dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen			
Javë 9: Të komunikoj. Të bëj kërkime dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 10: Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet	Vendos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			
Javë 11: Të bashkëpunoj me bashkëpunuesin	Vendos para për një përparim financiar	Kërkoheturi mbi bërjen dhe shpenzimet			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë mësuar nga krijimi i një inventari për borxhin?
 - Si ndiheni që keni një inventar të përfunduar për borxhin tuaj?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: MERRNI PËRGJEGJËSI DHE KËMBËNGULNI – Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Përse Ati Qiellor dëshiron që unë të marr përgjegjësi vetjake për jetën time?

Shihni: "Sedrick's Journey" ["Udhëtimi i Sedrikut"], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 129.)

Diskutoni: Si të mësojmë që të vazhdojmë pa u ndalur edhe kur puna është e vështirë?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhjet 42:42 dhe citimin nga Presidenti Xhejms E. Faust (në të djathtë)

Diskutoni: Lexojeni citimin nga Plaku D. Tod Kristoferson (në faqen 129). Përse Zoti pret nga ne që të punojmë për atë që marrim?

"Mos ji dembel; sepse ai që është dembel nuk duhet të hajë bukën, as duhet të veshë rrobat e punëtorit."

DOKTRINA E BESË-LIDHJE 42:42

"Këmbëngulja duket tek ata njerëz që . . . nuk dorëzohen edhe kur të tjerët thonë: 'Është e pamundur'."

XHEJMS E. FAUST,
"Këmbëngulja",
Ensign ose *Liahona*,
maj 2005, f. 63,
Konferenca e Përgjithshme, prill 2005.

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexojeni së bashku çdo hap në modelin më poshtë.

Hapi 2: Kërkojini njëri-tjetrit që të flisni rreth një detyre apo sfide shumë të vështirë që personi tjetër po has.

Hapi 3: Ndhijmoheni njëri-tjetrin që t'i zbatoni të katër hapat më poshtë për detyrën apo sfidën e vështirë.

1	2	3	4
MBANI NJË QËNDRIM POZITIV	MBANI MEND QË TË PUNONI SË BASHKU	ZËVENDËSOJENI FRIKËN ME BESIM	SHKONI PËRPARA ME DURIM E GUXIM
Renditini bekimet tuaja.	Kërkojuni ndihmë miqve, bashkëmoshatarëve, anëtarëve të grupit dhe të tjerëve.	Shmangeni dyshimin. Mbajeni mend se Zoti e ka të gjithë fuqinë. Bëjini thirrje Atij dhe pranojeni vullnetin e Tij.	Kurrë, kurrë, kurrë mos hiqni dorë; duroni me besim. Kërkoni për mësimë që Zoti mund të jetë duke ju mësuar.

Hapi 4: Shkruani dy ose tri mënyra se si mund të shkoni përpara me besim, duke mirëbesuar se Perëndia do të sigurojë për ju.

Përsiatni: Lexojeni citimin nga Presidenti Tomas S. Monson (në të djathtë). Si reagoj unë kur përjetoj dështim?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Zgjidhni diçka që është e vështirë ose e parehatshme dhe përfundojeni detyrën. Shkruajeni më poshtë.
- ☐ Tregojani familjes dhe miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth punës dhe këmbënguljes.

UDHËTIMI I SEDRIKUT

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



SEDRIKU: Unë quhem Sedrik Kambezabue. Jetoj në Republikën Demokratike të Kongos. Jam anëtar i Kishës SHDM.

Jam misionar dege në fshatin e Kipusangës. Duhet të përgatitem për të shkuar në një mision të huaj. Në mënyrë që të shkoj në një mision, më nevojitet një pasaportë, e cila tani kushton 250 dollarë amerikanë.

Për të fituar para, babai im dhe unë blejmë banane. Disa fshatra prodhojnë shumë banane: Tishabobo, Lusuku dhe Kamanda.

Tishabobo është rreth 14,5 kilometra larg prej këtu. Lusuku është 29 kilo-

metra larg. Edhe Kamanda është 29 kilometra larg. Ne shkojmë atje dhe blejmë banane dhe i sjellim prapë këtu për t'i shitur.

Për të shkuar nëpër fshatra ne përdorim një biçikletë. Ne mund të marrim katër ose gjashtë tufa banane.

Kur shkoj me biçikletë çdo rrugë shkon një orë e gjysmë, nëse biçikleta punon dhe unë kam fuqi. Kur është mesditë dhe i nxehti është zhuritës, lëviz ngadalë për shkak të të nxehtit dhe diellit.

Mund të bëj dy udhëtime në ditë nëse zgjohem shumë herët në mëngjes. Kjo është një mënyrë e mirë për të ndihmuar për pagimin e pasaportës sime.

Tani po fitoj para, pak e nga pak, ndaj po ruaj edhe për shpenzimet e shkollës edhe të misionit. Dhe tani, pas katër vitesh punë, kam mjaftueshëm para për pasaportën time, plus 70 dollarë të ruajtur.

Kthehuni te faqja 128.

“Perëndia e ka projektuar këtë ekzistencë të vdekshme për të kërkuar thuasht një tendosje të përhershme. . . . Me punë ne mbajmë dhe pasurojmë jetën. . . . Puna ngre dhe përsos karakterin, krijon bukuri dhe është instrumenti i shërbimit tonë për njëri-tjetrin dhe për Perëndinë. Një jetë e shenjtë është e mbushur me punë, ndonjëherë e përsëritur, . . . ndonjëherë e pavarësuar, por gjithmonë punë që përmirëson, . . . ngre [dhe synon].”

D. TOD KRISTOFERSON, “Mendime mbi një Jetë të Përkushtuar”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2010, f. 17

“Përgjegjësia jonë është të ngrihemi nga të menduarit ngushtë për të vetëzotësia, nga dështimi tek arritja. Detyra jonë është të bëhemi vetja jonë më e mirë. Një prej dhuratave më të madhërishtme të Perëndisë për ne është gëzimi i të provuarit përsëri, sepse asnjë dështim kurrë nuk ka pse të jetë përfundimtar.”

THOMAS S. MONSON, “The Will Within”, *Ensign*, maj 1987, f. 68



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

3

ELIMINONI BORXHIN

Lexoni: Javën e kaluar ne diskutuam tri parime që përcaktuam për të dalë nga borxhi:

1. Kuptojeni situatën e vërtetë të borxhit tuaj.
2. Kini dëshirën për të dalë nga borxhi.
3. Mposhtini prirjet e “njeriu[t të] natyrshëm” që ju çojnë drejt borxhit.

Sot ne do të diskutojmë edhe dy parime të tjera:

1. Reshtni së marri borxh.
2. Shlyejini borxhet tuaja.

Diskutoni: Cilat janë disa nga gjërat më kuptimplote që keni mësuar javën e kaluar?

1. RESHTNI SË MARRI BORXH

Lexoni: Ju nuk mund të prisni të dilni nga borxhi derisa të reshtni së marri më shumë borxh. Ka dy hapa të thjeshtë për të reshtur së marri borxh:

1. Mblidhni një fond për raste të ngutshme.
2. Hiqni dorë nga përdorimi i kartave të kreditit dhe huave konsumatore.

Së pari, vazhdoni të mblidhni një fond për raste të ngutshme derisa të keni vlerën e tre deri gjashtë muajve të shpenzimeve të kursyera. Përdorini këto para kur është e nevojshme në vend të kartës së kreditit. Por kujtohuni që ta përdorni vetëm për raste të ngutshme aktuale dhe t'i vendosni në buxhet për çdo gjë tjetër.

Së dyti, reshtni së mbështeturi vetëm te borxhi konsumator dhe kartat e kreditit. Plaku Xhefri R. Holland sugjeroi “operacionet plastike” financiare. Ai tha: “Ky është një operacion krejtësisht jo i dhimbshëm: Thjesht bëjini copash kartat tuaja të kreditit. . . . Asgjë tjetër më e volitshme që njihet nga njeriu bashkëkohor nuk e ka rrezikuar gjendjen financiare të familjeve, veçanërisht të familjeve të reja që hasin vështirësi, sa kartat e kreditit” (Jeffrey R. dhe Patricia T. Holland, “Things We Have Learned—Together”, *Ensign*, qershor 1986, f. 30). Bërja copash e kartave tuaja të kreditit do t’ju ndihmojë të reshtni së hyri më shumë në borxh.

Diskutoni: Çfarë jeni i/e gatshëm/me të bëni për të reshtur së marri borxh?

2. SHLYEJINI BORXHET TUAJA

Lexoni: Ne jemi këshilluar t’i paguajmë borxhet tona sa më shpejt të mundemi: “Në qoftë se merrni përsipër një borxh . . . punoni që ta paguani sa më parë e ta çlironi veten nga varësia” (*Të Vërtetë ndaj Besimit*, [2005], “Borxh”, f. 26).

Këtu janë katër hapa që do t’ju ndihmojnë të bëni një plan dhe ta ndiqni atë për të dalë nga borxhi.

1. Vendosni të paguani para shtesë për borxhet tuaja.
2. Vendosni se ku të paguani para shtesë.
3. Përdorni metodën e parave me rivënie në depozitim.
4. Ndërmerrni hapa shtesë, si të jetë e nevojshme.

Vendosni të Paguani Para Shtesë për Borxhet Tuaja

Lexoni: Një nga mënyrat më të shtrenjta për të dalë nga borxhi është të bëjmë pagesa minimale. Shpesh pagesa minimale është një përqindje e bilancit. Kur bilanci ulet, ulet edhe pagesa minimale. Kjo zgjat kohën që duhet për ta shlyer bilancin dhe ju kushton më shumë interes. Për të dalë nga borxhi shumë më shpejt, juve do t'ju nevojitet të paguani më shumë se pagesa minimale.

PËRSHKRIMI	BILANCI	NORMA E INTERESIT	PAGESA MUJORE
Karta nr. 1 e kreditit	4 000	17%	97
Karta nr. 2 e kreditit	6 500	19%	168
Makina	5 000	3,00%	145
Huaja studentore	18 000	5,50%	300
Kredia	170 000	4,50%	1 050

Për shembull, nëse e përdorëm inventarin tonë për borxhin (më lart) nga kapitulli i kaluar dhe bëmë vetëm pagesën minimale me kartën nr. 1 të kreditit, sa kohë mendoni se do të duhet për të dalë nga borxhi? Si mendoni, sa interes do të na kushtonte? Duke bërë vetëm pagesat minimale:

- Do të duhen 20 vjet e 9 muaj për ta shlyer borxhin!
- Do të kushtonte 5 107,62 dollarë për interesin.

Po sikur të paguanit pagesën minimale aktuale me 97 dollarë, plus 100 dollarë shtesë në muaj?

- Ju do ta shlyenit borxhin brenda 2 vitesh e gjysmë – i bie 18 vjet më shpejt!
- Ju do të kursenit 4 357,49 dollarë në interes!

Diskutoni: Përse kreditorët duan që ju të bëni vetëm pagesa minimale?

Lexoni: Pagimi i më shumë se pagesat minimale do ta shkurtojë kohën që duhet për të dalë nga borxhi dhe do t'ju kursejë më shumë para në interes. Ju keni mbajtur kontrollin për shpenzimet tuaja dhe keni zhvilluar një buxhet. Si mund të kurseni disi para nga shpenzimet tuaja për të bërë pagesa shtesë për borxhet tuaja? Një nga zotimet tuaja këtë javë do të jetë të përcaktoni se sa para shtesë mund të vini mënjanë për ta paguar borxhin tuaj. Kur ta merrni në konsideratë shlyerjen e borxhit tuaj të parë, zgjidhni një shumë të pandryshueshme që përfshin pagesën minimale shtesë të lartpërmendur dhe pagujeni të paktën derisa ta keni shlyer borxhin.

VEPRIMTARIA (15 minuta)

Hapi 1: Bahkohuni me partnerin në veprim. Shqyrtoni buxhetin tuaj dhe shihni nëse mund të gjeni 100 dollarë ose më shumë që mund t'i zbatoni për të paguar borxhet tuaja. Shkruani idetë tuaja më poshtë.

Hapi 2: Si grup, tregoni idetë tuaja.

Vendosni se Ku të Paguani Para Shtesë

Lexoni: Këtu kemi disa mundësi për të vendosur se cilat borxhe duhen paguar të parat. Ju mund:

- Të paguani para shtesë së pari për borxhin me interesin më të lartë.
- Të paguani para shtesë së pari për borxhin me bilancin më të ulët.

Të dyja mundësitë kanë avantazhet dhe disavantazhet e veta, por të dyja do t'ju ndihmojnë që të çliroheni nga borxhi. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë të përcaktoni se cilin borxh do të paguani të parin.

METODA	AVANTAZHET	DISAVANTAZHET
Interesi më i lartë së pari	◦ Eliminon më shpejt borxhet më të shtrenjta	◦ Mund të marrë më shumë kohë për të pakësuar numrin e kreditorëve ◦ I sheh frytet me vonesë
Bilanci më i ulët së pari	◦ Zvogëlon numrin e kreditorëve më shpejt ◦ Zvogëlon numrin e pagesave minimale më shpejt ◦ I sheh frytet brenda një kohe të shkurtër	◦ Mund të jetë më i shtrenjtë meqenëse nuk jeni duke shlyer borxhet me interesin më të lartë së pari

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Përdorni shembullin më poshtë të inventarit për borxhin për të bërë sa vijon:

Hapi 1: Vendosni një shenjë pranë huas me normën më të lartë të interesit.

Hapi 2: Qarkoni huan me bilancin më të vogël.

PËRSHKRIMI	BILANCI	NORMA E INTERESIT	PAGESA MUJORE
Karta nr. 1 e kreditit	4 000	17%	97
Karta nr. 2 e kreditit	6 500	19%	168
Makina	5 000	3%	145
Huaja studentore	18 000	5,5%	300
Kredia	170 000	4,5%	1 050

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Përdorni inventarin tuaj për borxhin te (faqja 123) për të bërë sa vijon:

Hapi 1: Vendosni një shenjë pranë huas me normën më të lartë të interesit.

Hapi 2: Qarkoni huan me bilancin më të vogël.

Hapi 3: Vendosni se cilën hua të paguani së pari me para shtesë dhe shënojeni atë tek inventari juaj për borxhin.

Përdoreni Metodën e Parave me Rivënie në Depozitim

Lexoni: Metoda e parave me rivënie në depozitim është një mënyrë e shkëlqyer për t'i shlyer borxhet tuaja. Le të themi që tani ju mund të paguani 100 dollarë shtesë në muaj për borxhet tuaja. Kur ta shlyeni një borxh, çfarë do të bëni me paratë që shkonin për atë hua? Rivendosini në depozitim për të paguar huat e tjera! Pikërisht kështu mund të filloni të dilni vërtet nga borxhi më shpejt.

Për shembull, me shembullin e inventarit për borxhin, nëse keni paguar 100 dollarë shtesë në muaj në kartën nr.1 të kreditit, pagesa juaj mujore do të ishte 197 dollarë. Pasi të jetë shlyer, juve do t'ju mbeteshin 197 dollarë shtesë që mund t'i përdornit për të shlyer një borxh tjetër. Nëse do t'i përdornit ato 197 dollarët shtesë dhe t'i vendosni bilancit prej 6 500 dollarësh për kartën nr. 2 të kreditit, ju do:

- Ta shlyenit atë kartë krediti shumë më shpejt se 23 vjet nga sa po të bënit pagesat minimale!
- Të kursenit më shumë se 8 500 dollarë në interes!

Sapo ta shlyenit atë kartë krediti, ju do të kishit 365 dollarë shtesë për të paguar borxhe të tjera, e kështu me radhë. Metoda e parave me rivënie në depozitim funksionin mirë për ta eliminuar borxhin shpejt.

Diskutoni: Si do t'ju ndihmojë metoda e parave me rivënie në depozitim për t'ju nxjerrë më shpejt nga borxhi?

Ndërmerrni Hapa Shtesë

Lexoni: Nëse po kaloni një periudhë të vështirë duke bërë pagesa minimale për borxhin, atëherë mund t'ju duhet të merrni masa shtesë (shih mëposhtë).

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Ndahuni në grupe me nga dy deri në katër njerëz dhe diskutoni për masat shtesë më poshtë. Përsiatni nëse ndonjë nga këto masa mund t'ju ndihmonte.

Hapi 1: Gjeni punë shtesë ose punë më të mirë: A ju kujtohet shembulli me kavanozin? Juve mund t'ju duhet një kavanoz më i madh! Të ardhurat shtesë nga një punë e dytë ose biznes paralel mund ta përshpejtojë planin tuaj për eliminimin e borxhit. Me siguri që nuk do keni nevojë për një punë të dytë të përhershme. Sidoqoftë, nëse po hasni vështirësi për ta përshpejtuar shlyerjen e borxhit tuaj, të ardhurat shtesë mund t'ju ndihmojnë pamasë për të rifituar gjendjen tuaj financiare.

Hapi 2: Shitni disa gjëra pa të cilat mund të jetoni.

Hapi 3: Minimizimi: Nganjëherë lëvizja juaj më e mirë është të shpërnguleni – me plot kuptimin. Një shtëpi, apartament ose makinë më pak e kushtueshme mund të jetë një mundësi e mirë.

Hapi 4: Rifinancimi borxhin: Në disa rrethana është e mundur t'i rifinanconi huat tuaja me një normë të ulët interesi ose t'i shkruani disa prej tyre në një hua të vetme me një normë më të ulët interesi. Mund të ketë kosto për refinancimin ose shkërrjen, prandaj sigurohuni që t'i kuptoni shpenzimet paraprakisht.

Hapi 5: Gjeni ndihmë nga këshilluesit ose këshilltarët financiarë: Në shumë vende të botës njerëzit mund të marrin këshillime financiare nëpërmjet shërbimeve vendore jofitimprurëse ose institucioneve financiare. Gjeni dhe këshillohuni me një këshillues të besueshëm.

DISKUTONI PËR ELIMINIMIN E BORXHIT NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Në këshillin tuaj familjar këtë javë, diskutoni se sa para mund të vini mënjane çdo muaj për të bërë pagesa shtesë për borxhet tuaja. Përveç kësaj, diskutoni se cilën hua do të donit të fillonit që ta paguani të parën (interesin më të lartë apo bilancin më të ulët). Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë "Model Diskutimi Në Këshillin Familjar".

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- A po merrni ende borxh?
- Sa para mund të përballoni që t'i vendosni për të bërë pagesa shtesë? (Shqyrtoni të ardhurat dhe shpenzimet tuaja dhe shënoni shumën që mund të paguani shtesë në fletën tuaj të inventarit për borxhin në faqen 123.)

Pjesa 2: Planifikoni

- Çfarë mund të bëni për t'u siguruar që të reshtni së marri borxh? Së bashku, merrni parasysh që t'i bëni copash kartat tuaja të kreditit.
- Çfarë shpenzimesh mund të pakësoni që të mbledhni para për të bërë pagesa shtesë për borxhin tuaj?
- Çfarë huaje (ose huash) duhet të shlyeni së pari? (Shënoni rendin në inventarin tuaj për borxhin në faqen 123.)



MË SHUMË SE DY PËRQIND

Dikur më pëlqente shumë karta ime e kreditit! Një herë në tre muaj do të merrja 2% mbrapsht për të gjitha blerjet e mia. Por kur unë dhe bashkëshorti im filluam me seriozitet planin financiar, u bë shumë e vështirë që ne ta krahasonim bilancin e kartës sonë të kreditit me bilancin e llogarisë sonë bankare të pagës. Unë kuptova se po shpenzonim rregullisht pak më shumë nga sa kishim në të vërtetë. Ne i bëmë copash kartat tona të kreditit, siç sugjeroi Plaku Holland! Tani e di se jemi duke kursyer më shumë se 2% duke pasur kufizime të qarta dhe duke e ditur me saktësi se sa para kemi në llogarinë tonë në çdo rast.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Çliroje veten nga robëria” (DeB 19:35).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- (A)** Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- (B)** Do të përcaktoj sa para shtesë mund të paguaj për ta eliminuar borxhin dhe cilën hua të filloj ta shlyej të parën dhe do të krijoj një plan për eliminimin e borxhit.
- (C)** Do të diskutoj rreth planit për eliminimin e borxhit tim gjatë këshillit tim familjar.
- (D)** Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim

[illegible]

SHĚNIME



9

PËRBALLIMI I KRIZAVE FINANCIARE

PARIMI NGA THEMELI IM

- Komunikoni: Bëni Kërkesa dhe Dëgjoni

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Mësoni t'i Përballoni Krizat Financiare
2. Shtojini Përgatitjet Tuaja për Raste të Ngutshme



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të krijoj një plan për të filluar eliminimin e borxhit.
- Ⓒ Të diskutoj rreth planit për eliminimin e borxhit tim gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta për-krah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën "Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia" në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPIJEKJEVE TË MIA				
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjet tuaja për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Përdoreni tabelën "Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia" në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.				
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Mëdha				
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj partnerit Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mja	Ⓒ Më kujt rrethat të Familjes	Ⓓ Vihem në kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjurmë Notime të Partnerit në Veprim
Shembull 20 për një buror	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi borxhin		
Javë 1 Më kujt rrethat të jeta tërë rrethat	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi borxhin		
Javë 2 Të udhëtoj bashkë me partnerin	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 3 Të përdorim dhe të jemi në boror	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 4 Të jemi një pjesë të bashkëpunimit	Regjistroj shpenzimet	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 5 Të zgjedh problemet	Zgjedh një problem për bashkëpunim	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 6 Të përdorim kohën me partnerin	Calloj para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 7 Të rregulloj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 8 Puna: Të mos përdorim dhe të shpenzojmë	Vendos para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 9 Të komunikojmë të bëjmë vendime dhe të bëjmë	Vendos para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 10 Vlerësimi i mënyrës të vendosim në fuqi dhe në fuqi të të ardhmës	Vendos para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		
Javë 11 Të bëjmë një, të shprehim dhe të bëjmë	Vendos para për një përparim financiar	Kërkohet mbi borxhin dhe shpenzimet		

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë mësuar nga krijimi i një plani për eliminimin e borxhit?
 - Çfarë po bëni tani ndryshe për ta eliminuar borxhin në familjen tuaj?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: KOMUNIKONI

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Kur iu është përgjigjur Ati Qiellor lutjeve të mia?

Shihni: “Creating Lift” [“Krijimi i Forcës Ngritëse”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 145.)

Diskutoni: Si mund t’i dallojmë përgjigjet ndaj lutjeve tona? Përse është dëgjimi një pjesë thelbësore e lutjes?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhjet 8:2 dhe citimin nga Presidenti Rasëll M. Nelson (në të djathtë)

Diskutoni: Përse është të dëgjuarit një aftësi thelbësore? Si mund të na ndihmojë në punën tonë të dëgjuarit me kujdes?

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Si grup, lexojini hapat më poshtë dhe diskutoni shkurtimisht për to.

Hapi 2: Kërkojini njërit ose dy prej anëtarëve të grupit t’u tregojnë të tjerëve rreth një sfide apo pyetjeje që ata kanë. Çdokush tjetër duhet të përpiqet të dëgjojë, duke i ndjekur këto hapa.

Hapi 3: Kur të mbaroni, pyetini anëtarët e grupit që folën se si u ndien kur grupi u përpoq vërtet të dëgjonte.



“Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe që do të banojë në zemrën tënde.”

DOKTRINA E BESËLIDHJE 8:2

“Shpirti juaj do të bekohet teksa mësoni të dëgjoni, më pas tek dëgjoni për të mësuar nga fëmijët, prindërit, shokët, fqinjët dhe udhëheqësit e Kishës, gjithçka prej të cilave do ta zgjerojë aftësinë për të dëgjuar këshilla nga lart.”

RUSSELL M. NELSON,
“Listen to Learn”,
Ensign, maj 1991,
f. 24

Lexoni: Citimet nga Presidenti Henri B. Ajring dhe Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë)

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjoni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Lutuni individualisht dhe si familje çdo mëngjes e çdo natë. Shpenzoni kohë pas çdo lutjeje që të dëgjoni plot nderim për udhërrëfim.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth komunikimit.

KRIJIMI I FORCËS NGRITËSE

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PRESIDENTI DITER F. UHTDORF: Me qëllim që një aeroplan të ngrihet nga toka, duhet krijuar një forcë ngritëse. Në aerodinamikë, forca ngritëse krijohet kur ajri kalon te krahët e një aeroplani në mënyrë të tillë që trysnia nga poshtë krahëve të jetë më e madhe sesa trysnia sipër krahëve. Kur forca ngritëse e tejkalon tërheqjen poshtë të gravitetit, aeroplani ngrihet nga toka dhe arrin të fluturojë.

Në një mënyrë të ngjashme, ne mund ta krijojmë forcën ngritëse në jetën tonë shpirtërore. Kur forca që na shtyn drejt qiellit, është më e madhe sesa tundimet dhe ankthi që na tërheqin poshtë, ne mund të ngjitemi dhe të fluturojmë në mbretërinë e Shpirtit.

Edhe pse ka shumë parime të ungjillit që na ndihmojnë të arrijmë forcën ngritëse, do të më pëlqente të përqendrohesha te njëra në veçanti.

Lutja!

Lutja është një nga parimet e ungjillit që siguron forcë ngritëse. Lutja ka fuqinë të na ngrejë nga shqetësimet tona tokësore. Lutja mund të na ngrejë përmes reve të dëshpërimit ose errësirës për te një horizont i ndritshëm e i kthjellët.

Një nga bekimet, privilegjet dhe mundësitë më të mëdha që kemi si fëmijë të Atit tonë Qiellor, është se ne mund të komunikojmë me Të nëpërmjet lutjes. Mund t'i flasim Atij për përvojat tona jetësore, sfidat dhe bekimet. Ne mund ta dëgjojmë e të marrim udhërrëfim qiellor nga Shpirti i Shenjtë në çdo kohë e në çdo vend.

(Shih Dieter F. Uchtdorf, "Prayer and the Blue Horizon", *Ensign* ose *Liahona*, qershor 2009, f. 5–6)

Kthehuni te faqja 144.

"Ati ynë Qiellor i dëgjon lutjet e fëmijëve të Tij [anëmbanë] tokës, që luten për ushqim për të ngrënë, për rroba për t'i mbuluar trupat e tyre dhe për dinjitetin që do të rridhte nga të qenët në gjendje për të siguruar për vete."

HENRI B. AJRING,
"Mundësi për të Bërë Mirë", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 22

"Ne duhet të kërkojmë ndihmë nga Ati ynë Qiellor dhe të kërkojmë forcë përmes Shlyerjes së Birit të Tij, Jezu Krishtit. Në të dyja, si në gjërat materiale, ashtu dhe ato shpirtërore, marrja e kësaj ndihme hyjnore na mundëson të bëhemi kujdestarë të matur për vete dhe për të tjerë."

ROBERT D. HEJLS, "Të Bëhemi Kujdestarë të Matur, Materialisht dhe Shpirtërisht", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 8



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

2

MBROJENI FAMILJEN TUAJ NGA VËSHTIRËSITË



HARTA E SUKSESIT PËR KUJDESTARINË FINANCIARE

PIKAT PËR BUXHETIN DHE SHPENZIMET

Lexoni: Shqyrtoni dhe përditësoni buxhetin tuaj. Çfarë po shkon mirë? Cilat kategori keni nevojë të rregulloni, nëse keni ndonjë? A mund të shpenzoni më pak në disa kategori që të kurseni më shpejt për fondin tuaj për raste të ngutshme, që të çliroheni nga borxhi ose që të kurseni për të ardhmen? Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë të diskutoni për veprimtarinë vijuese gjatë këshillit familjar.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Merrni parasysh secilën nga kategoritë më poshtë dhe përgjigjuni me sinqeritet.

SI NDIHEM RRETH SHPENZIMEVE TË MIA?	Shpenzoj tepër pak	Ndihem mirë për shpenzimet e mia	Shpenzoj me tepri
Ngrënia në restorante	☐	☐	☐
Artikujt ushqimorë	☐	☐	☐
Ushqimet e lehta dhe pijet	☐	☐	☐
Zbavitja	☐	☐	☐
Qiraja ose kredia	☐	☐	☐
Shërbimet komunale	☐	☐	☐
Veshjet	☐	☐	☐
Gjërat për shtëpinë	☐	☐	☐
Transporti	☐	☐	☐
Sigurimet	☐	☐	☐
Telefoni celular	☐	☐	☐

Përsiatni: Çfarë do të bëni nëse hasni një krizë financiare? Çfarë krize financiare keni përjetuar në të kaluarën?

Lexoni: Te Dhiata e Vjetër, Jozefi e paralajmëroi Faraonin për shtatë vite bollëku, të pasuar me shtatë vite zie buke. Menjëherë, Faraoni caktoi mbikëqyrës për të vendosur mënjanë [prodhime] shtesë nga vitet e begata që të përgatitej për vitet e këqija (shih Zanafilla 41:1–37). Ndonëse mund të mos kemi gjithmonë një profeci të qartë se kur do të vijnë kohët e begata dhe të këqija, profetët sot na kanë nxitur që të përgatitemi për kohë krize, veçanërisht kur gjërat po shkojnë mirë.

Në këtë kapitull, ne do të mësojmë se çfarë të bëjmë kur hasim një krizë financiare dhe si të përgatitemi për kohë krizash përpara se ato të ndodhin.

Diskutoni: Çfarë lloj krizash financiare mund të hasni? Hidhni në letër më poshtë idetë e grupit.



GJITHNJË EKZISTON NJË MËNYRË

Kur filluam të mësonim për mbledhjen e një fondi për raste të ngutshme, unë dhe bashkëshorti im nuk e kishim menduar se në të vërtetë do të mblidhnim mjaftueshëm para. Ne u lutëm për udhërrëfim dhe përgjigjja jonë ishte që të shitnim një nga makinat tona. Tani bashkëshorti im merr autobusin për të shkuar në punë dhe ne kemi një fond të mirëfilltë për raste të ngutshme.

1. MËSONI T'I PËRBALLONI KRIZAT FINANCIARE

Lexoni: Ashtu si një plan për raste të ngutshme apo largim në rast zjarri, në rastin e një krize financiare ju duhet të keni një rrjedhë veprimi që është e lehtë për ta ndjekur. Rreth përballimit të sprovave, Plaku Marvin J. Ashton pyeti: "A mund të uleni qetësisht, të shqyrtoni faktet dhe të renditni të gjitha rrjedhat e mundshme të veprimit? A mund t'i identifikoni shkaqet dhe ta përcaktoni rrugëdaljen? Të menduarit të thellë në qetësi mund t'i zgjidhë problemet më shpejt sesa vrulli i tërbuar" ("Give with Wisdom That They May Receive with Dignity", *Ensign*, nëntor 1981, f. 88). Përcaktimi se si t'iu bëjmë ballë krizave financiare që më përpara, do t'ju lejojë që të jeni të përgatitur emocionalisht dhe financiarisht kur vështirësitë të godasin dhe mund t'ju ndihmojë që t'i parandaloni disa kriza në të ardhmen. Përballimi i një krize financiare kërkon dy hapa: vlerësimin e situatës dhe ndërmarrjen e veprimit të duhur.

Diskutoni: Përse është e rëndësishme që të vendosni tani se si ta përballoni një krizë financiare? Si ju kanë ndihmuar Shpirti që t'iu bëni ballë krizave në të kaluarën?

Vlerësoni Situatën

Lexoni: Për ta vlerësuar një krizë të mundshme financiare, ju mund të doni të bëni pyetjet në vijim:

- A jeni besnik në pagimin e së dhjetës dhe ofertave tuaja? A po e jetoni jetën tuaj në një mënyrë të tillë që të jeni të denjë për bekimet e Perëndisë?
- Çfarë masash paraprake për raste të ngutshme keni tashmë në zbatim që do t'ju ndihmojnë të përballeni me sfidën aktuale? A keni rezerva ushqimore dhe uji? një fond për raste të ngutshme? sigurimin e duhur?
- Ku ju çalojnë përgatitjet për rastet e ngutshme?
- Cilat polica për sigurimet keni që mund të mbulojnë një pjesë ose të gjithë pjesën e kësaj sfide?
- Për sa kohë do të jeni në gjendje të mbështeteni te fondi juaj për raste të ngutshme?
- A ka vend në buxhetin tuaj dhe në planin për eliminimin e borxhit për rregullime të përkohshme, nëse është e nevojshme?

Diskutoni: Përse është e rëndësishme që ta vlerësoni plotësisht një situatë përpara se të veproni?

Veproni

Lexoni: Në varësi të llojit dhe gjendjes së krizës suaj financiare, ka veprime të ndryshme që mund të jeni në gjendje t'i ndërmerrni që t'ju ndihmojnë për t'i kapërcyer sfidat tuaja financiare. Ndonëse këto veprime mund të mos kenë kuptim për të gjitha situatat, hapat vijues duhet t'ju japin një ide të asaj se ç'mund të bëhet në rastin e një krize financiare.

Telefononi Kompaninë Tuaj të Sigurimeve

Lexoni: Disa kriza financiare mund të përfshijnë një rast të ngutshëm shëndetësor, një aksident automobilistik, riparime për shtëpinë ose humbjen e punës. Për situata të tilla, përpara se t'ju zërë paniku ose të ndërmerrni veprime të tjera, merreni në telefon kompaninë tuaj të sigurimeve që t'ju kontrollojë pjesën e mbulimit. Bërja e pyetjeve për mbulimin nuk do të thotë që po paraqitni një kërkesë. Por nëse në situatën tuaj jeni të mbuluar, duhet të jeni në gjendje të kuptoni disi se sa do të jenë shpenzimet tuaja vetjake.

Diskutoni: Cilat kriza financiare ia vlen të mbulohen nga kompania juaj e sigurimeve?

Përdorni Fondin Tuaj për Raste të Ngutshme

Lexoni: Qëllimi i fondit tuaj për raste të ngutshme është t'ju ndihmojë të dilni nga krizat financiare. Mos u ndieni fajtor që i përdorni ato për këto situata. Ju mund ta përdorni fondin tuaj për raste të ngutshme për çfarëdo gjëje që iu nevojitet – nga shpenzimet e jetesës deri te sigurimet me përqindje të zbritura. Tregohuni të zgjuar që ta përdorni atë për gjërat e duhura në kohën e duhur. Rimbusheni fondin tuaj për raste të ngutshme sa më shpejt të jetë e mundur nëse ju duhet të përdorni para nga ai.

Paguani së Pari Shpenzimet dhe Faturat Tuaja më të Rëndësishme

Lexoni: Shqyrtojini mirë të gjitha shpenzimet dhe faturat tuaja dhe përcaktoni se cilën duhet të paguani menjëherë dhe cilën mund ta shtyni për një periudhë të shkurtër kohe pa gjorbë të madhe. Mund të jetë e nevojshme të telefononi faturuesit tuaj për të parë nëse ka periudha të përkohshme që nuk kërkojnë pagesa [gjatë rasteve të ngutshme], mundësi skemash për pagesa pa interes ose zgjatje të afatit përfundimtar. Tregohuni të zgjuar se cilat shpenzime të paguani së pari dhe shqyrtoni pasojat e pafavorshme për shtyrjen e pagesave të faturave të tjera përpara se ta bëni këtë. Do t'ju nevojitet të ndaloni së bëri shpenzime të panevojshme për një periudhë, nëse është e mundur. Përqendrohuni tek ushqimi, strehimi, shërbimet komunale dhe transportimi i nevojshëm përpara se të bëni shpenzime të tjera.

Diskutoni: Përse do të ishte më e rëndësishme që të paguani së pari shpenzimet e renditura?

Telefononi Kreditorët Tuaj


Lexoni: Në rrethana ekstreme, mund të jetë gjë me mend të telefononi kreditorët tuaj dhe t'u shpjegoni situatën tuaj aktuale. Në varësi të krizës, ju mund të doni t'i kërkon:

- Shtyrje të përkohshme ose zvogëlim të pagesave.
- Zgjatje të huas ose ndryshim të përkohshëm për kriteret e saj.

Ndonëse kjo mund të jetë mundësia e vetme e arsyeshme në rastet ekstreme, kini kujdes se shtyrja e pagesave ose ndryshimi i kriterëve për huan tuaj mund t'ju çojë në taksa shtesë dhe ta bëjë huan më të shtrenjtë gjatë kohëzgjatjes.

Përcaktojini Burimet e Tjera që Mund të Vijnë në Ndihmë

Lexoni: Përgjegjësia jonë është të sigurojmë për veten dhe familjen tonë. Sidoqoftë, do të ketë raste kur do të na duhet të mbështetemi te të tjerët përkohësisht. Ndërsa kërkon burime të tjera, jini të kujdesshëm që të mos bëheni të varur te ndihma për një kohë të gjatë – një varësi e tillë do të pengojë përparimin tuaj shpirtëror dhe material. Teksa lexojmë te kapitulli 2, Presidenti Spenser W. Kimball dha mësim se ka katër nivele të ndihmës materiale tek të cilat mund të drejtohem:



1. **Vetvetja:** Së pari ju duhet të bëni gjithçka që mund ta bëni vetë për të siguruar për familjen tuaj dhe për ta lehtësuar kërcënimin e menjëhershëm.
2. **Familja:** Nëse nuk jeni në gjendje t'i plotësoni vetë nevojat financiare bazë pasi keni bërë gjithçka që ju vetë mundeni, ju duhet t'i drejtoheni një pjesëtari të ngushtë ose të afërm të familjes, nëse është e nevojshme, për mbështetje financiare të përkohshme, qoftë për strehim, ushqim ose nevoja të tjera.

3. **Kisha:** Pasi keni bërë gjithçka që mund ta bëni vetë dhe pasi të kërkonti ndihmë nga familja, mund të keni nevojë të takoheni me udhëheqësit tuaj të Kishës (peshkopin, presidentin e degës ose presidenten e Shoqatës së Ndihmës) për të shqyrtuar mundësi shtesë. Kujtoni se udhëheqësit tuaj të Kishës janë udhëzuar me urtësi që t'i ndihmojnë njerëzit ta përkrahin jetën kur është e nevojshme, jo stilin e jetesës.
4. **Komuniteti:** Programe përkrahëse të ndryshme komunitare ose shtetërore mund të jenë në dispozicion për ju që të mund t'ju ofrojnë ndihmë në formë këshillimi financiar ose për punësimin, ndihmë për strehimin, përkrahje për ushqimin e të porsalindurve dhe kujdesin për nënat shtatzëna, e të tjerë. Kujtoni se këto programe janë përcaktuar për të dhënë ndihmë afatshkurtër. Mos u mbështetni tek ata për një kohë të gjatë.

Diskutoni: Përse duhet të kërkojmë ndihmë nga familja jonë përpara se të kërkojmë ndihmë nga Kisha dhe komuniteti? Çfarë burimesh që përcaktoi grupi juaj janë në dispozicion në zonën tuaj për t'ju ndihmuar në kapërcimin e krizave?

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Përgjigjiuni në mënyrë të pavarur pyetjeve më poshtë dhe merrni parasysh se çfarë do të bëni për të përballuar një krizë financiare.

Nëse do të humbisja burimin e të ardhurave të mia, për sa kohë do të jetoja me kursimet e mia? (Sa ditë, javë apo muaj?)

Kush janë kreditorët e mi që do të më duhej t'i telefonoja për t'ia shpjeguar situatën time?

Te cilët pjesëtar të familjes apo miq mund të drejtohesha nëse do të më nevojitej ndihmë?

Hapi 2: Bashkohuni me partnerin tuaj në veprim (ose bashkëshortin/en tuaj nëse ndodhet aty) dhe diskutoni për përgjigjet tuaja. Diskutoni për mënyrat se si mund të përgatiteni më mirë tani për kohët e vështira në vazhdim. Shënoni idetë tuaja dhe bëni plane që t'i ndiqni.

2. SHTONI PËRGATITJET TUAJA PËR RASTET E NGUTSHME

Lexoni: Ju duhet të keni ose duhet të jeni duke punuar për të mbledhur një fond njëmuor për raste të ngutshme. Përgatitjet tuaja nuk duhet të përfundojnë në aty! Punoni për t'u çliruar nga borxhi konsumator dhe që më pas të mbledhni një fond tre deri gjashtë muor për raste të ngutshme dhe të kërkonit sigurime për të mbrojtur të ardhurat tuaja.

Mbledhni një Fond Tre deri Gjashtë Muor për Raste të Ngutshme

Lexoni: Pasi ta keni shlyer të gjithë borxhin tuaj konsumator, hapi tjetër është ta shtoni fondin tuaj njëmuor për raste të ngutshme në një fond tre deri gjashtë muor për raste të ngutshme. Kujtoni që t'i ruani paratë për fondin tuaj për raste të ngutshme në një vend të sigurt që të mund t'i merrni pa paguar gjobë. Shtojeni këtë fond sa më shpejt të jetë e mundur që të jeni më mirë të përgatitur për krizat financiare. Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë ta vlerësoni fondin tuaj për raste të ngutshme dhe të vazhdoni t'i shlyeni borxhet tuaja konsumatore.

Kërkoni Sigurime të Përshtatshme për Të Ardhurat

Shënim: Ky informacion mund të mos zbatohet për rajonin ose zonën tuaj.

Lexoni: Një nga pasuritë tuaja më të rëndësishme janë të ardhurat tuaja. Kërkoni për polica të besueshme sigurimi për paaftësinë fizike dhe për jetën në zonën tuaj dhe merrni mbulimin e përshtatshëm sa më shpejt të jetë e mundur.

DISKUTONI RRETH PËRGATITJES PËR KRIZAT FINANCIARE NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Një nga zotimet tuaja këtë javë do të jetë të diskutoni për përgjigjet tuaja për “Pikat për Buxhetin dhe Shpenzimet” (shih faqen 147) dhe për përgatitjet tuaja për krizat financiare. Diskutoni për rastet e ngutshme që mund të vijnë në familjen tuaj, si mund të përgatiteni për to, çfarë sigurimi mund t’ju nevojitet të merrni që t’ju ndihmojë ta mbron veten dhe planet për t’u telefonuar faturuesve dhe kreditorëve nëse e kërkon nevoja. Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar”. Kujtoni, nëse nuk jeni i/e martuar, këshilli juaj familjar mund të përfshijë një shok/shoqe të dhomës, mik/mikeshë, pjesëtar/e të familjes ose këshillues/e.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Si po ecni me buxhetin tuaj? (Shqyrtoni përgjigjet për veprimtarinë “Pikat për Buxhetin dhe Shpenzimet” në faqen 147.)
- Si po ecni me fondin tuaj njëmuor për raste të ngutshme?
- A jeni duke jetuar një jetë aq të drejtë sa ta meritoni ndihmën e Perëndisë gjatë një krize? Çfarë mund të përmirësoni?

Pjesa 2: Planifikoni

- Çfarë krizash financiare mund të ndodhin në familjen tuaj?
- S para ju nevojiten për fondin tre deri gjashtë muor për raste të ngutshme? Çfarë mund të bëni që të kurseni për të?
- Për çfarë gjërash ia vlen dhe nuk ia vlen ta përdorni fondin tuaj për raste të ngutshme?
- Çfarë mund të bëni më tepër që të përgatiteni për këto kriza?
- Çfarë sigurimi ju nevojitet të merrni për t’i mbrojtur të ardhurat, shëndetin dhe zotërimet tuaja?
- Çfarë mund të bëni për ta përmirësuar ose rregulluar buxhetin tuaj?



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Përgatitu dhe ji gati, ti dhe gjithë turmat e tua të mbledhura rreth teje, dhe ji roje për ta” (Ezekiel 38:7).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- (A)** Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- (B)** Do të vazhdoj të vë para për fondin tim për raste të ngutshme ose për borxhin e panevojshëm.
- (C)** Do të diskutoj si për "Pikat për Buxhetin dhe Shpenzimet" (shih faqen 147) edhe rreth përgatitjes për krizat financiare në këshillin tim familjar.
- (D)** Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim

[illegible]

SHĚNIME

[illegible]



10

INVESTIMI PËR TË ARDHMEN (PJESA 1)

PARIMI NGA THEMELI IM

- Kërkoni të Mësoni: Zgjidhni se Ku po Shkoni dhe Si të Arrini Atje

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Kurseni Para
2. Merreni Parasysh Pronësinë e Shtëpisë
3. Kërkoni të Arsimoheni



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të vazhdoj të vë para për përparësinë time financiare.
- Ⓒ Të diskutoj për përgjigjet në lidhje me “Pikat për Buxhetin dhe Shpenzimet” dhe rreth përgatitjes për krizat financiare gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për të vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Partneri mbi mënyrën se si mund të vashdhen të përparësishëm tekni udhëzohen për formimin e kësaj zotimese të rinovueshme.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme					
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj partnerin Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia	Ⓒ Më kujt rreth Këshillit të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjithë Koha e Partnerit në Veprim	
Shembull: Të jem në bindur	Regjistroj shpenzimet	Kishibihuri mbi bindjen			AN
Jana 1 Mësojta se vepra e mia për partnerin shpenzimet	Regjistroj shpenzimet	Kishibihuri mbi Zotim			
Jana 2 Të udhëtoj bashkë me juca kuzhinë	Regjistroj shpenzimet	Kishibihuri mbi të ardhurat dhe shpenzimet			
Jana 3 Të përdorshem dhe të jem në bindur	Regjistroj shpenzimet	Kishibihuri mbi të dhënat dhe ofertat			
Jana 4 Të jem një pjesë e korrespondencës	Harxhoj një burimet	Kishibihuri mbi bindjen e burimeve			
Jana 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një shtesë për burimet	Kishibihuri mbi bindjen e burimeve			
Jana 6 Të përdorshem me mangut	Calloj para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi bindjen për rastet të regjistrimit, ligjshmërisë			
Jana 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi bindjen			
Jana 8 Puna të marr përgjegjësi dhe të kumbullat	Vendos para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi bindjen			
Jana 9 Të komunikoj të bëj vlerësime dhe të dëgjoj	Vendos para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi administrimin e rasteve të krizës			
Jana 10 Kumbullat mbiq: Vlerësoni rrethit pa ofenduar dhe se si të arrijnë atë	Vendos para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi burimet, prirësitë e shprehur, arsimin			
Jana 11 Të bashkë më një, të shprehëmi që bashko	Vendos para për një përparësi financiare	Kishibihuri mbi planifikimin për partnerin			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecnit rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Si shkoi diskutimi juaj rreth buxhetit dhe shpenzimeve tuaja?
 - Çfarë vendosët të bënit për t'u përgatitur më mirë për krizat financiare?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: KËRKONI TË MËSONI

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Si na krijon mundësi të nxëniti?

Shihni: “Education for a Better Life” [“Arsimim për një Jetë më të Mirë”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 165.)

Diskutoni: Çfarë donte Plaku Jozef W. Sitati kur ishte 13 vjeç? Çfarë bëri ai rreth kësaj?

Lexoni: Doktrinën e Besëlidhjet 88:118–119 dhe citimin nga Presidenti Gordon B. Hinkli (në të djathtë)

Përsiatni: Çfarë mendimesh dhe përshtypjesh keni pasur nga Fryma e Shenjtë rreth përmirësimit të jetës suaj?

VEPRIMTARI – KRIJIMI I NJË “MISIONI TË JETËS”

Hapi 1: Lexojeni citimin nga Presidenti Henri B. Ajring (në faqen 163). Zoti ka një plan për ju. Ai ju ka bekuar me dhurata dhe talente të veçanta që do t’ju lejojnë të bëheni çdo gjë që Ai dëshiron që ju të bëheni. Ju mund ta përmbushni misionin tuaj këtu në tokë nëse jeni të zellshëm në kërkimin që ta kuptoni vullnetin e Tij për ju dhe t’i bindeni atij.

Hapi 2: Përgjigjuni pyetjeve më poshtë që të filloni të krijoni përfytyrimin apo “misionin e jetës” suaj.

MISIONI I JETËS SIME

Ku dua të jem pas pesë vjetësh?

Përse?

Çfarë aftësish, njohurish ose përvoja më nevojiten për të arritur atje?

“Kërkoni me zell dhe i mësoni njëri-tjetrit fjalë urtësie; po, kërkoni nga librat më të mirë fjalët e urtësisë; kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit. . . . Ngrini një shtëpi . . . mësimi.”

DOKTRINA E BESËLIDHJE 88:118–119

“Ne kemi një përgjegjësi dhe një sfidë për të zënë vendet tona në botën e biznesit, shkencës, qeverisë, mjekësisë, arsimit dhe çdo profesioni tjetër me vlerë e dobiprurës. Ne kemi një detyrim për t’i stërvitur duart dhe mendjet tona që të shquhen në punën e botës për bekimin e gjithë njerëzimit.”

GORDON B. HINCKLEY, “A City upon a Hill”, *Ensign*, korrik 1990, f. 5

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë kësaj jave. Shenjojeni rutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Plotësojini synimet vijuese dhe vihuni në rolin e këshilluesit për veprimtaritë.
- ☐ Përfundojeni së shkruari planin e "misionit të jetës" suaj dhe diskutojeni atë me familjen tuaj.
- ☐ Kërkojini dikujt të jetë këshilluesi juaj dhe caktoni një kohë për t'u takuar.

VEPRIMTARIA – KRIJIMI I SYNIMEVE

Hapi 1: Lexojeni citimin nga Presidenti Hauard W. Hanter (në të djathtë). Nëpërmjet synimeve, shpresat tona shndërrohen në veprime.

Synimet duhet:

1. Të jenë specifike dhe të matshme.
2. Të shkruhen diku dhe të vendosen atje ku mund t'i shihni të paktën çdo ditë.
3. Të kenë afate për t'u përmbushur.
4. Të kenë veprime të veçanta që duhet të ndërmerren për ta përmbushur synimin.
5. Të shqyrtohen, raportohen dhe përditësohen vazhdimisht.

Hapi 2: Në një fletë të veçantë letrë, shkruani dy ose tri synime që do t'ju ndihmojnë ta arrini misionin e jetës suaj. Ndiqeni shembullin më poshtë. Vendosi letrën atje ku mund ta shihni çdo ditë.

SYNIMI	PËRSE?	HAPA TË VEÇANTË PËR TA ARRITUR SYNIMIN	RENDI KOHOR	KUJT DO T'IA RAPORTOJ PËRPARIMIN TIM?
SHEMBULL: Lexojeni Librin e Mormonit për 30 minuta çdo ditë.	Që unë të mund të marr udhëheqje të përditshme nga Fryma e Shenjtë.	1. Ngrihem në orën 06:30 të mëngjesit çdo ditë. 2. Lexoj përpara se të ha mëngjes. 3. E shënoj përparimin tim në tabelë.	Do të bëj një vlerësim të përparimit tim çdo natë përpara se të shkoj në shtrat.	Do t'ia tregoj tabelën time të përparimit një pjesëtar të familjes çdo të diel.

"Përgjërrohuni që Shpirti t'ju tregojë atë që Zoti dëshiron që të bëni. Planifikoni që ta bëni këtë. Premtojini Atij se do të bindeni. Veproni me vendosmëri derisa ta keni bërë atë që Ai kërkoi. Dhe pastaj lutuni . . . për të ditur se çfarë mund të bëni pastaj."

HENRI B. AJRING,
"Veproni Gjithë Zell",
Ensign ose *Liahona*,
maj 2010, f. 63

"Ky është një ungjill pendimi dhe ne kemi nevojë të pendohemi dhe të zgjedhim të veprojmë më mirë. Me të vërtetë, procesi i pendimit, i bërjes së zotimeve dhe i vendosjes së synimeve duhet të jetë i vazhdueshëm. . . . Jua rekomandoj këtë praktikë."

HOWARD W. HUNTER, "The Dauntless Spirit of Resolution" (takim shpirtëror në Universitetin "Brigam Jang", 5 janar 1992), f. 2, speeches.byu.edu

VEPRIMTARIA – GJETJA E NJË KËSHILLUESI

Hapi 1: Lexojeni citimin nga Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë). Ka lloje të ndryshme këshilluesish. Juve mund t’ju nevojitet dikush me shumë përvojë për t’iu përgjigjur pyetjeve tuaja – dikush që e ka bërë atë që doni të bëni ju. Këshillues të tjerë mund të jenë miqtë ose pjesëtarët e drejtë të familjes. Këta njerëz janë të gatshëm të shpenzojnë më shumë kohë duke ju nxitur që të bëni ndryshime në jetën tuaj dhe duke ju mbajtur përgjegjës për përparimin.

Hapi 2: Mendoni rreth llojit të ndihmës që ju nevojitet. Shkruani një listë të njerëzve që mund të jenë këshilluesit tuaj. Përsiatni dhe lutuni për listën tuaj të emrave.

Hapi 3: Përgjigjuni pyetjeve më poshtë që të filloni një marrëdhënie këshilluese. Për ta ftuar dikë që të jetë këshilluesi juaj, ju thjesht mund të pyetni: “Po përpiqem të bëj një ndryshim në jetën time. A do të ishit i gatshëm të më ndihmonit?”

KËSHILLUESI IM

Kë do të donit të ishte këshilluesi juaj?

Kur do t’i kërkonti atij apo asaj që të jetë këshilluesi/ja juaj?

Kur mund të takoheni për t’i treguar “misionin e jetës” suaj dhe synimet tuaja?

Sa shpesh do të donit të takoheshit me këshilluesin/en tuaj?

Hapi 4: Mbajeni mend se ju jeni përgjegjës për “misionin e jetës” suaj. Kur të takoheni me këshilluesin tuaj:

- Shqyrtojeni përparimin tuaj.
- Shqyrtojini pengesat në përparimin tuaj dhe atë që po bëni për t’i kapërcyer ato.
- Shqyrtojeni veçanërisht atë që planifikoni të bëni përpara se të takoheni me këshilluesin tuaj sërish.

“Në vitet e mia të moshës madhore, unë kam kërkuar këshillë nga prindërit e mi dhe nga këshilltarë besnikë e të besuar. Njëri ishte një udhëheqës i priftërisë; tjetri një mësues që besoi tek unë. . . . Me lutje zgjidhni këshillues që shqetësohen sinqerisht për mirëqenien tuaj shpirtërore.”

ROBERT D. HEJLS,
“Përballja me Sfidat e
Botës së Sotme”,
Ensign ose Liahona,
nëntor 2015, f. 46

ARSIMIM PËR NJË JETË MË TË MIRË

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PLAKU JOZEF W. SITATI: Në moshën 13-vjeçare jetoja në një pjesë tepër rurale të Kenias. Njerëzit kishin shumë pak gjëra. Por ata që dukeshin se i siguronin gjërat që të tjerët i admironin, ishin ata që kishin një arsimim të mirë. Arrita ta kuptoj se arsimimi ishte një çelës për një jetë më të mirë.

Vazhdonte të më vinte mendimi që të shkoja e të flisja me drejtorin e njëres prej shkollave që dëshiroja me të vërtetë ta frekuentoja. Më nevojitej biçikleta e babait për ta bërë këtë udhëtim për të cilin duhej gjysmë dite. Nuk kisha dalë kurrë prej fshatit tim. Nuk dija se si të flisja anglisht shumë mirë dhe ky drejtor ishte një burrë i bardhë. Kurrë më parë nuk kisha takuar apo folur drejtpërdrejt me një burrë të bardhë, kështu që ky ishte një mendim që më trembi.

Diçka brenda meje vazhdonte të më shtynte dhe të më thoshte që duhej të bëja këtë, kështu që u nisa për të takuar drejtorin. Kur e vështrova, mund të shikoja se ai qe pothuaj i befasuar kur e pa këtë të ri që qëndronte si një ushtar përpara tij. Ai kishte sy dashamirës, kështu që kjo më dha zemër. I thashë se doja me të vërtetë të hyja në shkollën e tij dhe do të isha

shumë i lumtur nëse do të më pranonte. Pastaj ai tha: “Epo, do të shohim kur të dalin rezultatet e provimit”. I thashë: “Faleminderit, zotëri”. Për më pak se katër minuta dola nga zyra.

Ato katër minuta që kalova në atë zyrë, ishin me të vërtetë çastet vendimtare në jetën time. Isha i vetmi nxënës nga shkolla ime fillore që u përzgjedh në një nga shkollat më të mira në zonën tonë. Fakti që ky burrë i mirë ma kishte dhënë këtë mundësi, më bëri mirënjohës dhe më frymëzoi që të përpiqesha të isha nxënësi më i mirë në klasën time.

Kjo hapi mundësi të reja për mua që të shkoja në një tjetër shkollë të mirë dhe më pas të përgatitesha për universitet. Arsimimi im bëri të mundur që të gjeja bashkëshorten time në universitet. Kjo bëri të mundur që të gjeja një punë në qytet. Ndërkohë që jetonim në Nairobi, ne u ndeshëm me një çift misionarësh që na ftuan në shtëpinë e tyre, ku zhvillonin mbledhje me ata që ishin anëtarë të Kishës. Nëse nuk do kisha qenë në Nairobi në atë kohë, nuk do ta kisha gjetur kurrë ungjillin. Fakti që isha në një punë të sigurt, më mundësoi të shërbeja në Kishë.

Dëshmoj se arsimimi është një çelës për mbështetjen te vetja. Do të hapë shumë rrugë që ju të jeni në gjendje të siguronit për veten tuaj materialisht si edhe të bëheni të mbështetur te vetja shpirtërisht.

Kthehuni te faqja 162.




MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

4

KURSENI DHE INVESTONI PËR TË ARDHMEN



BESIM NË JEZU KRISHT • UNITET ME
BASHKËSHORTIN/EN
ZOTIM NDAJ MBËSHTETJES TE VETJA

**HARTA E SUKSESIT PËR
KUJDESTARINË FINANCIARE**

Lexoni: Kur njerëzit dëgjojnë termin *investim*, ata mund të mendojnë për një sallë burse të zhurmshme dhe kaotike me njerëz që shesin aksione dhe bonde. Ndonëse mund të jetë pjesë e investimit, **investimi** është gjithashtu akti i dhënies së kohës, përpjekjeve ose parave për diçka dhe pritja e njëfarësoj fitimi. Në këtë kuptim, investimi është një element i mbështetjes te vetja.

Në këtë kapitull, ju do të zbuloni tri mënyra se si të investoni:

1. Kurseni para
2. Merreni parasysh pronësinë e shtëpisë
3. Kërkoni të arsimoheni

1. KURSENI PARA


Përsiatni: Shpenzoni dy minuta për të menduar rreth pyetjes vijuese dhe hidhni në letër mendimet tuaja: Për çfarë do të më pëlqente më shumë që të kurseja?

Lexoni: Një nga mënyrat më të lehta për të investuar është të kurseni para. Ju keni punuar që të mblidhni një fond për raste të ngutshme, duke filluar me vlerën e shpenzimeve të një muaji dhe më pas duke e mbledhur që të arrijë vlerën e shpenzimeve të tre deri gjashtë muajve. Përfytyrojini mundësitë [që do të kishit] po të vazhdoni të kurseni edhe pas krijimit të një fondi të qëndrueshëm për raste të ngutshme.


Plaku L. Tom Peri dha mësim: “Paguajini vetes një shumë të paracaktuar për ta kaluar direkt te kursimet. . . . Për mua është e habitshme që kaq shumë njerëz punojnë gjithë jetën e tyre për pronarin e dyqanit, qiradhënësin, kompanitë elektro-energjetike, shitësit e makinave dhe bankën e prapëseprapë mendojnë kaq pak për vetë përpjekjet e tyre sa që nuk i paguajnë asgjë vetes” (“Becoming Self-Reliant”, *Ensign*, nëntor 1991, f. 66).

Siç u shpjegua më parë me shembullin e kavanozit, është shumë e rëndësishme të “paguajmë për veten” së pari duke vendosur para te kursimet. Kjo do t’ju ndihmojë të krijoni një siguri financiare.

QASJA E ZAKONSHME



QASJA E MBËSHTETJES TE VETJA



Diskutoni: Harxhoni një minutë kohë për ta shqyrtuar përsëri shembullin me kavanozin. Çfarë është më domethënëse për ju rreth këtij shembulli? Si po e tregoni besimin me vepra duke ndjekur qasjen e mbështetjes te vetja?

2. MERRENI PARASYSH PRONËSINË E SHTËPISË

Lexoni: Blerja e një shtëpie mund të jetë një mënyrë tjetër investimi. Pronësia e shtëpisë nuk është për këdo, sidoqoftë, dhe shpesh qiraja mund të jetë një mundësi më e mirë.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Ndahuni në grupe me nga dy ose tre njerëz dhe shpenzoni pak minuta duke shqyrtuar gjërat pozitive dhe negative që janë renditur më poshtë për pronësinë e një apartamenti kundrejt marrjes së një apartamenti ose shtëpie me qira. Shtoni edhe disa nga vetë idetë tuaja te listat më poshtë.

Hapi 2: Më pas mbledhuni sërish bashkë dhe diskutoni për pyetjet vijuese: Çfarë mësuat? Çfarë gjërash të tjera pozitive dhe negative hodhët në letër?

GJËRAT POZITIVE TË QIRASË	GJËRAT NEGATIVE TË QIRASË
Kosto më të ulëta për mirëmbajtjen Më e lehtë të shpërngulesh	Nuk e kam në “pronësi” Qiraja mund të rritet
GJËRAT POZITIVE TË PRONËSISË	GJËRAT NEGATIVE TË PRONËSISË
Shtëpisë mund t’i rritet vlera (vlerësimi) Ju filloni ta kini shtëpinë në pronësi	Kostot për mirëmbajtjen Mund të jetë e vështirë ta shesësh dhe të shpërngulesh

Lexoni: Për ata që po marrin parasysh pronësinë e shtëpisë, mbajini mend këto dy parime:

- Blini një shtëpi vetëm kur dhe ku t’ju duket e përshtatshme.
- Blini vetëm atë që mund ta përballoni lehtësisht.

Tani le të diskutojmë për disa faktorë që mund të ndikojnë te këto parime.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Përgjigjuni në mënyrë të pavarur pyetjeve më poshtë. Nëse nuk mund t'iu përgjigjeni me "po" këtyre pyetjeve, marrja me qira në situatën tuaj aktuale mund të jetë një mundësi më e mirë sesa blerja.

A KA MË SHUMË KUPTIM PËR MUA QË TA BLEJ, NË VEND QË TA MARR ME QIRA?

- ☐ A jam i/e lirë nga borxhi konsumator?
- ☐ A kam një fond 3 deri 6-mujor për raste të ngutshme?
- ☐ A po jetoj sipas buxhetit dhe a e di se çfarë shume pagese mund ta përballoj lehtësisht?
- ☐ A kam kursyer para mjaftueshëm për një pagesë paraprake?
- ☐ A kam një vend punësimi të qëndrueshëm?
- ☐ A planifikoj ta kem në pronësi shtëpinë për të paktën 5 vjet?
- ☐ A mund t'i përballoj kostot shtesë për mirëmbajtjen dhe sigurimin e shtëpisë sime dhe pagimin e taksave për pronën?

Diskutoni: Përse janë të rëndësishme këto pyetje që t'ia bëni vetes përpara se të blini një shtëpi?

Lexoni: Shumë njerëz blejnë një shtëpi duke përdorur një hua që quhet *kredi*. Kjo kredi është një borxh dhe do t'ju kërkojë interes. Nga ju pritet që të bëni pagesat mujore dhe ta shlyeni huan.

Për një qëndrueshmëri financiare afatgjate, pagesa mujore për kredinë tuaj nuk duhet ta kalojë 25 përqind të të ardhurave tuaja mujore. Përdoren këto si udhërrëfim për atë që mund të përballoni ta paguani, në vend të asaj që huadhënësi është i gatshëm t'ju japë hua.



VEPRIMTARIA PËR LLOGARITJE

Në Shtetet e Bashkuara, të ardhurat mesatare për familje në vitin 2013 ishin rreth 52 000 dollarë. Sa është shuma më e lartë e parave që duhet të shpenzojë çdo muaj për pagesën e kredisë një familje që fiton 52 000 dollarë në vit?

Si grup, vendoseni informacionin vijues te makinat tuaja llogaritëse. Ndaluni në çdo hap për t'u siguruar që çdokush të marrë të njëjtën përgjigje përpara se të kalojë në hapin tjetër.

HAPAT	LLOGARITJET
25% e 52 000 = shpenzimi vjetor për kredinë	$.25 \times 52\,000 = 13\,000$
13 000 pjesëtuar me 12 muaj = shpenzimi mujor për kredinë	$13\,000 \div 12 = 1\,083$

Një familje me këto të ardhura do të bënte mirë të sigurohej që pagesa e tyre mujore për shtëpinë të mos e kalojë shifrën 1 100 dollarë.

Tani, në mënyrë të pavarur ose me bashkëshortin/en tuaj (nëse është e mundur), llogaritni 25 përqind të të ardhurave tuaja mujore duke ndjekur hapat më lart. Ju nuk keni nevojë t'ia tregoni këtë shifër asnjë tjetri në grup nëse nuk parapëlqeni ta bëni. Shkruajeni përgjigjen tuaj këtu _____

Diskutoni: Çfarë do të thotë për ju të blini një shtëpi që mund ta përballoni lehtësisht?

Lexoni: Mbajeni në mendje se ka shpenzime të tjera për pronësinë e shtëpisë përveç kredisë. Kur keni në pronësi një shtëpi, ju jeni përgjegjës për mirëmbajtjen. Gjërat thyhen, vjetrohen dhe ndonjëherë kanë nevojë të zëvendësohen. Këshilluesit financiarë në përgjithësi rekomandojnë të kursehet të paktën 1 përqind e vlerës së shtëpisë suaj çdo vit për mirëmbajtje.



ÇEQE SHPËRBLIMI

Fill kur filluam të mësonim së pari rreth kujdestarisë financiare, unë fillova një punë të re që i paguante shpërblimet tremujore. Me ato para shtesë, ne vendosëm të përdornim një pjesë të tyre për të kursyer dhe pjesën tjetër për një pagesë kredie shtesë. Ne i bëmë përlllogaritjet dhe kjo pagesë shtesë për çdo tremujor do të na kursejë mijëra dollarë interes!

Dilni nga Borxhi i Kredisë

Lexoni: Siç u shpjegua më parë, një kredi është një hua – është borxh – dhe ju kushton edhe shumën e interesit. Duke përsëritur mësimet e Presidentit J. Ruben Klark, Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Secili nga krerët e familjes le të synojë të lirohet nga kredia e shtëpisë së vet” (“Prepare for the Days of Tribulation”, *Ensign*, nëntor 1980, f. 33). Shlyerja e kredisë sa më shpejt mund të kërkojë pak sakrificë, por sa më shpejt ta shlyeni aq më shumë para të paguara për interesin kurseni. Ka dy mënyra për ta paguar kredinë tuaj:

- Paguani shtesë
- Krijoni një hua afatshkurtër me një normë më të ulët interesi

Pagesa shtesë për shumën themelore mund t’ju kursejë shumë vite pagesash dhe dhjetëra mijëra dollarë interes. Për shembull, nëse keni pasur një kredi 30-vjeçare prej 150 000 dollarësh me një normë interesi 4,5 përqind, ju do të paguanit 123 610 dollarë interes gjatë gjithë kohëzgjatjes së huas. Shikoni tabelën më poshtë për të parë se sa kohë dhe para mund të kurseni duke paguar 100 ose 200 dollarë shtesë në muaj.

	100 DOLLARË SHITESË NË MUAJ	200 DOLLARË SHITESË NË MUAJ
Koha e kursyer	Pothuajse 7 vjet	Pothuajse 11 vjet
Paratë e kursyera	29 715	47 462

Një mundësi tjetër për ta shlyer kredinë më shpejt, është të merrni një kredi afatshkurtër. Kreditë afatshkurtra zakonisht vijnë me norma interesi më të ulëta. Pagesa juaj mujore është më e lartë por ju do të kurseni vite pagesash dhe mijëra dollarë për interesin.

Le ta krahasojmë të njëjtën kredi si më parë, por këtë herë me një hua 15-vjeçare. Shembulli i parë ishte një kredi 30-vjeçare prej 150 000 dollarësh me një normë interesi prej 4,5 përqind. Le ta krahasojmë atë me një kredi 15-vjeçare me normë interesi prej 3,5 përqind.

	KREDI 30-VJEÇARE	KREDI 15-VJEÇARE
Norma e interesit	4,5%	3,5%
Pagesa mujore	760	1 072
Totali i interesit të paguar	123 610	43 018
Koha për ta shlyer	30 vjet	15 vjet

Në këtë rast, një kredi 15-vjeçare do të thotë një pagesë mujore prej rreth 312 dollarë më shumë, por do t'ju kursente:

- 15 vjet pagesa kredie.
- Më shumë se 80 000 dollarë interes.

Diskutoni: Nga çfarë do të ishit i gatshëm të hiqnit dorë me qëllim që të paguanit shtesë për kredinë tuaj ose për të marrë një kredi afatshkurtër që të liroheshit më shpejt nga borxhi?

3. KËRKONI TË ARSIMOHENI

Lexoni: Arsimimi është një formë tjetër investimi. Zakonisht, trajnimet shtesë ose arsimimi do të kenë një kosto. Nëse do të investoni në arsimim, sigurohuni që t'ju çojë drejt një pune më të mirë, që të mund të merrni fitime të mira nga investimi juaj. Presidenti Gordon B. Hinkli këshilloi se “bota në masë të madhe do t’ju paguajë aq sa mendon se vleni dhe vlera juaj do të rritet ndërsa merrni një arsimim dhe zotësi në fushën që keni zgjedhur” (“A Prophet’s Counsel and Prayer for Youth”, *Ensign*, janar 2001, f. 4).

Ndonjëherë mund të jetë e përshtatshme që të hyni në borxh për të marrë një arsimim por ka edhe shumë mënyra të tjera për ta paguar shkollën. Shqyrtojini të gjitha mundësitë e tjera përpara se t’i drejtoheni borxhit. Nëse atëherë hyni në borxh për arsimimin, përpiquni ta shlyeni sa më shpejt të jetë e mundur.

Grupi i mbështetjes te vetja Arsimim për Punë më të Mirë mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për ju kur të merrni parasysh që të investoni për arsimimin.

Diskutoni: Në ç’mënyrë arsimimi është një investim për ju?

DISKUTONI PËR KURSIMIT E PARAVE, SYNIMIN PËR PRONËSINË E SHTËPISË DHE INVESTIMIN PËR VETEN NËPËRMJET ARSIMIMIT NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Një nga zotimet tuaja të kësaj jave do të jetë të diskutoni për kursimet, pronësinë e shtëpisë dhe investimin për arsimimin tuaj gjatë këshillit familjar. Diskutoni për gjërat që do të donit të kurseni, nëse duhet të merrni me qira një shtëpi apo do ta blini atë (ose si mund të filloni ta shlyeni kredinë tuaj) dhe për çfarë synimesh për arsimimin, duhet të punoni nëse ka ndonjë. Ju mund të doni të përdorni përvijimin më poshtë “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar”.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Për çfarë do të donit të kursenit në një ditë të ardhme? Shqyrtojeni përgjigjen tuaj për pyetjen me përsiatje në faqen 167.
- Cilat janë disa nga gjërat pozitive dhe negative për pronësinë e një shtëpie kundrejt marrjes me qira? Shqyrtojeni veprimtarinë në faqen 169.

Pjesa 2: Planifikoni

- Si mund të kurseni për dëshirat tuaja në të ardhmen?
- Nëse nuk keni një shtëpi në pronësi aktualisht, a duhet ta merrni parasysh ta blini një të tillë? Apo duhet të vazhdoni ta merrni me qira për momentin?
- Nëse keni në pronësi një shtëpi aktualisht, si mund të punoni për ta paguar më shpejt kredinë tuaj? A do të jetë më e përshtatshme për situatën tuaj aktuale shitja e shtëpisë dhe marrja e saj me qira për një kohë?
- Për çfarë lloj arsimimi ose arsimimi shtesë, nëse ka ndonjë, duhet të investoni për të pasur një punë më të mirë?



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; por ajo nuk u shemb, sepse ishte themeluar mbi shkëmb” (Mateu 7:24–25).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do të vazhdoj të vë para për përparësinë time financiare.
- Ⓒ Do të diskutoj për kursimin e parave, qiramarrjen kundrejt blerjes së një shtëpie dhe investimin për arsimimin gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim

[illegible]

SHĚNIME



11

INVESTIMI PËR TË ARDHMEN (PJESA 2)

PARIMI NGA THEMELI IM

- Bëhuni Një, Shërbeni së Bashku

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Vendosni një Synim për Pensionin
2. Kuptojeni Interesin e Përbërë
3. Kuptojeni Marrëdhënien ndërmjet Rrezikut dhe të Ardhurave
4. Merrni Parasysh Investime të Mundshme
5. Bëni Kërkime për Llogari të Mundshme për Pensionin
6. Filloni të Kurseni për Pensionin sa më Parë të Jetë e Mundur



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR:

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të vazhdoj të vë para për përparësinë time financiare.
- Ⓒ Të diskutoj për kursimin e parave, blerjen e një shtëpie kundrejt marrjes së saj me qira dhe investimin për arsimin gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta për-krah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën "Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia" në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA					
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Partneri mbi mënyrën se si mund të veshkohen të përmirësohen teksta udhëzues për formimin e këtyre zotimeve të rëndësishme.					
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Maksimale ● Përpjekje të Rëndësishme					
Ⓐ	Ⓑ	Ⓒ	Ⓓ	Ⓔ	Ⓕ
E vë në praktikë dhe e tregoj parimin Themeli Im	I Planifikoj dhe i Administroj Financat e Mia	Mëq një Këshill të Familjes	Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjeneroj Mënyrë të Reja për të Vlerësuar	
Shprehja Të jem i bindur	Regjistroj dispancet	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 1 Mësohetja të vija kërkë një parim origjinal	Regjistroj dispancet	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 2 Të ushtroj besim të jeta kërkë	Regjistroj dispancet	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 3 Të përdorim dhe të jem i bindur	Regjistroj dispancet	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 4 Të jem një pjesë të bashkëpunimit	Regjistroj dispancet	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 5 Të zgjedh përdorimet	Zgjedh një sistem për bashkëpunim	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 6 Të përdorim kohën me mënyrë	Calloj para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 8 Puna të marr përgjegjësi dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 9 Të komunikoj të bëj kërkë dhe të mësoj	Vendos para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 10 Kërkë të mësoj vendosim se ku po shkon dhe se si të arrijmë atje	Vendos para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			
Javë 11 Të bashkëpunoj të shprehim bindjen	Vendos para për një përpjekje financiare	Kërkohet mbi bindjen			

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Si po ju shkon puna me përparësinë tuaj financiare?
 - Si shkoi diskutimi juaj gjatë këshillit familjar për pronësinë e shtëpisë dhe për synimin e mundshëm të një arsimimi shtesë?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: BËHUNI NJË, SHËRBENI SË BASHKU

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Si më shpëton mua në të vërtetë humbja e vetvetes në shërbimin ndaj të tjerëve?

Shihni: “In the Lord’s Way” [“Në Mënyrën e Zotit”], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 183.)

Diskutoni: Si mund t’i hapë pragjet e qiellit në jetën tuaj shërbimi ndaj të tjerëve?

Lexoni: Disa njerëz mendojnë se ata e meritojnë atë që të tjerët e kanë tashmë, gjë e cila mund të shkaktojë pakënaqësi. Të tjerë mendojnë se kanë të drejtën për të pasur gjëra që nuk i kanë fituar. Këto dy kurthe i verbojnë njerëzit që të shohin një të vërtetë thelbësore: të gjitha gjërat i përkasin Perëndisë. Mëria dhe e drejta për ta pasur diçka mund të mposhten duke u përqendruar te nevojat e të tjerëve. Lexoni te Mosia 2:17, Mosia 4:26 dhe citimin nga Presidenti Gordon B. Hinkli (në të djathtë).

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Si grup, mendoni për dikë që ka nevojë për ndihmë.

Hapi 2: Diskutoni për talentet, kontaktet dhe burimet që keni për të dhënë.

Hapi 3: Bëni një plan për t’i shërbyer atij personi. Për shembull, ju mund:



- Të kryeni një projekt shërbimi në komunitetin tuaj.
- Të përgatitni historinë tuaj familjare duke përdorur broshurën *Familja Ime: Histori që na Bashkojnë*. Pastaj shkoni në tempull dhe kryejini ordinancat e shenjta për pjesëtarët e familjes që kanë vdekur.
- Ta ndihmoni dikë në shtegun e tij ose të saj drejt mbështetjes te vetja.

“Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj.”

MOSIA 2:17

“Dhe tani, për hirin . . . e ruajtjes së një heqjeje të mëkateve tuaja nga dita në ditë, . . . unë do të doja që ju t’u jepni nga pasuria juaj të varfërve, çdo njeri sipas asaj që ka, në mënyrë që të ushqehen të uriturit, të vishen të zhveshurit, të vizitohen të sëmurët dhe t’u jepni ndihmë atyre qoftë shpirtërisht, ashtu edhe materialisht, sipas nevojave të tyre.”

MOSIA 4:26

“Kur ju jeni të bashkuar, fuqia juaj është e pakufishme. Ju mund të arrini çfarëdo gjëje që dëshironi të arrini.”

GORDON B. HINCKLEY,
“Your Greatest Challenge, Mother”,
Ensign, nëntor 2000,
 f. 97

Lexoni: Citimet nga Plaku Robert D. Hejls dhe Presidenti Tomas S. Monson (në të djathtë)

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjoni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- ☐ Veproni sipas planit që bëtë për t'i shërbyer dikujt.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth shërbimit.

NË MËNYRËN E ZOTIT

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



PRESIDENTI HENRI B. AJRING:

Parimet në themelin e programit të Kishës për mirëqenien janë jo vetëm për një kohë apo një vend. Ato janë për të gjitha kohët e për të gjitha vendet. . . .

. . . Mënyra se si duhet bërë ajo, është e qartë. Ata që kanë grumbulluar më shumë, duhet ta përuhin veten për t'i ndihmuar njerëzit nevojtarë. Ata që kanë bollëk, duhet të sakrifikojnë vullnetarisht një pjesë të rehatisë, kohës, aftësive dhe burimeve të tyre për të lehtësuar vuajtjen e njerëzve nevojtarë. Dhe ndihma duhet dhënë në një mënyrë që e rrit fuqinë e marrësve për t'u kujdesur për veten e tyre e më pas të kujdesen për të tjerët. Nëse bëhet kështu, në mënyrën e Zotit, diçka mbresëlënëse mund të ndodhë. Edhe dhënësi, edhe marrësi bekohet.

(Përshtatur nga një fjalim i dhënë nga Presidenti Ayring në përkushtimin e Qendrës së Shërbimeve për Mirëqenien në Shugërhauz të Jutas, qershor 2011, LDS.org)

PRESIDENTI DITER F. UHTDORF:

Vëllezër e motra, secili prej nesh ka një përgjegjësi prej besëlidhjeve që të jetë i ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve dhe të shërbejë ashtu siç bëri Shpëtimtari – për të ndihmuar, bekuar dhe ngritur moralisht ata që janë rreth nesh.

Shpesh, përgjigjja ndaj lutjes sonë nuk vjen kur jemi në gjunjë, por ndërsa jemi në këmbë, duke i shërbyer Zotit dhe duke u shërbyer atyre që janë rreth nesh. Veprimet vetëmohuese të shërbimit dhe përkushtimit kullojnë shpirtrat tanë, i heqin luspat nga sytë tanë shpirtërorë dhe hapin pragjet e qiellit. Duke u bërë përgjigjja për lutjen e një tjetri, ne shpesh gjejmë përgjigjen për lutjen tonë.

(“Duke Pritur në Rugën për Damask”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 76)

Kthehuni te faqja 182.

“Qëllimi i mbështetjes materiale dhe shpirtërore te vetja është që ta sigurojmë veten shpirtërisht dhe materialisht, në mënyrë që t'i ndihmojmë dhe të tjerët që janë në nevojë.”

ROBERT D. HEJLS, “Të Vijmë në Vete: Sakramenti, Tempulli dhe Sakrifika e Shërbimit”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2012, f. 36

“Kur punojmë së bashku në mënyrë bashkëpunuese, . . . ne mund të arrijmë çfarëdo gjëje. Kur bëjmë kështu, ne e shfarosim dobësinë e një njeriu që qëndron i vetëm, dhe e zëvendësojmë me forcën e shumë njerëzve që shërbejnë së bashku.”

THOMAS S. MONSON, “Church Leaders Speak Out on Gospel Values”, *Ensign*, maj 1999, f. 118



MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



DISKUTIMI I SOTËM:

4

KURSENI DHE INVESTONI PËR TË ARDHMEN

Lexoni: Në kapitullin e mëparshëm, ne mësuam se investimi është të japësh kohën, përpjekjen ose paratë në diçka dhe të presësh një lloj fitimi. Një nga arsyet që ne mund të investojmë para është që të kemi mjaftueshëm para kur të dalim në pension.

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim: “Teksa shkoni përpara në jetë drejt daljes në pension dhe dhjetëvjeçarëve që pasojnë, ne i ftojmë të gjithë . . . që të planifikojnë duke kursyer për vitet që pasojnë punën me kohë të plotë” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Ezra Taft Benson* [2014], f. 219–220). Mund të ketë programe shtetërore ose sociale që janë në dispozicion për t’ju ndihmuar gjatë pensionit, por me gjasë ju do të keni nevojë t’i shtoni paratë që keni në dispozicion nga këto programe me vetë kursimet ose investimet tuaja. Nëse nuk do t’ia dilni që të planifikoni tani, ju mund të mos keni mjaftueshëm të ardhura ose kursime për të qenë i/e mbështetur te vetja pasi të dilni në pension.

Diskutoni: Çfarë do të ndodhë nëse nuk keni mjaftueshëm para për të jetuar të qetë gjatë pensionit?

1. VENDOSNI NJË SYNIM PËR PENSIONIN

Lexoni: Përpara se të filloni të kurseni për pensionin, është e dobishme që të përlllogaritni se sa para do t'ju nevojiten. Kjo formulë e thjeshtë mund t'ju ndihmojë që të filloni:

$$\text{Numri i viteve në pension} \times \text{Shuma vjetore e nevojshme për pension} = \text{Synimi juaj për daljen në pension}$$

Ju nuk mund ta parashikoni saktësisht sa gjatë do të jetoni, por mund të parashikoni se kur do të donit të dilnit në pension dhe ju mund të planifikoni mundësisht se sa gjatë do të jetoni pas asaj kohe. Në mbarë botën, shumica e njerëzve dalin në pension rreth moshës 60 dhe 70 vjeç. Ju mund të jetoni edhe 20 deri 30 vjet të tjera pas daljes në pension.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Harxhoni pak minuta kohë që të bëni një përlllogaritje rreth synimit për pensionin tuaj duke përdorur formulën e mëposhtme.


	x	=	
Numri i viteve në pension			Synimi juaj për daljen në pension

Shënim: Ju mund të mos keni nevojë për këtë shumë të plotë kur të dilni në pension, ndërsa investimet tuaja mund të vazhdojnë të rriten gjatë gjithë pensionit, por marrja parasysh e këtij numri është një pikë e mirë për të filluar.


2. KUPTOJENI INTERESIN E PËRBËRË

Lexoni: Interesi i përbërë mund të jetë një nga çelësat për të pasur mjaftueshëm para për pensionin. **Interesi i përbërë** është të fitosh interes shtesë nga interesi dhe në mënyrë tipike përfaqësohet si një përqindje ose normë fitimi. Sapo të keni fituar pagesën tuaj të parë me interes, ajo shtohet te bilanci i shumës themelore. Më pas ai bilanc më i madh vazhdon të rritet.

ÇFARË ËSHTË INTERESI I PËRBËRË?




Lexoni: Investimi në mënyra që sigurojnë një normë të mirë fitimi shpesh i ndihmon njerëzit të kenë kursyer mjaftueshëm para për pensionin. Shumicës së njerëzve u duket më e lehtë të investojnë shuma të vogla parash vazhdimisht me kalimin e kohës, të tilla si shuma të caktuara çdo muaj ose nga çdo pagë, në vend të shumave të mëdha periodike. Shembulli më poshtë tregon vlerën totale të investimit prej 100 dollarësh në muaj për 30 vjet me norma të ndryshme fitimi. Kjo është fuqia e interesit të përbërë.



Diskutoni: Si mund të ketë ndikim koha dhe norma e fitimit në vlerën totale të një investimi?

3. KUPTOJENI MARRËDHËNIEN NDËRMJET RREZIKUT DHE FITIMIT

Lexoni: Siç e kemi parë, norma e fitimit mund të jetë shumë e madhe. Mund të duket mjaft e thjeshtë që ajo çka të gjithë ne kemi nevojë të bëjmë, pra, është t'i investojmë paratë tona në diçka me normën më të lartë të fitimit. Por nuk është aq e thjeshtë. Siç e tregon grafiku i mëposhtëm, të gjitha investimet mbartin një marrëdhënie rreziku dhe fitimi. Në mënyrë tipike, sa më e ulët të jetë norma e fitimit, aq më pak rrezik do të ketë të humbni paratë në atë investim. E kundërta, sa më i lartë të jetë fitimi i mundshëm, aq më i lartë do të jetë rreziku i mundshëm që të humbisni paratë.



VEPRIMTARIA (3 minuta)

Bashkohuni me bashkëshortin/en ose partnerin tuaj në veprim dhe diskutoni se sa rehat ndiheni personalisht për rrezikun në investim.

4. MERRNI PARASYSH INVESTIME TË MUNDSHME

Lexoni: Kur merrni parasysh investime të mundshme, është e dobishme të dini disa gjëra bazë. Pothuajse të gjitha investimet mund të ndahen në dy kategori: ato me normë të pandryshueshme fitimi dhe ato me normë të ndryshueshme fitimi.

Një **normë e pandryshueshme** do të thotë që norma juaj nuk do të ngrihet apo ulet por do të mbetet fikse ose e pandryshueshme. Shembuj kursimesh ose investimesh me norma të pandryshueshme përfshijnë llogari kursimesh, vërtetime depozitash (VD) dhe bonde. Investimet me normë të pandryshueshme shpesh kanë një normë të ulët fitimi dhe mund të konsiderohen më pak të rrezikshme sesa investimet me normë të ndryshueshme.

Një **normë e ndryshueshme** do të thotë që fitimi juaj mund të ngrihet ose të ulet, duke nënkuptuar që mund të fitoni ose të humbisni para. Shembuj të investimeve me normë të ndryshueshme përfshijnë aksione, shumë fonde të ndërsjella, biznese dhe pasuri të paluajtshme. Në mënyrë tipike, investimet me normë të ndryshueshme konsiderohen më të rrezikshme sesa investimet me normë të pandryshueshme, por ato mund të mbartin edhe mundësinë për fitime më të larta.

Larmishmëri do të thotë të përhapësh paratë e tua nëpër investimeve të shumta. Investimi në shumë investime ose shumë lloje investimesh mund të ndihmojë që ta ulë rrezikun tuaj.

Për më shumë informacion për lloje të ndryshme investimesh, lexoni pjesën “Burimet” në fund të këtij kapitulli këtë javë në mënyrë të pavarur.

Diskutoni: Si grup, shqyrtojini konceptet vijuese derisa çdokush të ndihet që i kupton.

- Interesi i përbërë
- Rreziku kundrejt fitimit
- Norma e pandryshueshme e fitimit
- Norma e ndryshueshme e fitimit
- Larmishmëria

5. BËNI KËRKIME PËR LLOGARI TË MUNDSHME PËR PENSIONIN

Lexoni: Në mënyrë tipike juve do t'ju nevojitet të paguani disa lloje taksash për investimet tuaja. Në fakt, taksat mund të jenë një nga shpenzimet më të mëdha për t'u marrë parasysh kur investoni. Për fat të mirë, shumë qeveri lejojnë llogari për pensionin që kanë përfitime të veçanta në taksa që do të doni t'i kuptoni. Këto llogari investimi mund të jenë të financuara nga punëdhënësi ose individualisht dhe brenda këtyre llogarive ju mund të investoni në aksione, bonde, fonde të ndërsjella dhe më tej. Llogaritë hapen në emra të ndryshëm në varësi të zonës ku jetoni, por përparësitë e taksës bazë janë të ngjashme dhe përgjithësisht i takojnë dy kategorive: Me taksë të shtyrë dhe pa taksë.

Me taksë të shtyrë: Kontributet te llogaritë me taksë të shtyrë janë në mënyrë tipike taksa që zbriten vitin e derdhjes së kontributeve, ndërkohë që tërheqjet gjatë pensionit taksohen me çfarëdo norme takse që vendoset nga të ardhurat tuaja në atë kohë. Nëse investimi juaj nuk ka gjasa të rritet ndjeshëm, qoftë për shkak të një norme të ulët fitimi apo për shkak se ka pak kohë që po rritet, ju mund të kurseni më shumë para në taksa duke e shtyrë pagesën e taksave të të ardhurave për ato para deri ditën e daljes në pension, kur paratë mund të taksohen me një normë të ulët.

Pa taksë: Kontributet te llogaritë pa taksë nuk japin përparësi për taksën fillestare. Për këto llogari, paratë që derdhni taksohen në vitin që janë fituar. Gjithsesi, të gjitha fitimet dhe tërheqjet në të ardhmen janë pa taksë. Nëse investimi juaj ka gjasa të rritet ndjeshëm, qoftë për shkak të një norme më të lartë fitimi apo për shkak se ka më shumë kohë për t'u rritur, ju me gjasë do të paguani më pak taksa duke përdorur një llogari pa taksë.

Siç mund ta shihni, bazuar në llojin e llogarisë që zgjidhni, ju ose do të paguani taksa në sportel ose kur bëni tërheqjen te [bankomati]. Në varësi nga rrethanat tuaja, një model mund të jetë më dobiprurës për ju sesa tjetri.

VEPRIMTARIA (5 minuta)

Hidhuni një sy tre shembujve të mëposhtëm. Këta shembuj ilustrjnë dikë që ka investuar 100 dollarë në muaj dhe ka fituar përkatësisht 8 përqind fitim për 10, 20 e 30 vjet. Po ajo shumë parash u investua dhe u rrit në të njëjtën vlerë si në llogarinë me taksë të shtyrë edhe në atë pa taksë. Sidoqoftë, shikoni ndryshimin te shuma e paguar në taksë.

Hapi 1: Ndahuni në grupe të vogla me nga dy deri në katër njerëz, duke përfshirë partnerin tuaj në veprim.

Hapi 2: Për çdo skenar, qarkojeni shumën totale më të ulët të paguar për taksë dhe shënoni se cila lloj llogarie kushton më pak në totalin e taksave.

Hapi 3: Diskutoni pyetjet vijuese:

- Cili është ndryshimi midis llogarive me taksë të shtyrë dhe pa taksë?
- Kur mund të jetë llogaria me taksë të shtyrë mundësia më e mirë?
- Kur mund të jetë llogaria pa taksë mundësia më e mirë?

INVESTIMI		TAKSAT		
		Taksat e paguara në fillim	Taksat e paguara pas tërheqjes nga llogaria	Totali i taksave të paguara
10 Vjet				
12 000 Totali i investuar Fitim 8% 18 294 Para për pension Norma e taksave 15% ME PAGESË TË SHTYRË TAKSASH PA TAKSA Norma e taksave 25%		0	+	2 744
		3 000	+	0
				= 2 744
				= 3 000

INVESTIMI		TAKSAT		
		Taksat e paguara në fillim	Taksat e paguara pas tërheqjes nga llogaria	Totali i taksave të paguara
20 Vjet				
24 000 Totali i investuar Fitim 8% 58 902 Para për pension Norma e taksave 15% ME PAGESË TË SHTYRË TAKSASH PA TAKSA Norma e taksave 25%		0	+	8 835
		6 000	+	0
				= 8 835
				= 6 000

INVESTIMI		TAKSAT		
30 Vjet		Taksat e paguara në fillim	Taksat e paguara pas tërheqjes nga llogaria	Totali i taksave të paguara
36 000 Totali i investuar Fitim 8% 149 035 Para për pension Norma e taksave 15% ME PAGESË TË SHTYRË TAKSASH PA TAKSA Norma e taksave 25%		0	+	22 335
		9 000	+	0
			=	22 335
			=	9 000

6. FILLONI TË KURSENI PËR PENSIONIN SA MË PARË TË JETË E MUNDUR

Lexoni: Sapo të keni krijuar një fond për raste të ngutshme dhe ta keni shlyer borxhin konsumator, ju duhet të filloni të kurseni për pensionin sa më parë të jetë e mundur. Sa më parë të filloni të kurseni për pensionin, aq më shumë do të rriten paratë tuaja në kohëzgjatje dhe me gjasë do të keni më shumë para në dispozicion për pensionin.

Një mënyrë e shkëlqyer për të filluar kursimin për pensionin është nëpërmjet një plani pensioni të financuar nga punëdhënësi. Nëse punëdhënësi juaj ju ofron një lloj llogarie për pensionin ku përputhet disi me atë që kontribuoni, përfitoni prej saj! Përputhja e tyre është si bonus ose rritje për ju, vetëm se derdhni kontribute për kursimet tuaja.

Veprimtaria vijuese ndihmon për të ilustruar fuqinë e investimit në mënyrë të rregullt për një periudhë më të gjatë kohe.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Hapi 1: Ndahuni në grupe të vogla me nga dy deri në katër njerëz, duke përfshirë partnerin tuaj në veprim.

Hapi 2: Diskutoni për strategjitë e investimit të tre njerëzve që përshkruhen më poshtë. Kush investon më shumë? Kush investon më pak? Të supozojmë që secili fiton 8 përqind të interesit të përbërë për investimet e tyre, kush mendoni se do të fitojë më shumë? Kush mendoni se do fitojë më pak?

XHULIA

- Investon 300 dollarë çdo muaj duke filluar që në moshën 25-vjeçare.
- Në total ajo investon 147 600 dollarë.


ANDREA

- Investon 600 dollarë çdo muaj duke filluar që në moshën 35-vjeçare.
- Në total ajo investon 223 200 dollarë.

BELA

- Investon 1 200 dollarë çdo muaj duke filluar që në moshën 45-vjeçare.
- Në total ajo investon 302 400 dollarë.

Hapi 3: Tani shqyrtoni skemën më poshtë që tregon se si investimet e tyre rriten me kalimin e kohës. Kush fitoi më shumë? Kush fitoi më pak? Çfarë ndikimi ka efekti kohë tek investimet?



Shënim: Supozohet 8% e normës së interesit të përbërë.

DISKUTONI RRETH PËRGATITJES PËR PENSIONIN NË KËSHILLIN TUAJ FAMILJAR

Lexoni: Gjatë këshillit tuaj familjar këtë javë, diskutoni për planet tuaja për pensionin. Përlogaritni se sa do t'ju nevojitet, kur do të donit të dilnit në pension dhe cila mund të jetë situata juaj financiare në atë kohë. Hidhni në letër shumën që do të donit të kursenit dhe përcaktoni një shumë që mund ta përballoni për ta vënë mënjanë çdo muaj për pensionin. Kujtoni, edhe pse është e rëndësishme që të filloni të kurseni për pensionin sa më parë të jetë e mundur, është më urgjente që të mblidhni fondin tuaj për raste të ngutshme dhe të eliminoni së pari borxhin konsumator. Gjatë diskutimit tuaj, ju mund të doni të përdorni përvijimin që pason “Model Diskutimi Në Këshillin Familjar”.

MODEL DISKUTIMI NË KËSHILLIN FAMILJAR

Sigurohuni që të filloni dhe të mbaroni me një lutje për ta ftuar Shpirtin.

Pjesa 1: Shqyrtoni

- Si po ecni me përparësinë tuaj aktuale financiare?
- Si po përgatiteni siç duhet për pensionin?

Pjesa 2: Planifikoni

- Kur do të donit të dilnit në pension?
- Sa para do t'ju nevojitet që të siguroni çdo vit për nevojat tuaja?
- Sa para keni nevojë të kurseni?
- Si do të jetë vallë situata juaj financiare kur të dilni në pension? A do të keni në pronësi një shtëpi? A do të keni ende një kredi? A do të jeni duke u përgatitur për të shërbyer një mision për të rritur? A do të keni nevojë të mbështetni ndonjë pjesëtar të familjes? A do të jenë vallë shpenzimet tuaja të jetesës më të shumta apo më të pakta se ç'janë tani?



INVESTIMI

Gjëja më e rëndësishme që kemi bërë ndonjëherë ishte thjesht të fillonim. Shumë kohë përpara se të kishim ndonjë të ardhur “shtesë”, unë zgjodha fondin e ndërsjellë me indeks konservator dhe krijuam një depozitim të rrjedhshëm me 1 përqind të pagës sonë, saqë e harruam fare. Kur i ndryshova punëdhënësit rreth tetë vjet më vonë, po krijoja fondin tim të ri për pensionin dhe zbulova sërish këtë fondin e vjetër . . . tani me vlerë pothuajse 7 500 dollarë.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Në mënyrë të pavarur mendoni rreth asaj që keni mësuar sot dhe shqyrtoni se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexojeni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruajini përgjigjet për pyetjet.

“Zot, ti më besove pesë talenta; ja, me ato unë fitova pesë talenta të tjerë” (Mateu 25:20).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe pastaj nënshkruani më poshtë.

ZOTIMET E MIA

- Ⓐ Do ta ushtroj dhe do ta tregoj parimin nga Themeli Im të kësaj jave.
- Ⓑ Do të vazhdoj të vë para për përparësinë time financiare.
- Ⓒ Do të diskutoj lidhur me përgatitjen për pensionin gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Do të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe do ta përkrah atë.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

LLOJI I INVESTIMIT	PËRKUFIZIMI	E PANDRYSHUESHME APO E NDRYSHUESHME
Llogari Kursimesh	Një llogari depozitimi, zakonisht në një bankë ose institucion tjetër financiar, përgjithësisht me normë të ulët fitimi. Përdoruesit e llogarisë mund të bëjnë tërheqje dhe depozitime pa gjabë.	E pandryshueshme
Vërtetimi për Depozitim (VD)	Një llogari ku ju depozitoni një shumë specifike parash për një periudhë të caktuar kohore; nëse i tërhiqni paratë përpara se të mbarojë koha, mund t'ju mbahet një gjabë (të humbisni një pjesë të parave të investuara). Ndërkohë që paratë investohen, ato prodhojnë një normë të pandryshueshme e modeste fitimi. Kur koha e caktuar të ketë kaluar, ju do ta rimerrni investimin fillestar, bashkë me interesin e fituar.	E pandryshueshme
Bondi	Një investim në borxh ku ju në thelb i huazoni paratë tuaja te një entitet ose organizatë për një periudhë të caktuar kohore me qëllim që të merrni një normë të pritshme fitimi. Kur koha e caktuar të ketë kaluar, ju do ta rimerrni investimin fillestar, bashkë me interesin e fituar. Bondet mund të mundësohen nga qeveritë dhe korporatat. Në varësi nga organizatat që i mundësojnë, bondet mund të konsiderohen me rrezik të ulët ose rrezik të lartë.	E pandryshueshme
Aksione	Kjo përfaqëson një pjesë të zotërimit në një kompani, e shitur si aksion. Çdo aksion përfaqëson një pjesë të zotërimit, pra nëse një kompani ka nxjerrë 100 000 aksione dhe ju zotëroni një aksion, ju zotëroni 1 të 100 000-ën e asaj kompanie. Norma e fitimit varet nga rendimenti i kompanisë.	I ndryshueshëm
Fond i Ndërsjellë	Këto janë krijuar në mënyrë tipike nga një grup me aksione dhe bonde të përziera. Fondi administrohet nga një profesionist. Fondet e ndërsjella sigurojnë një mënyrë të thjeshtë për të shumëfishuar investimet. Nëse fondi i ndërsjellë ka rezultate të mira, vlera e investimit tuaj rritet. Nëse ka rezultate të dobëta, vlera e investimit tuaj ulet.	I ndryshueshëm
Pasuri e Paluajtshme	Një investim pronësie në pronën e paluajtshme, të tilla si shtëpitë, apartamentet ose dyqanet. Fitimet vijnë në formë të ardhurash, një shtim në vlerën e pronës ose të dyja. Humbjet mund të ndodhin gjithashtu për shumë arsye, duke përfshirë një rënie në vlerën e pronës ose qiramarrësit që nuk e paguajnë qiranë apo dëmtimet e pronës.	I ndryshueshëm
Pronësi Biznesi	Ky investim përfaqëson pasjen e një pjese në zotërim, në pronësinë e një biznesi vetjak. Përfitimet varen nga rendimenti i biznesit.	I ndryshueshëm



12

TË VAZHDOJMË T'U JAPIM TË TJERËVE DHE T'I BEKOJMË ATA

PARIMI NGA THEMELI IM

- Merrini Ordinancat e Tempullit

PARIMET DHE AFTËSITË FINANCIARE

1. Tregojani Familjes dhe Miqve Tuaj Parimin e Mbështetjes te Vetja
2. Shkoni Përpara me Besim



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

ZOTIMET E JAVËS SË KALUAR

- Ⓐ Të ushtroj dhe t'ua tregoj të tjerëve parimin nga Themeli Im të javës së kaluar.
- Ⓑ Të vazhdoj të vë para për përparësinë time financiare.
- Ⓒ Të diskutoj lidhur me planin për pensionin gjatë këshillit familjar.
- Ⓓ Të vihem në kontakt me partnerin tim në veprim dhe ta përkrah atë.

HAPI 1: VLERËSONI ME PARTNERIN NË VEPRIM (5 minuta)

Harxhoni pak minuta për t'i vlerësuar përpjekjet tuaja për mbajtjen e zotimeve vetjake këtë javë. Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në fillim të kësaj fletore pune. Tregojani vlerësimin tuaj partnerit tuaj dhe diskutojeni me të pyetjen e mëposhtme. Ai ose ajo pastaj do të fillojë ku t'i tregohet.

Diskutoni: Çfarë sfidash patët ndërsa i mbajtët zotimet tuaja këtë javë?

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA				
Udhëzime: Vlerësoni përpjekjen tuaj për t'i mbajtur zotimet që bëni çdo javë. Tregojani vlerësimin vetjak partnerit tuaj në veprim. Partneri mbi mënyrën se si mund të vazhdoni të përmirësoheni bëni udhëzime për formimin e kësaj zotimit të rëndësishëm.				
LEGJENDA: ● Përpjekje Minimale ● Përpjekje Mesatare ● Përpjekje të Rëndësishme				
Ⓐ E vë në praktikë dhe e tregoj partnerit Themeli Im	Ⓑ I Planifikoj dhe i Administron Financat e Mja	Ⓒ Mëq një Këshill të Familjes	Ⓓ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Gjendja Nëse të Partnerit në Veprim
Shprehja Si jam në bindur	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohem mbi bindjen		
Javë 1 Më kujtohet të vëpara dhe të jem i përgatitur	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohem mbi bindjen		
Javë 2 Të ushtroj besim të jashtëm	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohem mbi bindjen të ushtroimit dhe shpenzimet		
Javë 3 Të përdorim dhe të jem i bindur	Regjistroj shpenzimet	Ndihmohem mbi të dhënat dhe ofertat		
Javë 4 Të jem i përgatitur të bashkëpunoj	Harroj një bërthamë	Ndihmohem mbi bërthamë të bashkëpunoimit		
Javë 5 Të zgjidh problemet	Zgjidh një sistem për bërthamë	Ndihmohem mbi bërthamë të bashkëpunoimit		
Javë 6 Të përdor kohën me mençuri	Calloj para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi bërthamë të bashkëpunoimit		
Javë 7 Të tregoj integritet moral	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi bërthamë të bashkëpunoimit		
Javë 8 Puna të marr përgjegjësi dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi bërthamë të bashkëpunoimit		
Javë 9 Të komunikoj të bëj kërkime dhe të diskutoj	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi administrimin e rastit të kësaj		
Javë 10 Më kujtohet të mësoj vlerësimin se ku po shkon dhe se si të arrijmë atë	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi funksionin, prirjen e shprehjes, zotimit		
Javë 11 Të bëjmë një, të shprehim dhe të bashkëpunoj	Vendos para për një përparim financiar	Ndihmohem mbi planifikimin për partnerin		

HAPI 2: RAPORTONI TE GRUPI (8 minuta)

Pasi t'i vlerësoni përpjekjet tuaja, bashkohuni sërish dhe raportoni përfundimet tuaja. Ecni rreth grupit dhe secili të thotë nëse e ka vlerësuar veten me të "kuqe", të "verdhë" apo "jeshile" për secilin zotim të javës së kaluar.

HAPI 3: JEPINI PËRVOJAT TUAJA (10 minuta)

Tani tregojini si grup gjërat që keni mësuar nga përpjekja për t'i mbajtur zotimet tuaja gjatë javës.

- Diskutoni:**
- Çfarë përvojash patët ndërsa e ushtruat ose ua treguat të tjerëve parimin nga Themeli Im?
 - Çfarë sfidash keni pasur me vënien e parave për përparësinë tuaj financiare?
 - Çfarë mësuar nga diskutimi për planin e pensionit tuaj?

HAPI 4: ZGJIDHINI PARTNERËT NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën vijuese. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të familjes.

Harxhoni dy minuta tani për t'u takuar me partnerin tuaj në veprim. Paraqiteni veten dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIEL	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHTU



THEMELI IM: MERRINI ORDINANCAT E TEMPULLIT

– Koha Maksimale: 20 Minuta

Përsiatni: Cilat janë disa nga gjërat që kanë më shumë rëndësi për ju?

Shihni: “Doing What Matters Most” [“Bërja e Asaj që Ka më Shumë Rëndësi”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 201.)

Diskutoni: Çfarë gjërash të parëndësishme po na pengojnë të përparojmë? Si mund të na ndihmojnë ordinancat e ungjillit?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhjet 84:20 dhe citimin nga Presidenti Bojd K. Parker (në të djathtë)

Diskutoni: Ndërsa kërkojmë mbështetje te vetja, pse është e rëndësishme të jemi të denjë për në tempull?

VEPRIMTARIA

Hapi 1: Me një partner, lexojeni citimin nga Plaku Kuentin L. Kuk (në të djathtë) dhe shkrimet e shenjta vijuese. Nënvizojini bekimet e premtuara për ata që adhurojnë në tempull.

“Si rrjedhim, në ordinancat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet” (DeB 84:20).

“Dhe që ata të mund të rriten në ty e të marrin plotësi të Frymës së Shenjtë dhe të organizohen sipas ligjeve të tua e të përgatiten për të fituar çdo gjë të nevojshme” (DeB 109:15).

“Dhe kur njerëzit e tu të bëjnë shkelje, ndonjëri prej tyre, ata me të shpejtë të mund të pendohen e të kthehen tek ty dhe të gjejnë hir në sytë e tu e të rivendosen në bekimet që ti i ke shuguruar të derdhen mbi ata që do të të nderojnë ty në shtëpinë tënde” (DeB 109:21).

“Dhe ne të kërkojmë, Atë i Shenjtë, që shërbëtorët e tu të mund të largohen nga kjo shtëpi të armatosur me fuqinë tënde dhe që emri yt të mund të jetë mbi ta e lavdia jote të jetë përreth tyre dhe engjëjt e tu të ngarkohen me përgjegjësi për ta” (DeB 109:22).

“Ne të kërkojmë, Atë i Shenjtë, . . . që asnjë armë e formuar kundër tyre nuk do të përparojë” (DeB 109:24–25).

Hapi 2: Përsiatni në mënyrë të pavarur: “Çfarë duhet të ndryshoj në jetën time që të marr pjesë në ordinancat e tempullit më shpesh?”

“Si rrjedhim, në ordinancat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet.”

DOKTRINA E BESËLIDHJE 84:20

“Zoti do të na bekojë ndërsa marrim pjesë në punën e ordinancave të shenjta të tempujve. Bekimet e atjeshme nuk do të kufizohen te shërbimi ynë në tempull. Ne do të bekohemi në të gjitha punët tona. Ne do të kemi të drejtën e ndikimit të Zotit në interesin tonë edhe në çështjet tona shpirtërore ashtu edhe në ato materiale.”

BOYD K. PACKER, *The Holy Temple* (1980), f. 182

“Ne do të bënim mirë ta studionim seksionin e 109-të të Doktrinës e Besëlidhjeve dhe ta ndiqnim paralajmërimin e Presidentit [Hauard W.] Hanter për ta vendos[ur] tempullin e Zotit si simbolin e madhërishëm të anëtarësisë [sonë].”

KUENTIN L. KUK, “Shikojeni Vetën Tuaj në Tempull”, *Ensign ose Liahona*, maj 2016, f. 99; duke cituar *Mësime të Presidentëve të Kishës: Hauard W. Hanter* (2015), f. 178–179

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni rutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- ☐ Nëse keni një rekomandim tempulli, vendosni një datë për të marrë pjesë në tempull.
- ☐ Nëse nuk keni një rekomandim tempulli, takohuni me peshkopin tuaj ose presidentin e degës për të diskutuar mënyrën se si mund të përgatiteni për t'i marrë ordinancat tuaja të tempullit.
- ☐ Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar rreth ordinancave të tempullit.

BËRJA E ASAJ QË KA MË SHUMË RËNDËSI

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexojeni këtë skenar.



TREGIMTARI: Një avion u rrëzua në Florida në një natë të errët dhjetori. U vranë mbi 100 njerëz. Ai ishte 32 kilometra larg zonës së sigurisë.

PRESIDENTI DITER F. UHTDORF: Pas aksidentit, hetuesit u përpoqën të përcaktonin shkakun. Rrota e përparme në fakt ishte shtrirë siç duhej. Aeroplani ishte në kushte mekanike të përkryera. Çdo gjë funksiononte siç duhej – gjithçka përveç një gjëje: një llamba të vetme drite e djegur. Llamba e vogël – me vlerë rreth 20 cent – nisi zinxhirin e ngjarjeve që së fundi çoi në

vdekjen tragjike të më tepër se 100 vetëve.

Sigurisht, llamba e dritës që nuk ndizej, nuk e shkaktoi aksidentin; ai ndodhi sepse ekuipazhi u përqendrua tek diçka që dukej se kishte rëndësi në atë çast, duke harruar atë që kishte rëndësinë më të madhe.

Prirja për t'u përqendruar te gjërat e parëndësishme në kurriz të atyre të thellave u ndodh jo vetëm pilotëve por gjithkujt. Të gjithë jemi në rrezik. . . . A jepen mendimet dhe zemrat tuaja pas atyre gjërave jetëshkurtra, flutura-ke që kanë rëndësi vetëm për çastin, apopas gjërave që kanë më shumë rëndësi?

(“Jemi Duke Bërë një Punë të Madhe dhe nuk Mund të Zbresim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 59, 60)

Kthehuni te faqja 200.




MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

DISKUTIMI I SOTËM:



5

**VAZHDONI T'U JEPNI TË
TJERËVE DHE T'I BEKONI ATA**



**HARTA E SUKSESIT PËR
KUJDESTARINË FINANCIARE**

1. TREGOJANI FAMILJES DHE MIQVE TUAJ PARIMET E MBËSHTETJES TE VETJA

Tregojani të tjerëve Parimet e Mbështetjes Shpirtërore te Vetja

Lexoni: Kur bëhemi të mbështetur te vetja shpirtërisht, është detyra jonë t'i ndihmojmë të tjerët të bëhen gjithashtu të mbështetur te vetja shpirtërisht. Te Doktrina e Besëlidhje ne lexojmë: "Dhe nëse ndonjë mes jush është i fortë në Shpirt, le të marrë me vete atë që është i dobët, që ai të lartësohet në zemërbutësi, që ai të mund të forcohet gjithashtu" (DeB 84:106). Në po atë mënyrë, te Dhiata e Re, Pjetri shkruan: "Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë, si kujdestarë të mirë të hirit të shumëfarshëm të Perëndisë" (1 Pjetër 4:10).

Diskutoni: Si zbatohen këto shkrime të shenjta për ju? Si jua kanë bekuar jetën parimet e mbështetjes te vetja te *Themeli Im*? Çfarë do të thotë të jesh i/e mbështetur te vetja shpirtërisht?

Tregojani të tjerëve Parimet e Mbështetjes Materiale te Vetja

Lexoni: Kur bëhemi të mbështetur te vetja materialisht, është detyra jonë t'i ndihmojmë të tjerët të bëhen gjithashtu të mbështetur te vetja materialisht. Një nga mënyrat më të mira se si t'i ndihmojmë të tjerët të bëhen të mbështetur te vetja, është të shërbesh dhe t'u japësh të tjerëve. Presidenti Marion G. Romney dha mësim: "Ka një varësi të ndërsjellë ndërmjet atyre që kanë dhe atyre që nuk kanë. Procesi i dhënies i lartëson të varfrit dhe i përul të pasurit. Në proces që të dy grupet shenjtërohen. Të varfrit, të çliruar nga skllavëria dhe kufizimet e varfërisë, aftësohen si njerëz të lirë për t'u ngritur në potencialin e tyre të plotë, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht. [Ata që kanë më shumë], duke ofruar nga pasuria e tyre shtesë, bëhen pjesëmarrës në parimin e përjetshëm të dhënies. Sapo një person është plotësuar ose është bërë i mbështetur te vetja, ai zgjatet për të ndihmuar të tjerë dhe cikli përsëritet" ("The Celestial Nature of Self-Reliance", *Ensign*, nëntor 1982, f. 93).

Diskutoni: Si zbatohet tek ju ky citim? Kush janë të varfrit? Si mund t'i ndihmoni të varfrit apo nevojtarët, në jetën tuaj?

Përsiatni: Harxhoni një minutë kohë për të përsiatur pyetjen vijuese: Cilin njoh që ka nevojë për *Financa Vetjake për Mbështetjen te Vetja*? Si do t'ua tregoj atyre? Hidhni në letër emrat dhe planet për t'i treguar më poshtë.

2. SHKONI PËRPARA ME BESIM

Lexoni: Përgëzime! Ju i keni përfunduar mbledhjet në grup në lidhje me Financat Vetjake për Mbështetjen te Vetja. Për ta vlerësuar përparimin tuaj, hidhni në letër se ku jeni dhe si planifikoni ta vazhdoni përparimin në tabelën më poshtë.

VEPRIMTARIA (10 minuta)

Në mënyrë të pavarur shqyrtoni Hartën e Suksesit për Kujdestarinë Financiare dhe përsiatni përparimin që keni bërë gjatë 12 javëve të fundit. Mendoni për hapat e tjera në udhëtimin tuaj dhe plotësojeni tabelën më poshtë.

OBJEKTIVI	PO OSE JO	PËRPARIMI DERI NË DATËN/HAPAT E TJERË
Ndihem në një mendje me bashkëshortin/en tim/e dhe Zotin rreth financave të mia.		
Jam zotuar që të bëhem i/e mbështetur te vetja.		
Kam besim te Jezu Krishti.		
Paguaj një të dhjetë të plotë dhe i jap ofertat e agjërimit.		

OBJEKTIVI	PO OSE JO	PËRPARIMI DERI NË DATËN/HAPAT E TJERË
Nuk jam i/e varur te përkrahja nga familja, kisha dhe qeveria.		
E shqyrtoj rregullisht dhe eci sipas buxhetit tim.		
Kam një fond njëmuor për raste të ngutshme.		
Nuk kam borxhe ose jam duke e paguar rregullisht borxhin.		
Kam një fond tre deri gjashtëmuor për raste të ngutshme.		
Kam sigurime të përshtatshme (të tilla si sigurime për shëndetin, jetën, makinën dhe paaftësinë fizike).		
Po kursej dhe po investoj për të ardhmen rregullisht.		

Diskutoni: Si jeni përmirësuar gjatë 12 javëve të fundit, për t'u bërë kujdestarë më të mençur dhe besnikë të financave tuaja?

Lexoni: Shumë nga gjërat që kemi diskutuar nuk mund të përfundohen brenda 12 javëve. Sidoqoftë, ju duhet t'i keni zhvilluar zakonet e nevojshme për ta vazhduar përparimin tuaj drejt kujdestarisë së suksesshme financiare. Vazhdoni të zhvilloni rregullisht këshilla familjarë. Vazhdoni t'i lexoni kapitujt në këtë fletore pune. Dhe vazhdoni të punoni për përparësitë tuaja financiare. Zotohuni të ndiqni "Hapat e Tjerë" që hodhët në letër në kolonën e fundit të vlerësimeve në faqet e mëparshme.

Përsiatni: Harxhoni pesë minuta për të menduar rreth pyetjes vijuese dhe hidhni në letër mendimet tuaja më poshtë: Cilat janë gjërat më kuptimplote që kam mësuar gjatë 12 javëve të fundit?

VEPRIMTARIA (20-30 minuta)

Si grup, shprehni sipas dëshirës dëshmitë, përvojat, gjërat që keni mësuar dhe mënyrat sipas të cilave Zoti ju ka bekuar gjatë 12 javëve të fundit.



VAZHDONI NË SHTEGUN TUAJ DREJT MBËSHTETJES TE VETJA

Lexoni: Përgëzime! Gjatë 12 javëve të kaluara, ju keni krijuar zakone të reja dhe jeni bërë më i/e mbështetur te vetja. Zoti do që ju të vazhdoni të ndërtoni mbi këto aftësi dhe të zhvillonit aftësi të reja. Ndërsa lutemi dhe mbajmë vesh, Fryma e Shenjtë mund të na ndihmojë të dimë se cilat gjëra në jetën tonë duhet të përmirësojmë.

Diskutoni: Çfarë mund të bëjmë që të vazhdojmë përgjatë shtegut tonë drejt mbështetjes te vetja? Si mund të vazhdojmë ta ndihmojmë njëri-tjetrin?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë 12 javëve të ardhshme. Shenjojeni kutinë përzgjedhëse kur ta përfundoni secilin veprim:

- ☐ Shqyrtojini dhe vazhdoni t'i jetoni të 12 parimet dhe zakonet për mbështetjen te vetja te Themeli Im.
- ☐ Tregojani të tjerëve atë që keni mësuar rreth mbështetjes te vetja. Vazhdoni t'i ndihmoni anëtarët e grupit tuaj ose propozoni të ndërmjetësoni për një grup të ri të mbështetjes te vetja.
- ☐ Ndërtoni mbi aftësitë tuaja duke marrë pjesë në një grup tjetër të mbështetjes te vetja.
- ☐ Studiojini parimet doktrinale të mbështetjes te vetja më poshtë.

PARIMET DOKTRINORE TË MBËSHTETJES TE VETJA

MBËSHTETJA TE VETJA ËSHTË NJË URDHËRIM	QËLLIMI I ZOTIT ËSHTË QË TË SIGUROJË PËR SHENJTORËT E TIJ DHE AI E KA TË GJITHË PUSHTETIN PËR TA BËRË KËTË	MATERIALJA DHE SHPIRTËRORJA JANË NJË
Doktrina e Besëlidhje 78:13–14; Moisiu 2:27–28	Doktrina e Besëlidhje 104:15; Gjoni 10:10; Mateu 28:18; Kolosianëve 2:6–10	Doktrina e Besëlidhje 29:34; Alma 34:20–25

"Dhe tani, vëllezërit e mi të dashur, pasi ju të keni hyrë në këtë shteg . . . , unë do t'ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë. . . . Ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht."

2 NEFI 31:19–20

"Zoti kujdeset mjaftueshëm për ne sa të na japë drejtim për të shërbyer dhe mundësinë për ta zhvilluar mbështetjen te vetja. Parimet e Tij janë të qëndrueshme dhe nuk ndryshojnë kurrë."

MARVIN J. ASHTON,
"Give with Wisdom
That They May Receive
with Dignity", *Ensign*,
nëntor 1981, f. 91

LETËR PËRFUNDIMI

Unë, _____, kam marrë pjesë në një grup për mbështetjen te vetja të siguruar nga Kisha e Jezui Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe i kam përmbushur kërkesat e nevojshme për përfundim sikurse vijojnë:

Mora pjesë në së paku 10 mbledhje nga 12 të tilla.

I përfundova që të 12 parimet dhe ia mësova ato familjes sime.

E përfundova një veprimtari shërbimi.

Kam ushtruar dhe ndërtuar një themel aftësish, parimesh dhe zakonesh për mbështetjen te vetja. Do të vazhdoj t'i përdor këto gjatë gjithë jetës sime.

Emri i pjesëmarrësit

Nënshkrimi i pjesëmarrësit

Data

Unë vërtetoj se ky pjesëmarrës i ka plotësuar kërkesat e renditura më lart.

Emri i ndërmjetësit

Nënshkrimi i ndërmjetësit të grupit

Data

Shënim: Në një datë të mëvonshme mund të lëshohet një certifikatë e Kolegjit SHDM për Biznesin nga komiteti i mbështetjes te vetja i kunjit ose distriktit.



A DO TA VAZHDONI SHTEGUN TUAJ DREJT MBËSHTETJES TE VETJA?

“Prandaj, çfarë lloj njerëzish duhet të jeni? Në të vërtetë, unë ju them juve, madje siç jam unë.”

3 Nefi 27:27

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Shërbime për
Mbështetjen te Vetja
FONDI I QARKULLUESHËM ARSIMOR

